

Prof.dr.

Halid bin Ali el Mushejkih

PËRMBLEDHJE
E
BESIMIT ISLAM

Korçë , 2024

Titulli i librit në origjinal:
"El Hulasatu fil akideti"

Titulli i librit në shqip:
"Përmbledhje e besimit islam"

Autori:
Prof. dr. Halid bin Ali el Mushejkih
Profesor në Fakultetin e Sheriatit, Universiteti i Kasimit,
Mbretëria e Arabisë Saudite

Përktheu :
Kastriot Bardhi

Redaktimi :
Klevi Vinjaku
Valmira Bardhi

HYRJA

Lavdërimi absolut i takon vetëm Allahut. Vetëm Atë falënderojmë; dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga të ligësitë e veteve tona dhe nga veset e punët tona të këqija. Atë që Allahu e udhëzon, askush nuk mund ta devijojë; dhe atë që Allahu e lë në humbje, askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj dhe deklaroj se përveç Allahut askush nuk meriton të adhurohet. Ai është i Adhuruari i Vërtetë, i Vetëm, pa ortakë dhe rivalë në pushtetin e sundimin e Tij. Gjithashtu, dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë muslimanë!” (Al Imran: 102)

“O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra. Dhe frikësojuni Allahut, me emrin e të Cilit ju kërkoni të drejtat e ndërsjella dhe ruani lidhjet farefisnore. Se vërtet, Allahu është përherë Mbikëqyrës mbi ju.”(En-Nisa: 1)

“O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t’jua bekojë veprat tuaja dhe do t’jua falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”(El Ahzab: 70-71)¹

Ky tekst është një përmbledhje e besimit të muslimanëve në Allahun e Lartësuar; është një paraqitje me pak fjalë e thelbit

¹ Kjo është hutbeja e emërtuar si *'Hutbetul-haxhe'*, të cilën i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ua mësonte sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta!), dhe ata me këtë fillonin fjalimet e rastit, hutbet, këshillat etj. (shënim i redaktorit)

të përmbajtjes së *teuhidit rububije*², *uluhije*³ dhe *esmau ue sifat*⁴. Në fakt, ky material është përmbledhje e një libri të mëparshëm, që kam shkruar për besimin e muslimanit. E bëra këtë përmbledhje, me qëllim që të studiohet dhe të mësohet lehtë në mësimet dhe në kurset fetare. Librin e titullova **“Përmbledhje e besimit islam”**. Gjatë hartimit të këtij teksti jam përpjekur të jem i qartë, në mënyrë që fjalët dhe shprehjet të kuptohen lehtë. Paqja, bekimet dhe mëshira e Allahut qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin, për familjen dhe gjithë shokët e tij.

Autori:

Prof. dr. Halid bin Ali el Mushejkih

² Njësimi i Allahut, duke besuar dhe pohuar veprat e Tij , si : krijimi, furnizimi, sundimi etj.

³ Njësimi i Allahut në adhurim duke ja kushtuar të gjitha adhurimet vetëm Atij.

⁴ Njësimi i Allahut në emrat dhe cilësitë e Tij.

KAPITULLI I

PËRKUFIZIMI I AKIDES, THEMELI I AKIDES ISLAME DHE BURIMET REFERENCIALE TË SAJ

- Mësimi i parë: Përkufizimi i akides dhe teuhidit
- Mësimi i dytë: Themeli i akides islame dhe burimet referenciale të saj
- Mësimi i tretë: Shehadeti "La ilahe il Allah"
- Mësimi i katërt: Shirku i madh dhe shirku i vogël
- Mësimi i pestë: Kufri

MËSIMI I PARË

PËRKUFIZIMI I AKIDES DHE TEUHIDIT

Akidja është besimi i patundur në Allahun e Lartësuar, dhe në të genit Një, i Vetëm dhe i pashoq; gjithashtu, besimi në engjëjt, në librat, në të dërguarit, në Ditën e Gjykimit, besimi në kaderin e Allahut (paracaktimin e krijimin), si dhe në gjithçka që buron nga këto baza të besimit dhe që i bashkëngjiten atyre.

Teuhidi është njësimi i Allahut në gjithçka që i përket vetëm Atij, duke pasur besim të sigurt e të plotë në Allahun e Lartësuar, i Cili është Një dhe i Vetëm në *uluhije*, në *rububije* dhe në *esmau ue sifat*.

➤ *Kush realizon teuhidin, hyn në Xhenet*

Ata që realizojnë teuhidin, i përkasin niveleve të ndryshme. Mirëpo kushti themelor për realizimin e teuhidit është: të mos e cënojë aspak atë (teuhidin) me diçka që e nxjerr nga feja dhe mileti islam. Sa i përket realizimit të teuhidit, pas plotësimit të kushtit të lartpërmendur, njerëzit ndahen në dy kategori:

1- Janë ata që realizojnë atë që quhet “përmbushje e detyrueshme e teuhidit”, e cila ka të bëjë me moscënimin e teuhidit nga çdo gjë e ndaluar (haram), siç janë: shirku i vogël, bidati (risia në fe) dhe gjynahet, krahas kryerjes së detyrave që urdhëron sheriati.

2- Ata që realizojnë atë që quhet “përmbushje e pëlqyer e teuhidit”, e cila konsiston te moscënimi i tij nga gjëra të urryera dhe të kritikuar, krahas kryerjes së adhurimeve vullnetare dhe veprave të pëlqyera.

MËSIMI I DYTË

THEMELI I AKIDES ISLAME DHE BURIMET REFERENCIALE TË SAJ

Themeli e akides islame është besimi në Allahun e Lartësuar, në engjëjt, në librat, në të dërguarit, në Ditën e Fundit dhe në kaderin e Allahut (paracaktimin dhe krijimin).

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët.” (El Bekare: 177)

Ndërsa Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i tha Xhibrilit kur u pyet për besimin: **“Të besosh në Allahun, në engjëjt, në librat, në të dërguarit, në Ditën e Fundit dhe të besosh në kaderin e Tij.”** (Muslimi)

➤ **Burimet referenciale të akides islame**

1- Burimet referenciale të akides islame janë: Libri i Allahut dhe Suneti i saktë (hadithet e sakta) i të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), si dhe konsensusi i të parëve tanë të mirë.

2- Çfarë ka ardhur e saktë nga Suneti i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) duhet të pranohet dhe të punohet me të, edhe nëse ka ardhur në formën *ehad*⁵. Ky është i argument pranueshëm në çështjet e akides.

3- Tekstet e shenjta: Kurani dhe Suneti janë themeli i akides islame. Këto duhen trajtuar ashtu siç i kanë trajtuar të parët tanë të mirë dhe gjithë ata që kanë ndjekur rrugën e tyre. Nuk lejohet kundërshtimi i teksteve të shenjta për shkak të interpretimeve gjuhësore apo për arsye të tjera.

⁵ Lajmi me vetëm një zinxhir të saktë transmetimi.

4- I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ka shpjeguar plotësisht dhe qartësisht të gjitha parimet e fesë. Nuk i lejohet askujt të sjellë risi në fenë e Allahut. Besimtari i dorëzohet Allahut me gjithë qenien e tij: në dukje dhe në brendësi. Ai nuk kundërshton asgjë nga Libri i Allahut dhe tradita profetike në asnjë formë: as me analogji, as me “zbulim” dhe as me fjalën e ndonjë dijetari apo imami etj.

5- Logjika e shëndetshme pajtohet me tekstin e shenjtë e të saktë; kurrsesi nuk mund të bien ndesh këto të dyja. Në rast se iluzionohet se mes tyre ka konflikt (duket sikur ato bien ndesh me njëra-tjetrën), atëhere i jepet përparësi tekstit të shenjtë.

6- Në akide duhen respektuar fjalët dhe shprehjet e miratuara nga sheriatu, duke i shmangur ato që kanë shpikur njerëzit. Fjalët dhe shprehjet e paqarta kanë dy mundësi interpretimi: interpretimi ose është i gabuar, ose është i saktë. Për shembull, kur flasim për cilësitë e Allahut, *mutekelimunët* (skolastikët) përdorin fjalë të tilla, si: *xhihatullah* - drejtimi nga është Allahu, *el xhismu* – trupi etj. Kur dikush vjen me të tilla fjalë apo shprehje, ne e pyesim për kuptimin e tyre; nëse kuptimi i tyre është i vërtetë, atëhere i pranojmë; nëse nuk është i vërtetë, i refuzojmë.

7- Vetëm Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është i pagabueshëm; po ashtu ymeti islam - në terësinë e tij - është i pagabueshëm⁶. Ndërkaq, individë të veçantë të ymetit mund të gabojnë. Në rastin kur imamët, dijetarët apo njerëzit e thjeshtë të ymetit kanë mospajtime për diçka, ata duhet t'i referohen Librit të Allahut dhe Traditës së Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Pas kësaj, pranohet fjala e atij që mbështetet në argument nga Kurani dhe Suneti; ndërkaq, të tjerëve nuk u pranohet. Natyrisht, vlerësohet

⁶ Është e pamundur që gjithë muslimanët të pajtohen me diçka të padrejtë apo të gabuar. (shën. përkth.)

mundi dhe përpjekja e dijetarëve të ymetit, përderisa ata nuk kundërshtojnë konsensusin e të parëve tanë të mirë.

8- Në ymet ka besimtarë të devotshëm e të inspiruar, si p.sh. Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Ëndërra e mirë e njerëzve të mirë është hak (e vërtetë), është pjesë e Profecisë. Islami çmon mendjemprehtësinë, urtësinë dhe mençurinë njerëzore; po ashtu vlerëson *kerametet*⁷ dhe përgëzimet, që u jepen njerëzve të devotshëm, me kusht që ato të mos bien ndesh me sheriatin. Mirëpo ato nuk janë burim apo referencë e akides dhe sheriatit islam.

9- Debati për çështjet e fesë është i qortuar. Mirëpo kur ai bëhet me mirësjellje, është i ligjëruar. Besimtari distancohet nga çdolloj polemike që e ka ndaluar sheriatin. Muslimani nuk duhet të zhytet në këto lloj debatesh; nuk i lejohej të flasë për gjëra rreth të cilave nuk ka dije. Për diçka që nuk e di, duhet të shprehet: “Allahu i Gjithëdijshëm e di më së miri.”

10- Edhe në rastin kur debati është i pashmangshëm, besimtari duhet t’i përmbahet metodës së Kuranit dhe Sunetit. Në këtë metodë duhet të besojë dhe atë duhet ta zbatojë. Nuk mund të kundërshtohet bidati me bidat; as liberalizmi me ekstremizëm; dhe as e kundërta nuk duhet të ndodhë.

11- Çdo gjë e shpikur në fe është bidat; çdo bidat çon në humbje dhe çdo devijim nga rruga e Allahut ka për vendmbërritje Zjarrin (Allahu na ruajttë prej tij!).

⁷ Janë ndodhitë e jashtëzakonshme, me të cilat Allahu i nderon evlijatë (miqtë e Tij), duke qenë se ata janë ndjekës besnikë të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

MËSIMI I TRETË

SHEHADETI “LA ILAHE ILA ALLAH”

Kuptimi i Shehadetit “La ilahe ila Allah” është: Nuk ka të adhuroar tjetër me të drejtë përveç Allahut. Allahu është i Vetmi që e meriton adhurimin; askush tjetër përveç Tij nuk meriton të adhurohet.

Shehadeti ka dy shtylla:

Shtylla e parë: mohimi i adhurimit të të tjerëve në vend të Allahut; këtë e përmban pjesa e parë e shehadetit **“La ilahe”**.

Shtylla e dytë: pohimi i adhurimit të Allahut, i Cili është i Adhuruari i Vërtetë; këtë e përmban pjesa e dytë e shehadetit **“ila Allah”**.

➤ **Nënçështje: Nuk mjafton thjesht artikulimi i shehadetit “La ilahe ila Allah”**

Musliman i vërtetë është ai që e thotë shehadetin **“La ilahe ila Allah”** duke ia ditur kuptimin; punon dhe vepron sipas kërkesave të tij. Besimtari distancohet nga shirku dhe ka besim të palëkundur në njësinë e Allahut, duke qenë i bindur plotësisht se nuk ka tjetër të adhuroar me të drejtë përveç Allahut; pastaj vepron duke iu përmbajtur të gjitha kushteve⁸ të kësaj dëshmie.

Kush vepron sipas kësaj dëshmie pa besuar në të, konsiderohet

⁸ Kushtet e fjalës LA ILAHE IL-LA ALLAH: 1. Dituria e cila mohon injorancën. 2. Siguria e plotë e cila mohon gënjeshtëri. 3. Singëriteti i cili mohon shirkun. 4. Thënia e së vërtetës e cila përjashton gënjeshtëri. 5. Dashuria e cila mohon urrejtjen. 6. Zbatimi i të gjitha shtyllave duke përjashtuar lënien e diçkaje prej tyre. 7. Pranimi i cili mohon refuzimin dhe mohimi i gjithçkaje që adhurohet përveç Allahut. (shënim i redaktorit)

munafik-hipokrit.

Kush beson në kundërshtim me të dhe bie në shirk, konsiderohet *mushrik* – **idhujtar**, edhe nëse e shpreh atë me gojë.

MËSIMI I KATËRT

SHIRKU I MADH DHE SHIRKU I VOGËL

➤ **Shirku i madh:**

Shirku i madh: do të thotë që t'i shoqërohet Allahut ortak në diçka që i përket vetëm Atij: në *rububije*, në *uluhije*, në *esmau ue sif*, si dhe në veprat e Tij. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Betohemi për Allahun, ne kemi qenë njëmend në humbje të qartë, kur ju kemi barazuar me Zotin e botëve.” (Esh-Shuara: 97-98)

Argument tjetër është hadithi që përcjell Ibn Abasi, i cili na tregon se një burrë hyri tek Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe i tha: “Çfarë dëshiron Allahu dhe ti.” Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ia ktheu atij: **“A më bërë mua të barabartë me Allahun?! Përkundrazi, thuaj: ‘Çfarë dëshiron vetëm Allahu.’”** (Transmeton Nesaiu me zinxhir transmetimi hasen - të mirë)

- **Nënçështje: Shirku i madh** është barazimi i krijesave me Allahun, Zotin e botëve, siç e sqaruar nëpërmjet argumenteve të mësipërme. Pra, në shirk të madh bie çdokush që i shoqëron Allahut ortak, duke e madhëruar atë siç madhërohet Allahu apo mbështetet tek ai në vend të Allahut, apo beson se ai ka ndikim në drejtimin dhe komandimin e botës e të tjera gjëra të ngjashme me këto. Nuk është kusht vënia e shenjës së barazimit në çdo

drejtim; përkundrazi, shirk i madh konsiderohet barazimi i krijesës me Krijuesin qoftë edhe në një apo në disa aspekte të veçanta, që i përkasin vetëm Krijuesit.

- **Nënçështje:** Kur njeriu e barazon Krijuesin me krijesat në çështje që i përkasin vetëm Krijuesit, dhe këtë e realizon jo përmes bindjes e besimit, por nëpërmjet mënyrës së të shprehurit, ky bie në **shirk të vogël**. Për shembull: shirk i vogël është betimi për dikë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, sikurse përcillet nga Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) se Umer bin Hatabi (i ati i Ibn Umerit) u betua për babain e tij, ndërsa Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha: **“Sigurisht që Allahu jua ka ndaluar që të betoheni për baballarët tuaj. Kushdo që betohet, le të betohet për Allahun ose të heshtë.”**(Muslimi)

Shirku i madh është gjynahu më i madh; pra, është më i madhi ndër gynahet e mëdha.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Padyshim idhujtaria është padrejtësi shumë e madhe.”
(Lukman: 13)

Për këtë arsye, Allahu i Lartësuar ka caktuar dënime të mëdha për ata që bëjnë këtë gjynah të madh. Prej këtyre dënimeve, më të rëndësishmet janë këto në vijim:

1- **Allahu nuk e fal shirkun e madh vetëm nëse njeriu pendohet**, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë.”(En-Nisa: 48)

2- **Shirku i madh e nxjerr njeriun nga feja**. Gjaku dhe pasuria e

atij që bie në shirk të madh nuk janë të shenjta.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Kur të kalojnë muajt e shenjtë (në të cilët ndalohet lufta), atëherë i vritni idhujtarët kudo që t’i ndeshni, i zini robër, i rrethoni dhe u bëni pusi kudo!” (Et-Teube: 5)

3- Allahu nuk ia pranon asnjë vepër atij që bie në shirk të madh; të gjitha veprat e tij asgjesohen dhe bëhen hi e pluhur, nëse ai nuk pendohet. Allahu i Lartësuar thotë për idhujtarët:

“Dhe Ne do t’u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t’i shndërrojmë në pluhur e hi.” (El Furkan: 23)

4- Muslimanes nuk i lejohet të martohet me idhujtarin; gjithashtu, edhe muslimanit nuk i lejohet të martohet me idhujtaren, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

“Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse kjo e fundit mund t’ju pëlqejë. Mos i martoni muslimanet me paganë, gjersa të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t’ju pëlqejë.”(El Bekare: 221)

5- Kur idhujtari vdes, nuk lahet, nuk qefinoset dhe nuk i falet namazi i xhenazes. Ai nuk varroset në varrezat e muslimanëve, por i hapet një gropë dhe varroset larg varreve të tyre.

6- Kush bie në shirk të madh dhe vdes pa u penduar, do të mbetet përjetësisht në zjarrin e Xhehenemit. Atij i ndalohet përgjithmonë hyrja në Xhenet.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Sigurisht, atij që adhuron tjetërkënd përveç Allahut, Allahu do t’ia ndalojë Xhenetin dhe strehim i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës.” (El Maide: 72)

➤ **Shirku i vogël**

Shirk i vogël janë fjalët dhe veprat (prej gjynaheve më të mëdha) që sheriati islam i quan “shirk”, teksa tekstet e shariatit tregojnë se ato nuk arrijnë nivelin e shirkut të madh, sepse nuk e asgjesojnë terësisht teuhidin dhe nuk e nxjerrin njeriun nga feja. Shembuj të shirkut të vogël janë: shtirja, betimi për dikë tjetër përveç Allahut etj.

➤ **Gjykimi për shirkun e vogël :**

1- Shirku i vogël nuk ka dispozitat e shirkut të madh, në asnjë nga çështjet e përmendura më sipër.

2- Shirku i vogël është prej gjynaheve të mëdha, madje është prej gjynaheve më të mëdha. Ai vjen direkt pas gjynaheve që e nxjerrin njeriun nga Islami.

3- Ky shirk mund të shtohet e të zmadhohet, derisa njeriu bie në gjynahun e shirkut të madh, i cili e nxjerr nga feja.

4- Për personin që bie në shirk të vogël, dijetarët ndajnë mendime të ndryshme. Shumica e dijetarëve thonë se ky njeri në Ditën e Gjykimit do të jetë në dëshirën e Allahut: ose e fal, ose e dënon.

5- Shpërblimi i veprës, e cila është e molepsur me shirk të vogël, asgjesohet. Të tilla vepra janë: shtirja apo rasti kur nëpërmjet adhurimeve njeriu synon të përfitojë nga të mirat e kësaj bote. Argument për këtë është fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili na tregon se Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Unë jam më i Panevojshmi ndaj shirkut. Kush bën një vepër duke Më shoqëruar ortak, do ta braktis atë dhe shirkun (veprën) e tij.”**

➤ **Mësim i dobishëm**

Askush nuk mund të jetë i sigurt (imun - i ruajtur) nga shirku. Prandaj Ibrahim (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) i lutej Allahut, siç na e tregon Allahu në Kuran:

“Më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!”
(Ibrahim: 35)

MËSIMI I PESTË

KUFRI⁹

➤ **Llojet e kufrit janë dy: Kufri i madh dhe kufri i vogël**

Kufri i madh

Llojet e kufrit të madh janë shumë, ndër më të rëndësishmet përmendim: kufri i përgënjeshtimit, kufri që ka të bëjë me ligjëvënien, duke lejuar atë që ka ndaluar Allahu, kufri i mendjemadhësisë dhe refuzimit, kufri i mospërfilljes dhe indiferentizmit, kufri i dyshimit, duke dyshuar në diçka që ka ardhur sheriati islam.

Kufri i madh shfaqet nëpërmjet besimeve të gabuara, po ashtu edhe nëpërmjet fjalëve dhe veprave që e nxjerrin njeriun nga Islami, edhe nëse ato nuk shoqërohen me besime të gabuara.

➤ **Sa i përket gjykimimit për kufirin e madh, është i njëjtë si për shirkun e madh.**

Siç e përmendëm më sipër, llojet e kufrit të madh janë shumë, por në vijim po shpjegojmë në mënyrë mjaft të përmbledhur shtatë lloje:

1- Kufri i përgënjeshtimit: Në këtë lloj kufri bie çdokush që përgënjeshton diçka nga parimet e fesë apo ligjet e saj; ose përgënjeshton diçka që na ka njoftuar feja me argumente kategorike, plotësisht të sakta dhe autentike.

2- Kufri i dyshimit: Do të thotë hezitimi dhe të qenurit dyshues në diçka që është prej parimeve të fesë, për të cilat ka dakortësi absolute; ose dyshimi në vërtetësinë e ndonjë lajmi

⁹ Mohimi dhe mbulimi i së vërtetës. (shën. përkth.)

apo rregulli që njihet si apriori fetare.

3- Kufri i refuzimit dhe mëndjemadhësisë: Në këtë lloj kufri bie njeriu që është i vetëdijshëm për vërtetësinë e fesë, i beson parimeve të Islamit dhe ligjeve të tij (i beson ato me zemër dhe këtë besim e shpreh me gojë), mirëpo ai refuzon zbatimin e ligjeve dhe rregullave të shariatit, nuk i përulet dhe nuk i nënshtrohet Allahut, për shkak të mëndjemadhësisë dhe inatit.

Braktisja e namazit, nga shkujdesja apo dembelizmi, bën pjesë në këtë lloj kufri.

4- Kufri i urrejtjes: Kush urren fenë islame apo diçka prej saj, ka bërë kufër, duke urreyer të vërtetën – Islamin. Kjo, sepse Islami është feja e Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar thotë:

“Kjo për shkak se ata e urrejnë atë që ka shpallur Allahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre.” (Muhamed: 9)

5- Kufri i indiferentizmit. Ky lloj kufri ka dy nënndarje:

E para: Indiferentizmi që e çon njeriun në kufër: i tillë është rasti kur ai e braktis fenë e Allahut dhe i kthen shpinën asaj, teksa e bën këtë me zemër, me gjuhë dhe me gjymtyrë; ose i beson kësaj feje me zemër dhe e shpreh shehadetin me gojë, mirëpo nuk punon me gjymtyrë: edhe kjo përfshihet në refuzimin që çon në kufër.

Kjo nënndarje e kufrit të indiferentizmit shfaqet në dy forma:

E para: është refuzimi total i urdhrave të Allahut, pra, nuk do t'i dëgjojë këto urdhra dhe nuk do t'i bindet Allahut, siç është rasti i jobesimtarëve, të cilët kanë mbetur në fetë e tyre të devijuara.

E dyta: është rasti kur njeriu nuk do të zbatojë asnjë rregull a dispozitë të shariatit islam, ndonëse i ka pranuar ato me zemër, i njeh mirë shtyllat e besimit dhe e artikulon shehadetin. Ky nuk mund të quhet musliman, sepse nuk i

zabton ligjet e fesë dhe i injoron rregullat e saj; nuk vepron asgjë nga detyrat që ka urdhëruar sheriati islam: as nuk falet, as nuk agjëron, as nuk e kryen haxhin dhe nuk bën asnjë detyrë fetare. Një njeri i tillë konsiderohet *qafir* (mohues, heretik), pra ka rënë në kufrin e madh. Gjithashtu, nuk quhet musliman ai që refuzon disa nga dispozitat e shariatit islam, siç p.sh. e refuzon namazin dhe tregohet indiferent ndaj tij, duke mos e kryer atë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaju: ‘Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!’ Në qoftë se kthejnë shpinën, (dijeni se) Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.” (Al Imran: 32)

E dyta: Indiferentizmi e mospërfillja që nuk arrin cakun e kufrit, siç është rasti kur muslimani braktis disa nga detyrat e shariatit (përveç namazit), ndërsa të tjerat i kryen. Pra, disa i kryen dhe disa jo, si p.sh. nuk e nxjerr zekatin apo nuk agjëron në muajin e Ramazanit, por detyrat e tjera fetare i realizon.

6- Kufri i nifakut (hipokrizisë): Kemi për qëllim nifakun në besim: Kur njeriu shfaq besimin dhe fsheh në zemrën e tij kufrin.

Ky lloj kufri ka dy nëndarje:

E para: Nifaku i madh apo nifaku i besimit: Kur njeriu shfaq besimin dhe fsheh të kundërtën e tij, kufrin. Munafikët janë në gjendjen më të keqe ndërmjet jobesimtarëve. Allahu i Lartësuar thotë:

“Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrsesi nuk do t’u gjesh atyre ndihmës.” (En-Nisa: 145)

E dyta: Nifaku i vogël: Kur njeriu shfaq diçka të ligjshme, ndërkaq fsheh diçka të ndaluar, që bie në kundërshtim me atë që shfaq.

Kufri i vogël

Kufër i vogël është ai që burimet e sheriatit islam - Kurani dhe Suneti - e kanë quajtur kufër, por nuk arrin në cakun e kufrit të madh, si p.sh. luftimi i muslimanit. Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) përcjell se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: **“Sharja e muslimanit është fisk - shmangie nga bindja ndaj Allahut, dhe luftimi kundër tij është kufër.”(Buhariu dhe Muslimi) Një formë tjetër e shfaqjes së kufrit të vogël është dhe përcmimi i njerëzve për shkak të prejardhjes, sikurse përcillet prej Ebu Malik el Eshariut (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Katër gjëra në ymetin tim kanë mbetur nga koha e injorancës: mburra me farefisën, përcmimi i të tjerëve për shkak të prejardhjes, kërkimi i rreshjeve përmes yjeve dhe vajtimi i të vdekurit.”** (Buhariu) Ka dhe shfaqje të tjera të kufrit të vogël.**

KAPITULLI II

IBADETI DHE FORMAT E SHFAQJES SË SHIRKUT NË TË

- Mësimi i parë: Përkufizimi i ibadetit
- Mësimi i dytë: Dy kushtet e ibadetit
- Mësimi i tretë: Llojet e ibadetit
- Mësimi i katërt: Shtirja
- Mësimi i pestë: Kur nëpërmjet veprave të mira njeriu synon të përfitojë nga kjo botë

MËSIMI I PARË:

PËRKUFIZIMI I IBADETTIT

Ibadeti (adhurimi) është një term gjithëpërfshirës për çdo gjë që Allahu e do dhe është i kënaqur me të, qofshin këto fjalë apo vepra, të dukshme apo të padukshme, si p.sh.: frikërespekti ndaj Allahut, mbështetja e sinqertë tek Ai, namazi, zekati, agjërimi e të tjera detyra fetare.

Gjithashtu është thënë se **ibadeti** është përukje e nënshtrim ndaj Allahut të Lartësuar, nëpërmjet zbatimit të urdhrave të Allahut dhe të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), si dhe duke hequr dorë apo duke u larguar nga çdo gjë që Allahu dhe i Dërguari i Tij e kanë ndaluar, në kërkim të kënaqësisë së Allahut dhe Xhenetit të Tij.

Ibadeti ka në themel të vet nënshtrimin absolut ndaj Allahut dhe dashurinë absolute ndaj Tij.

MËSIMI I DYTË

DY KUSHTET E IBADETIT

Kushti i parë: përkushtimi me sinqeritet për Allahun e Lartësuar. Do të thotë që nëpërmjet ibadetit, robi duhet të ketë për qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut dhe jo të dikujt tjetër.

Allahu i Lartësuar thotë:

“E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të sinqertë.” (El Bejine: 5)

Kushti i dytë: duhet që ibadeti të jetë në përputhje të plotë me sheriatin e Allahut, që konsiston te ndjekja dhe pasimi me konsekuencë i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Adhurimi duhet të përputhet me sheriatin e Allahut të Lartësuar në aspektet e mëposhtme: në formë dhe përmbajtje, në sasi dhe cilësi, po ashtu në aspektin kohor dhe vendor; të gjitha këto duhet të jenë të miratuara nga sheriati islam. Argument për këtë është fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që e përcjell Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!): **“Kush bën një vepër që nuk i përket fesë sonë, ajo do t’i refuzohet.”** (Buhariu dhe Muslimi)

MËSIMI I TRETË

LLOJET E IBADETIT

Kur argumentet e sakta të shariatit pohojnë se vepra të caktuara janë ibadete (adhurime), nuk lejohet t'i kushtohen dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar. Nëse njeriu ia kushton këto ibadete dikujt tjetër përveç Allahut, ai bie në shirk të madh.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt krahas Allahut!” (El- Xhin: 18)

Gjithashtu përcillet nga Abdullah bin Mesudi se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Kush vdes duke iu lutur (adhuruar) dikujt tjetër përveç Allahut, do të hyjë në Zjarr.”** (Buhariu dhe Muslimi)

➤ *Llojet e ibadetit janë shumë, ndër më të rëndësishmet janë këto në vijim:*

Adhurimi i parë: Lutja, e cila është dy llojesh :

E para: Lutja në formë ibadeti: Në këtë lloj të lutjes bëjnë pjesë të gjitha veprat e mira (ibadetet), me të cilat adhurohet Allahu, si: namazi, zekati etj.

E dyta: Lutja në formë kërkese: Janë fjalë dhe shprehje me të cilat besimtari i drejtohet Allahut, duke i kërkuar diçka të dobishme ose për largimin e gjërave të dëmshme.

➤ **Lutja drejtuar dikujt tjetër përveç Allahut ndahet në disa lloje:**

Lloji i parë: Lutja është shirk i madh.

Kjo shfaqet në disa forma:

1- Kur i kërkon krijesës diçka që nuk ka mundësi ta realizojë vetëm se Allahu i Lartësuar, si p.sh.: kërkon prej krijesave të zbresin shi apo kërkon faljen e gjynaheve, e të tjera si këto. Këto kërkesa janë shirk i madh. Ai shfaqet edhe në mënyrën sesi e kërkon diçka: duke iu lutur krijesës me përlësi të plotë dhe dashuri absolute, me frikë dhe me shpresë; dhe me forma të tjera të adhurimeve, të cilat i kushtohen vetëm Allahut të Lartësuar. Edhe kjo mënyrë e lutjes është shirk i madh.

2- Kur i lutet dikujt që është larg, teksa ai nuk ia dëgjon lutjen. Edhe kjo formë është shirk i madh.

3- I lutet dikujt tjetër përveç Allahut, duke besuar se ai vetë ka mundësi t'ia realizojë kërkesën dhe jo Allahu i Lartësuar; ose beson se kjo krijesë është partner me Allahun e Lartësuar në plotësimin e nevojave të lutësit.

4- I kërkon të vdekurit shërimin e të sëmurëve apo largimin e së keqes, e të tjera si këto. Edhe kjo formë e lutjes është shirk i madh.

Lloji i dytë: Lutja është bidat, kur i kërkon Allahut të Lartësuar që t'ia plotësojë kërkesat apo nevojat për hir të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), apo për hir të ndonjë njeriu të mirë, apo për hir të ndonjë krijese tjetër.

Lloji i tretë: Kur i gjalli i lutet të vdekurit dhe kërkon prej tij të ndërmjetësojë tek Allahu i Lartësuar. Edhe ky lloj është shirk i madh.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Kurse ata që ju i adhuroni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa

cipa e bërthamës së hurmës. Nëse ju u luteni atyre, ata nuk e dëgjojnë lutjen tuaj, por edhe sikur ta dëgjonin, nuk do t'ju përgjigjeshin. Në Ditën e Kiametit, ata do ta mohojnë adhurimin që u bënit atyre. Askush nuk mund të të njoftojë ty (o Muhamed) ashtu si Ai që është i Gjithëdijshëm.”(Fatir: 13-14)

- **Nënçështje: Teuesuli** (kryerja e shkaqeve të lejuara që na afrojnë tek Allahu)
Kjo do të thotë që besimtari të përmendë në lutjen e tij diçka që është shkak për pranimin e lutjes.

Teuesuli ndahet në dy lloje: teuesuli i ligjëruar dhe teuesuli i ndaluar

Lloji i parë: Teuesuli i ligjëruar, i cili ka disa nënndarje:

1- Afrimi tek Allahu i Lartësuar nëpërmjet emrave dhe cilësive të Tij, sikurse thotë Allahu i Lartësuar:

“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrreni Atë (lutjuni Atij) me to.”(El A’raf: 118)

2- Afrimi tek Allahu i Lartësuar duke përmendur premtimin e Tij: se Ai i përgjigjet lutjeve të lutësve. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë:

“O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu!” (Ali Imran: 194)

3- Afrimi tek Allahu i Lartësuar duke përmendur gjendjen e tij, duke shfaqur nevojën për mëshirën e Allahut, dobësinë dhe hallin, siç është lutur Musai (Paqja e Allahut qoftë mbi të!):

“Zoti im, çfarëdo dhuntie që të më japësh, unë jam nevojtari!” (El Kasas:24)

4- Afrimi tek Allahu i Lartësuar nëpërmjet lutjes së ndonjë njeriu të mirë, që është gjallë, me shpresë se Allahu do t'ia pranojë lutjen atij (njeriut të mirë) dhe do t'i bëjë dobi lutësit.

Lloji i dytë i teuesulit: Teuesuli i ndaluar

Ja disa shembuj të këtij lloji:

1- I kërkon Allahut diçka në emër të Profetit apo të ndonjë robi të mirë, apo të Qabes etj.

2- Kur i lutet të vdekurve, të ashtuqajturve “njerëz të mirë”; iu lutet drejtpërdrejt atyre. Ky është shirk i madh.

3- I lutet Allahut në varre, tyrbe etj; pra i lutet Allahut të Lartësuar dhe e adhuron Atë në këto vende. Ky është shirk i vogël.

Adhurimi i dytë: Istianetu - kërkitimi i ndihmës

Allahu i Lartësuar thotë:

“Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”(El Fatiha: 5)

Adhurimi i tretë: Istigathetu- kërkitimi i shpëtimit

Kërkitimi i shpëtimit për të dalë nga ndonjë gjendje e vështirë, për të larguar ndonjë fatkeqësi a rrezik të madh. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ju kërkuat ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj.”(El Enfal: 9)

Adhurimi i katërt: Istiadhetu - kërkitimi i mbrojtjes

Kërkitimi i mbështetjes dhe përkrahjes nga ndonjë kërcënim a rrezik real, nga ndonjë gjë e keqe a diçka e dëmshme. Kjo do të thotë që të largohesh apo t'i shmangesh diçkaje të keqe, prej së cilës i frikësohesh, dhe të strehohesh te Ai (Allahu), tek i Cili

ndjen siguri, siç thotë Allahu i Lartësuar:

“Nëse djalli përpiqet të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.” (El A’raf: 200)

Istianetu, istigathetu dhe istiadhetu, që të gjitha këto, janë ibadete (adhurime). Gjykimi për to është njësoj si për lutjen, për të cilën folëm më sipër në mënyrë të detajuar.

Adhurimi i pestë: Dashuria

Dashuria është ibadet që duhet t’i kushtohet vetëm Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar thotë:

“Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa ç’i duan idhujtarët idhujt e tyre).” (El Bekare: 165)

Besimi është bindje, fjalë dhe vepër. Baza e besimit është ratifikimi (njohja dhe miratimi), ndërsa baza e veprave është dashuria.

➤ **Llojet e dashurisë:**

1- Dashuria për Allahun e Lartësuar: Është adhurimi më madhështor.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se sa i duan idhujtarët idhujt e tyre).”** (El Bekare: 165)

2- Dashuria për hir të Allahut: Kjo përmbledh çdo gjë që do Allahu i Lartësuar, si: njerëzit, veprat, kohët, vendet. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Duan t’u bëjnë më mirë mërgimtarëve.” (El Hashr: 9)

3- Dashuria mund të jetë shirk i madh, kur ajo i kushtohet dikujt tjetër përveç Allahut, duke e shoqëruar me përulje dhe madhërim, të cilat duhet t’i kushtohen vetëm Allahut të Lartësuar; apo e do ndonjë krijesë ashtu sikurse e do Allahun e Lartësuar. Allahut i Lartësuar thotë:

“E megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Atë dhe duke i dashur siç duhet Allahu.” (El- Bekare: 165)

4- Dashuria mund të jetë edhe shirk i vogël. Ky lloj i dashurisë ka disa nënndarje:

I tillë është rasti kur njeriu e lidh zemrën me të dashurin e tij në çdo gjë që e kënaq apo e zemëron atë. Njerëzit që e lidhin zemrën me pasurinë, Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i quajti **“robër të dinarit dhe të dirhemit”**. Pastaj i përshkoi ata duke thënë se **“kur u jepet pasuria, ata kënaqen; ndërsa kur privohen prej saj, zemërohen”**. (Buhariu)

Një nënndarje tjetër e kësaj lloji të dashurisë (shirk i vogël) është: **dashuria ekstreme**, si, p.sh., skajshmëria në dashurinë për të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) apo ndaj besimtarëve. Përcillet nga Ibn Abasi se ka dëgjuar Umerin (Kënaqësia e Allahut qoftë mbi të!) se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Mos më mbivlerësoni mua, siç vepruan të krishterët me të birin e Merjemes. Sigurisht që unë jam rob i Allahut. Kështu që për mua thoni ‘rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij’.”** (Buhariu)

Prej shirkut të vogël është edhe **teprimi në dashurinë e natyrshme**, si, p.sh., dashuria e skajshme për ndonjë njeri.

5- Dashuria e lejuar: Kjo është dashuri e natyrshme (ose natyrale), siç është dashuria për disa lloje ushqimesh apo dashuria për fëmijët etj. Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaj: ‘Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij.” (Et-Teube: 24)

➤ **Mësim i dobishëm:**

Dashuria, frika dhe shpresa janë ato që e lëvizin zemrën përpara drejt Allahut të Lartësuar. Sigurisht që shtytësi më i forte është dashuria.

Adhurimi i gjashtë: Frika

Frika është një ndër adhurimet më madhështore të zemrës.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Vetëm prej Meje duhet të frikësoheni” (El Bekare: 40)

➤ **Llojet e frikës:**

1- Frika e obliguar - detyrë

Zemra e besimtarit i frikësohet Allahut dhe dënimit të Tij. Kjo e motivon që të kryejë detyrat dhe të largohet nga gjërat e ndaluara. Allahu i Lartësuar thotë:

“Vetëm prej Meje frikësohuni, nëse jeni besimtarë!” (Ali Imran: 175)

2- Frika e pëlqyer

Kjo e motivon besimtarin të kryejë veprat e pëlqyera dhe të lërë veprat e urryera (të kritikuara) .

3- Frika që konsiderohet shirk i madh

Njeriu bie në shirk të madh kur frikësohet nga dikush tjetër veç Allahut, për gjërat që nuk mund t'i bëjë askush tjetër veç Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata të frikësojnë ty (o Muhamed) me zota të tjerë, përveç Tij.” (Ez-Zumer: 36)

Prej shirkut të madh është: t'i frikësohet dikujt tjetër përveç Allahut, ashtu siç i frikësohet Allahut të Lartësuar. Kjo është

frika e fshehtë. E tillë është frika prej të vdekurve në varr apo frika prej ndonjë njeriu “të shenjtë”. Pikërisht kjo lloj frike haset dhe vihet re tek ata që adhurojnë varret (tyrbet apo vendet e ashtuquajtura “të shenjta” a “të mira”) ose të ashtuquajturit “eulija”.

4- Frika që konsiderohet shirk i vogël

E tillë është ajo që ndikon në lënien e ndonjë adhurimi apo rënien në mëkat, nga frika e dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ka disa njerëz, që thonë: ‘Ne besojmë Allahun’. Por, kur vuajnë për çështjen e Allahut, e quajnë përndjekjen prej njeriut njësoj si dënimin e Allahut.” (El-Ankebut: 10)

5- Frika që konsiderohet bidat

Është ajo e bën njeriun pesimist dhe të dëshpëruar, duke ia humbur shpresën në mëshirën e Allahut dhe faljen e Tij.

6- Frika e natyrshme

Është frikë e lejuar dhe për të cilën njeriu nuk qortohet. Ai mund të dëmtohet nga gjëra që vërtet njihen si të dëmshme, si p.sh.: frika nga grabitqarët, nga zjarri etj. Allahu i Lartësuar na ka treguar në Kuran se Musai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kam frikë se do të më vrasin.”(Esh-Shuara: 14)

Frikacak quhet ai që frikësohet nga diçka prej së cilës zakonisht nuk mund të kihet frikë.

Adhurimi i shtatë: El Hashijetu - frikërespekti

Allahu i Lartësuar thotë:

“Por atyre mos iu frikësoni, frikësohuni vetëm prej Meje.”(El-Bekare:150)

El hashijetu është më specifike sesa *el haufu* - frika. Ajo është frikë e shoqëruar me njohje dhe dituri. Allahu i Lartësuar thotë:

“Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.”(Fatir: 28)

Adhurimi i tetë: Er-Rahbetu - paniku

Është frika që arrin cakun e panikut. Allahu i Lartësuar thotë:

“Vetëm prej Meje duhet të frikësoheni.” (El Bekare: 40)

Bera’a (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që ka thënë: **“O filan! Kur të shtrihesh për të fjetur në shtratin tënd thuaj: ‘O Zoti im, Ty ta dorëzoj veten time... deri tek fjala e tij: duke shpresuar e duke të pasur frikë Ty!’** (Buhariu dhe Muslimi)

Adhurimi i nentë: Er-Raxhau – shpresa:

Është besimi që ka njeriu për realizimin e diçkaje, përmbushja e së cilës është e mundshme, qoftë kjo e afërt apo e largët.

Adhurimi i dhjetë: Er-Ragbetu - ambicia

Është dëshira e fortë për të arritur një qëllim a synim të caktuar

Adhurimi i njëmbëdhjetë: Et-Teube - pendimi

Është ndjenjë keqardhjeje që i lind dikujt për një punë a veprim të gabuar që ka bërë; është kthimi nga gjynahu në bindjen ndaj Allahu të Lartësuar.

Sa i përket gjykimit për: *el hashijetu*, *er-rahbetu*, *er-raxhau* dhe *er-ragbetu*, është i njëjti si për frikën, të cilin e sqaruar më

parë.

Adhurimi i trembëdhjetë: Mbështetja tek Allahu

Mbështetja është prej adhurimeve të zemrës. T’i mbështetesh Allahut do të thotë: t’i dorëzohesh plotësisht Atij, t’i varësh shpresat tek Ai, për fitimin e të mirave dhe shmangien e të këqijave, qofshin ato të dynjasë apo të Ahiretit. E gjithë kjo realizohet përmes kryerjes së shkaqeve.

Mbështetja tek Allahu i Lartësuar është adhurim, që duhet t’i kushtohet vetëm Atij. Nuk lejohet që ky adhurim t’i kushtohet dikujt tjetër veç Tij.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Në qoftë se jeni besimtarë, atëherë mbështetuni tek Allahu!”** (El Maide: 23)

➤ **Mbështetja është tre lloje:**

1- Mbështetja vetëm tek Allahu i Lartësuar: Ky është adhurim i ligjëruar; është **prej adhurimeve më madhështore.**

2- Mbështetja tek dikush tjetër përveç Allahut për ato gjëra që janë ekskluzivitet i Allahut, të cilat nuk ka mundësi t’i kryejë vetëm se Allahu i Lartësuar. E tillë është mbështetja tek të vdekurit, duke iu kërkuar atyre faljen e gjynaheve apo shërimin e të sëmurëve. Ky është **shirk i madh.**

3- Mbështetja tek ndonjë krijesë që ka diçka në dorë dhe mund ta bëjë; kur mbështetet tek krijesa me një ndjenjë inferioriteti (si, p.sh., mbështetja tek sundimtari a drejtori, për sigurimin e mjeteve të jetesës apo për t’u mbrojtur). Ky veprim është **shirk i vogël.**

Ndërsa autorizimi nuk ka lidhje me çështjen për të cilën sapo flasim. Ky proces realizohet kur një person ngarkon a lejon dikë për të bërë një punë të caktuar¹⁰ në emër të tij, duke ia

¹⁰ P.sh. për shitjen apo blerjen e ndonjë malli etj.

deleguar kompetencat përfaqësuesit, ngase personi në fjalë nuk ka mundësi të jetë prezent vetë.

Adhurimi i katërbëdhjetë: Flijimi i kurbanit

Është një ndër adhurimet më madhështore.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurbanit im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.” (El - Enam: 162)

➤ **Llojet e flijimit (kurbanit):**

1- Therja e kurbanit si rit adhurimi - është afrimi tek Allahu nëpërmjet derdhjes së gjakut, si p.sh.: flijimi që bëhet për festën e Kurban Bajramit, *akika* - kurbanit që theret për fëmijën e sapolindur në shenjë falënderimi ndaj Allahut të Lartësuar etj.

2- Kurbanit që merr gjykimin e bidatit (ririsë në fe): Është flijimi që bëhet për t’u afruar tek Allahu nëpërmjet derdhjes së gjakut të kafshës me forma e mënyra që nuk kanë ardhur në shariat. Kjo konsiderohet risi në fe, sepse njeriu dëshiron të afrohet tek Allahu përmes flijimit të kurbanit me gjëra që nuk janë ligjzuar në shariatin islam, si p.sh.: therja e pulës a gjelit të detit në ditën e Kurban Bajramit, ose kur bën kurban në një vend të caktuar duke besuar se atje ka bereqet, si rasti i atij që ther kurban tek varri i ndonjë njeriu “të mirë” etj.

3- Kurbanit mund të jetë edhe shirk i madh, atëhere kur njeriu e flijon kafshën duke ia kushtuar dikujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar, siç është rasti i atij që nëpërmjet kurbanit dëshiron të afrohet tek xhindet, tek të vdekurit apo të gjallët etj.

4- Flijimi i kurbanit për ndonjë njeri të veshur me pushtet apo për njerëz të tjerë, për nder të tyre. Ky lloj ka disa nënndarje:

E para: Është shirk i madh, kur e flijon kurbanin për t’i

madhëruar këta njerëz. Ky ngjan me kurbanin që theret për idhujt.

E dyta: Është bidat, si në rastin kur dikush bën kurban në momentin që pranë atij kalon ndonjë njeri i rëndësishëm, në shenjë madhërimi për të, ndonëse ai e përmend emrin e Allahut.

5- Kurbanin konsiderohet vepër e ndaluar (haram), kur ai bëhet thjesht për të ngrënë, por në të ka shpërdorim.

Adhurimi i pesëmbëdhjetë: Vizita e varrezave

Kjo ndahet në tri lloje:

1- Vizitë e ligjëruar nga sheriatit:

Është vizita që bëhet për të përkujtuar Ahiretin ose për t'u bërë mirë të vdekurve, duke i përshëndetur ata me selam, ose i lutet Allahut dhe i kërkon Atij falje e mëshirë për ta.

Nëse realizohen këto dy qëllime, atëhere vizita është e ligjëruar, sipas rregullave të sheriatit.

2- Vizita e varrezave konsiderohet bidat (risi në fe), kur viziton varret, për ta adhuruar Allahun atje; apo për të kërkuar bereqet në to; apo kur dëshiron t'u dhurojë të vdekurve sevape përmes kësaj vizite. Gjithashtu nuk lejohen që varrezat të merren si vende adhurimi, as të ndërtohet mbi to, as të rrethohen dhe as të ndriçohen; sikurse nuk lejohet që të udhëtohet drejt tyre qëllimisht, vetëm për t'i vizituar ato. Këto dhe të tjera veprime janë të ndaluara nga sheriatit islam dhe nuk kanë asnjë bazë në fe.

3- Vizita e varrezave konsiderohet shirk, kur adhurimi u kushtohet të vdekurve (u lutet atyre, kërkon ndihmë prej tyre, flijon kurban për ta etj.), siç u sqarua më sipër.

➤ **Nënçështje:**

Shkaqet e rënies në shirk (idhujtari):

1- Madhërimi jashtë mase i njerëzve të mirë¹¹. Ky është shkak i parë dhe më i rrezikshmi, i cili i çoi njerëzit drejt shirkut të madh.

2- Madhërimi i varreve, ndërtimi mbi to, ndriçimi dhe rrethimi i tyre, ngritja i faltoreve mbi to, udhëtimi drejt tyre duke pasur si qëllim kryerjen e adhurimeve në to.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na tregon se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Allahu i mallkoi hebrejtë dhe të krishterët, sepse ata i morën varret e profetëve të tyre për vende adhurimi.”** (Buhariu dhe Muslimi)

3- Ngritja e statujave të frymorëve dhe pikturimi i tyre. Ebi Zura (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se ai bashkë me Ebu Hurejrën (Allahu qoftë i kënaqur me të!) hynë në një shtëpi medinase, ku gjetën një njeri që pikturonte frymorë. Ai (Ebu Hurejra) i tha se kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që ka thënë: **“Nuk ka më zullumqar se ai që tenton të krijojë sikurse krijon Allahu (t’i përngjasojë Allahut në krijim). Atëherë le të krijojë kokrrën ose farën, nëse mundet (por, ai kurrë nuk mund ta bëjë dot një gjë të tillë).”** (Buhariu)

¹¹ Për herë të parë, shirku u shfaq në popullin e Nuhut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kur e tepruan madhërimin e të devotshmëve. Ata pikturuan figurat e disa njerëzve të devotshëm (për të kujtuar adhurimin e tyre të madh ndaj Zotit). Mirëpo çështja nuk mbaroi me kaq. Pas njëfarë kohe ata filluan t’i adhuronin ata në vend të Allahut. Për këtë shkak, Allahu ua dërgoi atyre Nuhun (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për t’i thirrur në teuhid. (shënim i redaktorit)

➤ **Skulptura dhe pikturimi i frymorëve ndahet në dy kategori:**

E para: Është shirk i vogël, kur thjesht pikturon apo bën skulpturë.

E dyta: Është shirk i madh, kur synon që nëpërmjet pikturës a skulpturës t'i përngjasojë Allahut, të krijojë siç krijon Ai, apo diçka të ngjashme me krijimin e Allahut, apo ta rivalizojë Atë. Ose synon që nëpërmjet pikturës së tij, ta adhurojë atë (krijesën) në vend të Allahut të Lartësuar.

MËSIMI I KATËRT

SHTIRJA

Përkufizimi: Është vepra e mirë që bëhet për dikë tjetër përveç Allahut dhe zbulurimi i saj në sytë të njerëzve; ose shfaqja para të tjerëve si njeri i devotshëm, që ta lavdërojnë dhe të krijojnë respekt për të. Kjo mund të realizohet përmes fjalëve, veprave dhe paraqitjes së jashtme.

➤ **Llojet e shtirjes janë si vijon:**

E para: Kur shtirja është në thelb të besimit, që do të thotë se njeriu shfaq Islamin, por në zemrën e tij fsheh kufrin. **Ky është nifak (hipokrizi) i madh, që e nxjerr njeriun nga Islami.**

E dyta: Shtirja e tërësishme, në kuptimin që, **perms veprës së mirë, njeriu dëshiron vetëm të shtiret para të tjerëve**, për të përfituar diçka nga kjo botë, siç është rasti i munafikëve në namazin e tyre, për të cilët Allahu i Lartësuar thotë: **“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashtron. Kur ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak”** (En-Nisa: 142)

Për këtë namaz nuk ka shpërblim; kjo vepër asgjesohet. Kjo është shtirje e tërësishme. Nuk mund të imagjinohet që një besimtar të bëjë diçka të tillë kur falet apo agjëron, por kjo mund të ndodhë në adhurime të tjera, siç është sadakaja etj.

Mirëpo, nëse e rregullon njetin gjatë kryerjes së adhurimit, në kuptimin që: e nis një vepër të mirë, por e bën atë për t’u dukur në sy të njerëzve, pastaj e ndryshon qëllimin, duke dëshiruar të fitojë kënaqësinë e Allahut, në këtë rast, ai do ta marrë shpërblimin për sa kohë është i sinqertë në veprën e tij, nëse fundi i veprës nuk ka lidhje me fillimin, siç është sadakaja apo leximi i Kuranit.

Ndërsa kur ekziston një lidhje mes fundit dhe fillimit të veprës,

siç është namazi, në këtë rast, duhet ta përsërisë adhurimin, nëse ky adhurim është obligim.

E treta: Kur motivi për të kryer veprën e mire është shtirja, atëhere kjo vepër është e pavlefshme. Ebu Hurejra (Allahu goftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: **“Allahu i Lartësuar thotë: ‘Unë nuk kam nevojë aspak për ortakëri (dhe as për diçka tjetër, prandaj Unë nuk e pranoj një punë të tillë). Kush bën një vepër duke më shoqëruar Mua ortakë në të (duke pasur për qëllim dikë tjetër përmes kësaj vepre), Unë e lë atë dhe veprën (shirkun) e tij.”**(Muslimi)

E katërta: Kur në thelb vepra e mirë kryhet për hir të Allahut, pastaj molepset nga shtirja. Kjo ndodh në dy raste:

1- Kur njeriut i vijnë ngacmime të jashtme për t’u shtirur, por ai e urren shtirjen dhe i vë fre vesveseve. Kjo nuk e dëmton.

2- Kur atij i pëlqen shtirja dhe vazhdon në të, atëherë kjo vepër është tërësisht e infektuar me syfaqesi. Çdo vepër që molepset në shtirje, është e pavlefshme. I tillë është rasti kur fundi i veprës ka lidhje me fillimin e saj, siç është namazi dhe haxhi. Ndërsa kur nuk ka lidhje mes fundit dhe fillimit të veprës, si në rastin e leximit të Kuranit apo kur përmend Allahun, jep sadaka, përhap dijen, në të tilla raste, nuk është e pavlefshme e gjithë vepra, por, gjithsesi besimtari ka nevojë ta ripërtërijë nijetin e ta largojë shtirjen. Vepra që nuk shoqërohet me shtirje është e saktë.

E pesta: Kur shtirja vjen pas përfundimit të adhurimit. Nëse u flet njerëzve me mburrje për adhurimin që bën, atëhere ky veprim konsiderohet gjynah, është haram dhe shpërblimi për veprën e mirë pakësohet, por ajo nuk asgjesohet. Hudhejfja na tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Kush bën ndonjë vepër të mirë thjesht për t’u dukur te njerëzit, Allahu do ta turpërojë (në**

dynja dhe Ahiret).”(Buhariu dhe Muslimi)

E gjashta: Kur merr falënderime dhe lavdërime nga njerëzit, për shkak të veprave të mira që ai bën. Në lidhje me këtë, përmendim dy raste:

1- Kur gëzimi konsiderohet sihariq prej Allahut dhe është shenjë e pranimit të veprës. Në këtë rast nuk ka problem. Ebu Dherri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na përcjell se të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i kanë thënë: **“O i Dërguari i Allahut çfarë mendon për dikë që kryen vepër të mirë dhe njerëzit e lavdërojnë për këtë gjë?”** Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u përgjigj: **“Ky është shpërblim i përshpejtuar; vjen si sihariq (lajm i mirë) për besimtarin.”** (Muslimi)

2-Kur njeriu gëzohet thjesht se e lavdërojnë njerëzit për arritjet e tij, në këtë rast, kjo është shtirje dhe merr gjynah për këtë. Atij i pakësohet shpërblimi, por nuk i asgjesohet vepra e mirë.

➤ **Nënçështje: Kompensimi për shtirjen**

Shtirja shlyhet përmes pendimit tek Allahu i Lartësuar, duke thënë: “O Zoti im, unë kërkoj mbrojtje prej Teje që mos të të bëj shirk me vetëdije; dhe kërkoj falje prej Teje për atë që nuk di.” Për këtë, traseton Ebu Musa el Eshari se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Shirku tek ju është më i fshehtë sesa ecja e milingonës në errësirën e natës. A të të tregoj diçka të cilën nëse e bën Allahu, do ta largojë ty çdo gjë prej shirkut të vogël e të madh?! Thuaj: ‘O Zoti im, unë kërkoj mbrojtje prej Teje që mos të të bëj shirk me vetëdije; dhe kërkoj falje prej Teje për atë që nuk di!’”**

(Ahmedi dhe të tjerë)

MËSIMI I PESTË

KUR NËPËRMJET VEPRAVE TË MIRA NJERIU SYNON TË PËRFITJË NGA KJO BOTË

➤ **Kjo ndahet në disa lloje:**

Lloji i parë: Npërmjet Islamit ai kërkon vetëm të fitojë nga të mirat e kësaj bote. **Ky është shirk dhe nifak i madh.**

Lloji i dytë: Npërmjet adhurimit dëshiron të fitojë vetëm të mirat e kësaj bote, p.sh.: e kryen haxhin për të përfituar pasuri ose shkon në luftë për të fituar nga plaçka e luftës, ose kërkon dijen fetare për të marrë diplomë a për të bërë karrierë, duke u joshur nga posti e pozita; nëpërmjet këtyre veprave kurrsesi nuk do të fitojë kënaqësinë e Allahut. **E gjitha kjo është haram dhe konsiderohet prej gjynaheve më të mëdha; është shirk i madh dhe asgjeson veprat e mira që njeriu bën.**

Allahu i Lartësuar thotë: **“Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t’ua shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t’u lihet gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç Zjarrit. Do t’u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t’u zhvlerësohet ajo që kanë punuar.”** (Hud: 15-16)

Ebu Hurejra përcjell se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“I dështuar qoftë robi i dinarit (monedhë prej ari), i dështuar qoftë robi i dirhemit (monedhë prej argjendi), i dështuar qoftë robi i veshjes së bukur, i dështuar qoftë robi i petkut (veshje e sipërme me thekë)...”** (Buhariu)

Lloji i tretë: Npërmjet adhurimit dëshiron të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe dynjanë njëkohësisht, siç është rasti i atij që shkon në luftë për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe për të përfituar nga plaçka e luftës ose si ai i cili agjëron për të

fituar shpërblimin e Allahut dhe njëkohësisht për t'u kuruar. Sipas një mendimi: vepra e tij asgjesohet. Sipas një mendimi tjetër: nëse dominon qëllimi i ibadetit, atëhere vepra e tij është e saktë; dhe nëse dominon qëllimi i dynjasë, atëhere vepra e tij asgjesohet. Në çdo rast, shpërblimi i tij është i mangët, pra, nuk merr shpërblim të plotë. Transmetohet nga Abdullah bin Umeri se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Çdo luftëtari që del në luftë në rrugë të Allahut dhe merr nga plaçka e luftës që ka dëshiruar, i përshpejtohet dhënia e shpërbimit në këtë botë. Atij i jepet që në dynja 2/3 e shpërblimit të Ahiretit. Në Botën Tjetër i mbetet vetëm 1/3 e shpërblimit. Ndërkaq, nëse nuk merr asgjë nga plaçka e luftës, ai do ta marrë shpërblimin e plotë në Ahiret.”** (Muslimi)

Lloji i katërt: E fillon adhurimin duke dëshiruar të mirat e kësaj botë, mirëpo pastaj e ndryshon nijetin dhe kërkon shpërblimin e Allahut. Kur adhurimi është njësi e vetme: i përbërë nga pjesë të pandashme nga njëra-tjetra, fundi i të cilit ka lidhje me fillimin, si në rastin e namazit, atëherë i gjithë namazi asgjesohet, bëhet i pavlefshëm. Kur adhurimi ndahet në pjesë, që nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën, në kuptimin që pjesa e parë është e pasaktë dhe tjetra e saktë, në këtë rast, nuk asgjesohet i gjithë adhurimi, por vetëm ajo pjesë që është molepsur me dëshirën për të përfituar nga të mirat e kësaj bote.

Lloji i pestë: Kur motivi kryesor është të fitojë shpërblimin e Allahut, dhe pastaj të fitojë nga të mirat e kësaj bote, teksa fitimi i të mirave të kësaj bote është dytësor. Kjo është e lejuar.

Allahu i Lartësuar ka thënë:

“E u thashë: “Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t’ju dërgojë shi të bollshëm, t’ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!” (Nuh:

10-12)

Lloji i gjashtë: Kur njeriu e kryen adhurimin me sinqeritet të plotë, pastaj dëshiron diçka nga të mirat e kësaj bote, si rasti i tre personave që mbetën të izoluar në Shpelle¹², të cilët i

¹² Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: Kam degjuar Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) duke rrëfyer: “Tre veta nga popujt para jush u nisën në një udhëtim. Nata i zuri tek një shpellë dhe hynë në të për t’u strehuar. Ndërkaq ra një shkëmb nga mali dhe u bllokoi grykën e shpellës. Atëherë, i thanë njëri-tjetrit: ‘Nuk ju shpëton gjë tjetër nga kjo shpellë vetëm nëse do t’i luteni Allahut me punët e mira që keni bërë.’

Kështu, njëri prej tyre tha: ‘O Allah! Për respekt ndaj prindërve që i kisha të moshuar, nuk i jepja qumësht për të pirë as familjes dhe askujt tjetri para tyre. Por një ditë u lagova shumë duke kullotur bagëtitë dhe nuk arrita t’i kthej në vathe veçse pasi kishin fjetur. Sapo arrita mola bagëtitë që qumshtin t’ua jepja atyre për të pirë, por i gjeta në gjumë. Ngaqë nuk më pëlqente t’i jepja për të pirë as familjes e askujt tjetër para tyre, vazhdova të qëndroja me gotën e qumshtit në dorë, duke pritur zgjimin e tyre, deri në agim. (Disa transmetues ka shtuar: Ndërkohë që fëmijët ulërinin duke qarë nga uria te këmbët e mia). Kështu, u zgjuan dhe pinë qumshtin e mjelur për ta që në mbrëmje. O Allah! Nëse e kam bërë këtë punë për të fituar kënaqësinë Tënde, largoje këtë shkëmb që na ka bllokuar daljen nga gryka e kësaj shpelle.’

U hap disi (gryka e shpellës), por nuk mund të dilnin.

Tjetri tha: ‘O Allah kam patur një vajzë xhaxhai, e cila ishte njeriu më i dashur tek unë. Kërkova ta joshja për marrëdhënie të paligjshme me të, por ajo refuzoi. Derisa kur e goditi zia dhe mjerimi i një thatësire, erdhi për të kërkuar dhe unë i dhashë njëqind e njëzet dinarë (monedha floriri) me kusht që të më linte të kryeja marrëdhënie intime me të. Ajo pranoi dhe kur m’u dha mundësia për marrëdhënie me të, ajo tha: ‘Mos ma prish virgjërinë; kjo nuk është e drejtë.’ Atëherë, nga frika prej pasojave të gjynahut e përmbajta veten prej marrëdhënieve të paligjshme, edhe pse e kisha tepër të vështirë. Kështu, u largova prej saj, megjithëse ajo ishte njeriu më i dashur për mua dhe ia lashë floririn që i dhashë. O Allah! Nëse e kam

kërkuan Allahut të Lartësuar t'i shpëtonte dhe t'i nxirrte nga kjo vështirësi, për shkak të veprave të sinqerta që kishin bërë për hir të Tij. **Kjo lejohet, mirëpo shpërblimin e merr vetëm për atë vepër të cilën e ka kryer me sinqeritet.**

bërë këtë punë për të fituar kënaqësinë Tënde, na e hap grykën e kësaj shpelle.' U hap sërish pak shkëmbi, por prapë nuk mund të dilnin prej saj.

I treti tha: 'O Allah! Mora në punë disa punëtorë. Pasi e kryen punën, çdonjërit prej tyre i dhashë pagën e vet, përveç një personi, i cili e la hakun e punës dhe shkoi. Unë i investova paratë e tij dhe prej tyre shtua shumë pasuria. Pas njëfarë kohe ai erdhi dhe më tha: - O rob i Allahut, më jep pagën time! - I thashë: Çdo gjë që shikon janë paga jote: devetë, lopët, bagëtitë dhe skllëvërit! – O rob i Allahut, mos u tall me mua! – tha ai. – Nuk po tallem me ty! – i thashë, – Merri, janë të tuat. Kështu, i mori të gjitha dhe nuk la asgjë. O Allah! Nëse e kam bërë këtë punë për të fituar kënaqësinë Tënde, na e hap grykën e kësaj shpelle. Shkëmbi u largua nga gryka e shpellës dhe dolën ata dolën jashtë saj.' (Buhariu dhe Muslimi)

KAPITULLI III

IMANI (BESIMI) DHE SHTYLLAT E TIJ

- Mësimi i parë: Përkufizimi i besimit
- Mësimi i dytë: Lidhja ndërmjet Imanit dhe Islamit
- Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit

MËSIMI I PARË

PËRKUFIZIMI I BESIMIT

Imani (besimi) është bindje dhe siguri e fortë në zemër, pohim me gojë dhe veprim me gjymtyrë; shtohet përmes veprave të mira e nënshtrimit ndaj Allahut dhe pakësohet për shkak të gjynaheve. Prej argumenteve që e qartësojnë se të gjitha elementet e lartpërmendura janë pjesë e qenësishme e besimit është fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!): **“Imani është besimi në Allahun, në engjëjt, në librat e Tij, në të dërguarit e Tij...”** (Buhariu); gjithashtu edhe ky hadith i transmetuar po nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!): **“Imani (besimi) ka 70 e ca degë; dega më e lartë është fjala “La ilahe ila Allah”, ndërsa më e ulta është largimi i pengesave nga rruga. Turpi është degë e besimit.”** (Buhariu dhe Muslimi)

Besimi shtohet dhe pakësohet; argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua forcuar besimin, krahas besimit që patën. Të Allahut janë ushtritë e qiejve dhe të Tokës; Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë” (El Fet’h: 4)

Në këtë kontekst vjen edhe fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për gratë: **“Nuk kam parë (qenie) më të mangëta në arsyetim dhe në fe sesa gratë, të cilat arrijnë t’ia marrin mendjen edhe burrit më të vendosur!”** (Buhariu)

Ndjekësit e Traditës Profetike besojnë se besimi ndahet në degë, dhe se ai nuk është një njësi e vetme. Veprat janë shtyllë e besimit, por jo të gjitha janë të tilla. Gjithashtu besojnë se njeriu që bie në gjynahe të mëdha është musliman, për shkak të besimit që ka në zemër, por njëkohësisht ai konsiderohet i

shturur për shkak të gjynaheve të mëdha në të cilat ka rënë.

Në këtë çështje, kanë devijuar dy grupe:

1- Huarixhët. Këta i konsiderojnë të gjitha veprat shtyllë të besimit; në varësi të ekzistencës apo mungesës së tyre (veprave) ekziston apo mungon edhe vetë besimi.

2- Murxhiat. Sa i përket qëndrimit që mbajnë ndaj çështjes së besimit, këta klasifikohen në disa kategori:

Kategoria e parë: Murxhitë ekstremistë, siç janë xehmijtë dhe ata që përkrahin idetë e tyre. Sipas tyre, besimi kufizohet thjesht në njohjen e Allahut të Lartësuar.

Kategoria e dytë: Murxhitë fukaha¹³, sipas të cilëve: besimi është fjalë që pohohet me gojë dhe bindje e siguri e fortë në zemër. Këta bien dakort me ndjekësit e Traditës Profetike, sepse besojnë se Allahu i kërcënon mëkatarët dhe ka përgatitur ndëshkim për ta. Gjithashtu ata thonë se prej atyre që bien në gjynahe të mëdha ka nga ata që do të hyjnë në Zjarr, por nuk do të banojnë përjetësisht në të.

Kategoria e tretë: Shumica e esharinjve, të cilët pohojnë se besimi është thjesht bindje e siguri e fortë në zemër.

Kategoria e katërt: Keramitë, sipas të cilëve: besimi është thjesht pohim me gojë.

Kategoria e pestë: Maturiditë, sipas tyre: besimi është bindje e siguri e fortë në zemër, ndërsa pohimi me gojë është shtyllë shtesë e besimit dhe nuk ka lidhje me origjinën e tij. Kjo do të thotë se njeriu nuk bie në kufër, kur i cënon parimet e besimit me gojë, për shkak të imponimit apo detyrimit.

Sa i përket çështjes së shtimit dhe pakësimit të besimit, ndjekësit e Traditës Profetike kanë kundërshtarë dy grupe:

¹³ Murxhitë që i përkasin kastës së juristëve islam.

1-Murxhitë, të cilët pohojnë se besimi as nuk shtohet, as nuk pakësohet.

2-Huarixhët dhe mtezilitë, të cilët pohojnë se besimi vetëm shtohet, nuk pakësohet.

MËSIMI I DYTË

LIDHJA NDËRMJET ISLAMIT DHE IMANIT

Kur në një tekst të shenjtë të vetëm (nga Kurani dhe Suneti) përmenden Islami dhe Imani (të dyja së bashku), atëhere secili prej tyre ka kuptimin e vet të veçantë: Islami përfshin të gjitha veprat e dukshme, ndërsa Imani përfshin të gjitha veprat e fshehta. Kur ndonjëri prej tyre (Islami apo Imani) përmenden veçmas, atëhere në të përfshihet e gjithë feja.

MËSIMI I TRETË

SHTYLLAT E IMANIT (BESIMIT)

Shtylla e parë: Besimi në Allahun e Lartësuar

➤ **Besimi në Allahun e Lartësuar përfshin katër çështje:**

E para: Besimi në ekzistencën e Allahut. E vërteta më e madhe në këtë botë është: ekzistenca e Allahut të Lartësuar, i Cili është Zoti i Vetëm dhe i pashoq.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Kjo është kështu, sepse Allahu është e Vërteta (i Vetmi që meriton të adhurohet), kurse gjithçka që adhurohet përveç Tij, është e pavërteta. Dhe, pa dyshim, Allahu është më i Lartësuari dhe i Madhërishmi.” (El Haxh: 62)

Për ekzistencën e Allahut të Lartësuar dëshmojnë:

1- *Fitra*¹⁴, e cila është një argument i pakundërshueshëm që dëshmon për ekzistencën e Allahut. Njeriu lind me besim. Në brendësinë e tij ekziston një instikt natyral, aftësi e lindur dhe shtysë e vetvetishme, që e bën të ndjejë dhe të kuptojë ekzistencën e Krijuesit të tij pa u menduar dhe pa e mësuar atë nga të tjerët. Allahu i Lartësuar thotë: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** (Er-Rum: 30)

Ndërsa Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Çdo fëmijë lind në gjendjen e natyrshmërisë (fitra). Pastaj prindërit e shndërrojnë në hebre, të krishterë ose zoroastrian.”** (Buhariu dhe Muslimi)

¹⁴ Besimi natyral me të cilin njeriu vjen në jetë.

2- Mendja (arsyeja dhe logjika e shëndetshme) është një tjetër fakt që vërteton ekzistencën e Allahut të Lartësuar. Një mendje e shëndetshme, e cila nuk ndikohet nga dyshimet dhe pasionet, është e ndriçuar me bindje e siguri absolute se gjithë krijesat e kanë një Krijues, që i ka sjellë në jetë. Sigurisht ato nuk mund të krijojnë veten (apo njëra-tjetrën) dhe nuk mund të gjenden rastësisht në këtë botë.

Allahu i Lartësuar thotë:

“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos janë ata krijues të vetvetes?!” (Et-Tur: 35)

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë : **“Çdo fëmijë lind në gjendjen e natyrshmërisë (fitra). Pastaj prindërit e tij e shndërrojnë në hebre, të krishterë ose zoroastrian.”** (Buhariu dhe Muslimi)

3- Argumenti i shqisave. Edhe shqisat dëshmojnë gjithashtu për ekzistencën e Allahut. Vetë realiteti i njerëzve dhe gjendja e tyre janë dëshmi e pakontestueshme. Ne dëgjojmë dhe jemi dëshmitarë të pranimit të lutjeve të njerëzve të përveuajtur; për shkak të lutjeve të sinqerta, të pikëlluarve u largohen brengat e mundimet. Këto janë fakte të pakontestueshme dhe të vërteta të pamohueshme, që dëshmojnë për ekzistencën e Allahut të Lartësuar. Allahu i Lartësuar ka thënë për Nuhun (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): **“Kështu, ai iu lut Zotit të vet: ‘Unë jam i mundur, andaj më ndihmo!’ Dhe Ne i hapëm dyert e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm dhe i shpërthyem burimet e tokës, e u takuan ujërat për një qëllim të paracaktuar. Ndërsa Nuhun e bartëm në një barkë (të ndërtuar) prej dërrasash dhe gozhdësh, e cila lundronte nën Sytë Tanë: si shpërblim për atë (Nuhun a.s.) i cili u mohua.”** (El Kamer: 10-14)

4- Argumentet e shariatit (argumenti fetar). Kurani i Madhërishtëm (dhe të gjitha librat hyjnorë) faktojnë

ekzistencën e Allahut. Profecitë tashmë të realizuara, besimi i drejtë, ligjet dhe rregullat e vendosura në dobi të njerëzimit dhe për përsosjen e moralit të njerëzve, të gjitha këto, dëshmojnë se janë vendosur nga një Zot, i Cili ka urtësi dhe dituri për interesat jetësore të krijesave të Tij. Edhe informacionet për universin, që i dëshmon vetë realiteti, vërtetojnë se ato (librat hyjnorë) janë prej një Zoti të Gjithëfuqishëm, i Cili e bën realitet gjithçka që dëshiron.

Allahu i Lartësuar thotë:

“A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.” (En-Nisa: 82)

E dyta: Besimi në teuhidin rububije . Do të thotë: Njësimi i Allahut, duke pasur bindje të sigurt se Ai është Zoti i gjithësisë, Krijuesi, Sunduesi dhe Komanduesi i tij (universit).

Allahu i Lartësuar thotë:

“Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar Allahu, Zoti i botëve!” (El A'raf: 54)

Er-Rabu, në gjuhën arabe, vjen në disa kuptime: Zotëriu, Sunduesi dhe Komanduesi, i Cili, me mëshirën, mirësitë dhe begatitë e Tij kujdeset për gjithë botën.

➤ **Rububija sillet reth tre çështjeve:**

1- Krijimi: Allahu është Krijuesi i gjithçkaje. Çdo gjë tjetër përveç Tij është krijesë.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje.” (Ez-Zumer: 62)

2- Sundimi: Allahu është Sunduesi dhe çdo gjë tjetër përveç

Allahut është nën pushtetin e Tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

“A nuk e di ti se vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës? Përveç Allahut ju nuk keni tjetër mbrojtës e as ndihmës.”(El Bekare: 107)

3- Komandimi: Vetëm Allahut i përket urdhërimi dhe komandimi; çdo gjë tjetër përveç Tij është e urdhëruar dhe e komanduar.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaju (o Muhamed!): ‘Të gjitha janë në dorë të Allahut!’
(Ali Imran: 154)

➤ **Ligjet e Krijuesit dhe Sunduesit të Lartësuar janë gjithëpërfshirëse;** ato përfshijnë:

1- Ligjet e universit

Sa i përket ligjeve të universit, Allahu rregullon çdo gjë në univers; çdo gjë i nënshtrohet Atij dhe asgjë nuk del jashtë pushtetit e sundimit të Tij. Ai vendos çfarë dëshiron në gjithësi, ashtu sikurse e kërkon urtësia e Tij.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj ‘Bëhu!’ - dhe ajo bëhet.” (Ja Sin: 82)

2- Ligjet e fesë

Sa i përket ligjeve të fesë, Allahu ka ligjëruar një shariat të drejtë (ligjet e fesë dhe rregullat fetare), ashtu siç e kërkon urtësia e Tij. Gjithsesi, njeriu është lënë i lirë të zgjedhë mes besimit e mosbesimit, mes zbatimit të fesë ose moszbatimit të saj.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve!” (Et-Tekuir: 28-29)

Cilësitë e tjera të rububijes të Allahut të Lartësuar, si p.sh.: furnizimi, sjellja e krijesave në jetë, marrja e shpirtave të tyre etj., të gjitha këto, i referohen tre çështjeve të lartpërmendura (krijimit, sundimit dhe komandimit).

Besimi në rububijen e Allahut të Lartësuar është instaluar në qenien e njeriut (është e ngulitur në natyrshmërinë e krijimit të tij). Gjithsesi, edhe në këtë aspekt, ka njerëz të devijuar, por nuk janë shumë. Një pjesë e tyre kanë rënë në shirk (duke i përshkruar Allahut ortakë në rububije), si p.sh. të krishterët, të cilët besojnë në “Trinitet”; gjithashtu edhe një pjesë e idhujtarëve arabë, të cilët besonin se zotat e tyre u sillnin dobi, shkaktonin dëm apo rregullonin çështjet e jetës së tyre.

E treta: Besimi në teuhidin uluhije. Do të thotë: **Njësimi i adhurimit vetëm për Allahun; besimi me bindje e siguri të plotë se vetëm Allahu është i Adhuruari i Vërtetë; vetëm Ai e meriton adhurimin. Ai nuk ka ortakë apo partnerë në adhurim.**

Allahu i Lartësuar thotë:

“Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm të Më adhurojnë.” (Edh-Dharijat: 56)

Gjithashtu Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur se: ‘S’ka zot tjetër përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!” (El Enbija: 25)

Sikurse thotë i Lartësuari: **“Për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve!”** (Et-Tekuir: 28-29)

Për shkak të teuhidit uluhije¹⁵ janë dërguar profetët, për shkak të këtij lloji të teuhidit janë armiqësuar me popujt e tyre. Teuhidi uluhije është realiteti i fesë islame.

E katërta: Besimi në teuhidin esmau ue sifat

Teuhidi esmau ue sifat është besimi në gjithçka që ka ardhur e saktë në tekstet e sheriatit për emrat dhe cilësitë e Allahut, duke i pohuar ato që ka pohuar Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!); dhe gjithashtu duke i mohuar ato emra dhe cilësi që Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i kanë mohuar.

➤ ***Rregullat që zbatojnë ndjekësit e Traditës Profetike për emrat e bukur të Allahut dhe cilësitë e Tij të larta janë:***

1. Rregulli për pohimin e emrave dhe cilësive. Ndjekësit e Traditës Profetike pohojnë çdo gjë (emra dhe cilësi) që ka pohuar Allahu për Vetën në Librin e Tij apo e ka pohuar nëpërmjet të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ashtu siç i shkon përshtat Madhështisë së Tij, pa i ndryshuar, pa i mohuar, pa i përshkruar dhe pa i krahasuar.

2. Rregulli për mohimin. Ndjekësit e Traditës Profetike mohojnë gjithçka (emra e cilësi) që Allahu e ka mohuar për Vetën në Librin e Tij ose ka mohuar i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në këtë mënyrë ata

¹⁵ Njësimi i adhurimit vetëm për Allahun, duke ia kushtuar të gjitha adhurimet vetëm Atij.

mohojnë çdo të metë e mangësi që i atribuohet Allahut, duke besuar në përsosmërinë e emrave dhe cilësive të Tij. Pra mohojnë cilësitë e mangëta dhe pohojnë të kundërtën e tyre, që janë cilësitë e përkryera e të përsosura.

3. Rregulli për emrat dhe cilësitë për të cilat nuk ka argumente pohuese e as mohuese, dhe për të cilat njerëzit kanë rënë në mosmarrëveshje, si p.sh.: *el xhismu* (trupit), *el xhihatu* (drejtimi) etj. Këto as nuk i pohojmë dhe as nuk i mohojmë, por, sa i përket kuptimit të tyre, kërkojmë sqarim. Nëse u jepet kuptimi i gabuar, i refuzojmë; dhe nëse u jepet kuptimi i drejtë, i pranojmë, duke iu përmbajtur me përpikmëri rregullave të shariatit.

➤ **Cilësitë e Allahut ndahen në dy lloje:**

1- Cilësi *dhatije* - të Qenies (atributet e Individualitetit të Allahut). Këto janë attribute të pandashme prej Allahut, me të cilat ka qenë e do të jetë vazhdimisht i cilësuar. Nuk mund të imagjinohet kurrë shkëputja e tyre nga Qenia e Tij, si p.sh.: dija, fuqia etj.

2- Cilësitë *fi'lije* - të veprimit (atributet e veprimeve të Allahut). Janë ato që varen nga dëshira e Allahut. Nëse Ai dëshiron diçka, vepron; nëse Ai nuk dëshiron, nuk vepron. Për shembull: lartësia mbi Arsh, zbritja në qiellin e dynjasë etj.

Janë edhe **cilësitë *haberije*** - atributet lajmëruese, njohëse, si p.sh.: Fytyra, dy Duart, dy Sytë etj.

➤ **Kur pohojmë cilësitë e Allahut, duhet të ruhem i ndaluar nga gjëra rreptësisht të ndaluara:**

1- *Tahrifi* (ndryshimi). Nuk lejohet të ndryshohet fjala nga kuptimi i saj i drejtpërdrejtë pa ndonjë argument.

2- *Tatili* (mohimi). Nuk lejohet mohimi i emrave dhe cilësive të cilat i ka pohuar Allahu i Lartësuar.

Mohimi ndahet në dy lloje:

Lloji i parë: Mohimi tërësor, siç është mohimi i xhehmijeve, të cilët i refuzojnë të gjitha emrat dhe cilësitë e Allahut të Lartësuar.

Lloji i dytë: Mohimi i pjesëshëm, siç është mohimi i esharinjëve, të cilët refuzojnë një pjesë të cilësive të Allahut dhe i interpretojnë ato ndryshe.

3- Tekifi - dhënia formë e cilësisë ose përshkrimi i mënyrës sesi është ajo, si fjala e dikujt: *“Dora e Allahut ka këtë apo atë formë.”*

4- Temthili (përngjasimi) është besimi që cilësitë e Allahut u përngjasojnë cilësive të krijesave, si p.sh. ai që thotë se Dora e Allahut është si dora e njeriut.

Mundet që *tekifi* të shoqërohet me *temthil*, si p.sh. ai që thotë se zbritja e Allahut të Lartësuar është në këtë formë a atë formë, duke e përngjasur p.sh. me zbritjen e shiut. I Lartësuar është Allahu nga çdo mangësi dhe e metë! Pra, në këtë rast ka bërë bashkë *tekifin* dhe *temthilin*.

➤ **Disa cilësi që Allahu i Lartësuar i ka pohuar në Librin e Tij dhe Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshinmbi të!) i ka pohuar në hadithe të sakta:**

1- Lartësimi i Allahut mbi krijesat e Tij, i cili ndahet në dy lloje: lartësimi i Qenies dhe lartësia cilësive. Sa i përket lartësisë së cilësive të Allahut, besojmë se të gjitha cilësitë e Tij janë më të lartat, më të përsosurat e më të përkryerat. Për lartësimin e Qenies së Allahut, theksojmë se Allahu është i Lartësuar i mbi të gjitha krijesat e Tij. Për këtë dëshmon Libri i

Allahut, Tradita Profetike dhe *fitra*¹⁶. Prej këtyre argumenteve përmendim fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Ata i frikësohen Zotit të tyre lart mbi ta dhe bëjnë atë, që u urdhërohet.” (En-Nahl: 50)

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur mbajti Fjalimin e Lamtumirës, me të cilin iu drejtua muslimanëve në ditën e Arafatit, në fund të ligjëratës së tij tha: **“Kur ju të pyeteni për mua, çfarë do të thoni?”** Ata thanë: “Dëshmojmë se ti e çove në vend amanetin, e kryeve misionin dhe e këshillove ymetin.” Pastaj Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ngriti gishtin tregues në drejtim të qiellit. Ndërkaq, të gjithë njerëzit e panë dhe e dëgjuan duke thënë tri herë: **“Allahume sh’hed - O Zot, dëshmo për këtë.”** (Muslimi)

2- Lartësimi mbi Arsh

Allahu i Lartësuar thotë:

“Në të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor.” (El A’raf: 54)

Në kuptimin që: Allahu u ngrit dhe u lartësua mbi Arsh ashtu si i takon Madhërisë, Madhështisë dhe Përsosmërisë së Tij absolute. Ai është absolutisht i Lartësuar në çdo aspekt të Qenies së Tij. Ai është i Lartësuar mbi të gjitha qeniet dhe i ndarë prej tyre; kurrësi nuk mund të përngjasojë me krijesat e Tij. Prej argumentave të Traditës Profetike është hadithi që transmeton Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) cili përcjell se, kur Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) përmendi *shefaetin*¹⁷, tha :**“Unë do të arrij në derën e**

¹⁶ Natyrshmëria e krijimit të njeriut.

¹⁷ Ndërmjetësimi në Ditën e Kiametit.

Xhenetit dhe ajo hapet para meje. Pastaj do të shkoj tek Zoti im i Lartësuar, i Cili qëndron mbi Fronin e Tij dhe i përulem Atij në sexhde, vendos ballin mbi tokë.”

3- Cilësia e të folurit

Allahu i Lartësuar ka folur, flet dhe vazhdon të flasë me dëshirën dhe vullnetin e Tij, kur dëshiron dhe si dëshiron. E folura e Tij është e vërtetë, me shkronja dhe me zë. Zërin e Tij e dëgjojnë krijesat që Ai do. Fjalët e Allahut të Lartësuar janë fjalë të vërteta. Ai flet ashtu siç i shkon përshtat Madhërisë dhe Madhësisë së Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

“Sa i takon Musait, Allahu i ka folur atij drejtpërdrejt.” (En-Nisa: 164)

➤ KURANI

Kurani është fjala e Allahut. Fjalët e Kuranit nuk u përngjasojnë fjalëve të krijesave. Kurani është një Libër që e ka zbritur Allahu i Lartësuar, është shpallje prej Tij, nuk është i krijuar. Fillimisht Allahu ka folur me Kuran; Librin e Tij ia shpalli Xhibril Eminin (Besnikut), i cili e zbriti Shpalljen e Allahut në zemrën e Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në mënyrë graduale, pak nga pak, të ndarë pjesë-pjesë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhamed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e Allahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë.” (Et-Teube: 6)

Kur njerëzit e lexojnë Kuranin apo e shkruajnë në Mus’hafe, apo e memorizojnë në mendjet e tyre, të gjitha këto, nuk e nxjerrin nga konteksti i tij, nga të qenit fjalë e vërtetë prej Allahut, sepse Kurani është fjala e Allahut. Allahu e ka shpallur Kuranin dhe Atij i atribuohet. Kurani është fjala e Allahut; Allahu ka folur realisht. Ky Libër nuk i atribuohet atij që e lexon

apo e përcjell. Leximi, shkrimi dhe memorizimi janë produkte njerëzore; ndërsa Kurani, nga fillimi deri në fund, i gjithi është fjalë e Allahut të Lartësuar, i Cili ka folur realisht ashtu siç i shkon përshtat Madhësisë së Tij.

4- Fytyra

Është një prej cilësive të Qenies së Allahut të Lartësuar. Kjo cilësi është pohuar në Kuran, në Traditën e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe në konsensusin e të parëve tanë të nderuar. Allahu i Lartësuar thotë:

“Çdo gjë që është në Tokë, do të zhduket, e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhëri dhe Nderim.”
(Er-Rahman: 26-27)

5- Dy Duart

Allahu ka dy Duar të vërteta ashtu siç i shkojnë përshtat Madhësisë së Tij. Duart e Tij nuk iu përngjasojnë duarve të krijesave.

Allahu i Lartësuar i drejtohet shejtanit të mallkuar me këto fjalë:

“Zoti tha: ‘O Iblis, ç’të pengoi ty të mos përuleshe në sexhde para atij që e kam krijuar Vetë me duart e Mia? A mos u bërë mendjemadh apo mendon se je nga të lartët?’” (Sad: 75)

6- Shikimi i Allahut

Besimtarët do ta shikojnë Zotin në Ditën e Kiametit qartësisht me sytë e tyre duke mos e përfshirë gjithë Qenien e Tij.

Besimtarët do ta shikojnë Zotin e tyre në dy momente:

Momenti i parë: Në Mahsher në Ditën e Kiametit.

Momenti i dytë: Kur të hyjnë në Xhenet.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë, dhe Zotin e tyre do të shohin.” (El Kijame: 22-23)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Ju do ta shikoni Zotin tuaj (në Ditën e Kiametit) ashtu siç shihni Hënën në natën, kur ajo është e plotë (bedër). Nuk do të ngushtoheni e nuk do të hasni vështirësi në shikimin e Tij.”** (Buhariu dhe Muslimi)

- **Gjykimi për ata që mohojnë ndonjë nga cilësitë të Allahut të Lartësuar, të pohuar në Librin e Tij dhe në Sunnetin e të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)**

Ata që mohojnë ndonjë nga cilësitë të Allahut të Lartësuar, bëjnë pjesë në njëren prej kategorive të mëposhtme, ku për secilën ka gjykim specifik:

Kategoria e parë: Ai i cili e mohon një cilësi të ardhur në formë kategorike përmes një teksti të shenjtë (në Kuran ose në hadith autentik), teksa nuk ka ndonjë dileme që mund të deformatojë kuptimin e tekstit, por ky e mohon cilësinë nga inati ose nga dashakeqësia, ose ka ndonjë sëmundje në zemër, ose përpiqet ta kundërshtojë të Dërguarin e Allahut, pasi i është bërë qartë e vërteta. Një njeri i tillë, **konsiderohet qafir (jobesimtar).**

Kategoria e dytë: Kur dikush që mohon një cilësi është në kërkim të së vërtetës, njihet si i drejtë e dashamirës, mirëpo gabon dhe e keqinterpreteton tekstin e shenjtë; ose nuk e njeh fare atë, ose nuk arrin ta konceptojë drejt. **Ky është i justifikuar; i falet gjynahu.**

Kategoria e tretë: Ai që mohon një cilësi duke ndjekur dëshirat

e veta, teksa shfaq mangësi në kërkimin e së vërtetës dhe flet pa dije, por nuk ka për qëllim të kundërshtojë Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). **Ky është gjynahqar, por mund të konsiderohet edhe *fasik*¹⁸.**

Shtylla e dytë: Besimi në engjëjt

Engjëjt janë krijesa që i përkasin botës së padukshme. Ata e adhurojnë Allahun e Lartësuar me përkushtim absolut; nuk kanë asgjë prej veçorive hyjnore. Allahu i Lartësuar i krijoi nga drita. Allahu i bëri të bindur e të devotshëm, plotësisht të dorëzuar e të nënshtruar ndaj Tij, si dhe i pajisi me fuqi për zbatimin e urdhrave të Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata që janë tek Ai (engjëjt), nuk ngurrojnë për ta adhuruar Atë e nuk ndiejnë lodhje, por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë.” (El Enbija: 19-20)

➤ **Besimi në engjëjt përfshin katër çështje:**

E para: Besimi në ekzistencën e tyre.

E dyta: Besimi i detajuar në engjëjt të cilëve ua kemi mësuar emrat në tekstet e shenjta (nga Kurani dhe Suneti), si p.sh. Xhibrili (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). **Gjithashtu besimi i përgjithshëm në engjëjt që nuk ua dimë emrat.**

E treta: Besimi në engjëjt që ua njohim cilësitë.

E katërta: Besimi në engjëjt të cilëve ua njohim detyrat që kryejnë, të urdhëruar nga Allahu i Lartësuar¹⁹.

¹⁸ Njeri i prishur.

¹⁹ Xhibrili është i ngarkuar ta transmetojë Shpalljen nga Allahu tek ata të cilët Allahu dëshiron nga Pejgamberët. Mikaili është i ngarkuar për shiun dhe për bimët. Israfili është i ngarkuar që t'i fryjë Surit në Ditën e Gjykimit dhe në kohën e Ringjalljes. Meleku i vdekjes është i ngarkuar për marrjen e shpirtave në kohën e vdekjes. Meleku i

Shtylla e tretë: Besimi në librat

Kemi për qëllim librat që Allahu i Lartësuar ia zbriti të dërguarve të Tij, si mëshirë dhe udhëzim për krijesat, që përmes tyre të arrijnë lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë).”
(El Hadid: 25)

kodrave është i ngarkuar për kodrat. Maliku është roja e Xhehenemit. Ka prej melekëve që janë të ngarkuar për embrionin njerëzor në mitër. Disa të tjerë i ruajnë njerëzit. Disa i shkruajnë veprat e tyre. Çdo individ i ka dy melekë. Thotë Allahu i Lartësuar: **“Dhe kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. Dhe ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.”** (Kaf: 17-18) Disa melekë janë të ngarkuar ta pyesin njeriun. Pasi të varroset, do t’i vijnë dy melekë dhe do ta pyesin: “Kush është Zoti yt? Cila është feja jote? Kush është Profeti yt?” Për këtë Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu i forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët Allahu i bën të humbur. Allahu punon çka të dojë.”** (Ibrahim: 27) Disa melekë janë të ngarkuar për banorët e Xhennetit. Thotë Allahu i Lartësuar: **“Do t’i vizitojnë engjëjt, duke hyrë në secilën derë. (U thonë) ‘Selamun alejkum. Me durimin tuaj, gjetët shpëtimin. Sa përfundim i lavdishëm është ky vend!’** (Er-Rad: 23-24) (Shkeputur nga libri “Besimi i grupit të shpëtuar”, Shejh Muhammed Salih el Uthejmin)

➤ **Besimi në librat përfshin katër çështje:**

E para: Besimi i sigurt se të gjitha librat janë shpallje prej Allahut të Lartësuar, janë fjalë e Tij.

E dyta: Besimi në librat që ua njohim emrat, siç është Kurani, që iu shpall Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

E treta: Besimi në lajmet e sakta të këtyre librave.

E katërta: Zbatimi i ligjeve, rregullave, dispozitave dhe i gjithçkaje që nuk është shfuqizuar, duke i pranuar me kënaqësi, me bindje, dorëzim dhe nënshtrim absolut, sidoqoftë i kuptojmë apo jo urtësitë e tyre. Besimi se të gjithë librat e mëparshëm janë shfuqizuar nga Kurani i madhërishtëm.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre.” (El Maide: 48)

➤ **Teurati dhe Ungjilli kanë pësuar ndryshime.** Hebrenjtë dhe të krishterët i kanë ndryshuar librat e Allahut, të cilat u janë zbritur. Ata i tjetërsuan këto libra, shtuan dhe pakësuan në to. Librat që ata kanë sot në dorë (Teurati dhe Ungjilli) janë të shumtë (në versione të ndryshme). Teurati i sotëm nuk është ai që i ka zbritur Musait (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Gjithashtu Ungjilli i sotëm nuk është Ungjilli që i ka zbritur Isait (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ajo çfarë ka mbetur e saktë prej këtyre librave është shfuqizuar nëpërmjet Kuranit, kurse pjesa tjetër është e ndryshuar, e pavërtetë.

Shtylla e katërt: Besimi në të dërguarit e Allahut të Lartësuar

Allahu ka zgjedhur prej njerëzve *resulë* - profetë, të cilëve ua ka besuar Shpalljen e Tij, dhe i ka urdhëruar që t'ia përcjellin njerëzve. Profeti i parë është Nuhu (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe i fundmi i tyre është Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne të frymëzuar ty (o Muhamed) me shpallje, ashtu siç frymëzuar me shpallje Nuhun dhe profetët pas tij.”(En-Nisa: 163)

Në Sahihun e Buhariut transmetohet hadithi i *shefaetit* (ndërmjetësimi) nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Ndër të tjera, në këtë hadith përmendet se njerëzit shkojnë tek Ademi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe i kërkojnë të ndërmjetësojë për ta, ndërsa ai nuk pranon duke u justifikuar. Pastaj u thotë të shkojnë tek Nuhu (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), sepse ai është i pari profet, i dërguar nga Allahu i Lartësuar. Dhe e përmend hadithin deri në fund.

Sa i përket dallimit ndërmjet *resulit* (profetit) dhe *nebijit* (lajmëtarit), thuhet se *resuli* është ai të cilin Allahu i Lartësuar e ka dërguar me shariat të posaçëm tek populli i tij, ndërsa *nebijji* nuk vjen me shariat të ri, por i shpallet shariati i *resulit* para tij, për ta ripërtërirë atë.

Profetët janë krijesa (qenie njerëzore). Ata nuk kanë asgjë prej veçorive dhe cilësive hyjnore. Allahu i Lartësuar thotë për Muhamedin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

“Thuaj: ‘Unë nuk mund t’i sjell vetes as dobi, as dëm, përveçse aq sa dëshiron Allahu. Sikur ta dija të padukshmen, do t’i shumoja të mirat dhe nuk do të më prekte asnjë e keqe. Unë jam vetëm paralajmërues dhe sjellës i lajmeve të mira

për njerëzit që besojnë." (El A'raf: 188)

Allahu e ka dërguar çdo profet tek populli i vet, përveç Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilin e dërgoi për mbarë njerëzimin, dhe jo vetëm, por edhe për xhindët; pra, e dërgoi te dy më të rëndësishmit: njerëzit dhe xhindët.

Allahu i dërgoi profetët tek njerëzit si përgëzues dhe paralajmërues, që ata të realizojnë qëllimin e ekzistencës së tyre në tokë, i cili është: adhurimi i Allahut të Lartësuar, pa i shoqëruar Atij asnjë ortak. Secili prej tyre e kreu amanetin dhe e realizoi misionin që i ngarkoi Zoti. Allahu i ndihmoi ata me mrekulli, si prova të pakontestueshme, në mënyrë që njerëzit të besonin. *Resulët* (profetët) janë më lart sesa *enbijatë* (lajmëtarët). Gjithashtu Allahu i dalloi profetët ndërmjet tyre; një pjesë prej tyre i ngriti mbi të tjerët. Profetët më të mirë janë pesë. Ata quhen *ulul azmi* - profetët durimtarë e të vendosur, të zgjedhur e të dalluar. Ata janë: Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), Nuhu, Ibrahim, Isai dhe Musai. Më i miri prej tyre - madje krijesa më e mirë e Allahut - është vula e profetëve, i Dërguari ynë, Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) pas të cilit nuk ka profet tjetër.

➤ **Besimi në profetët përfshin katër çështje:**

E para: Besimi se ata të gjithë janë të dërguar prej Allahut.

Kush mohon apo përgënjeshton qoftë edhe njërin prej tyre, i ka mohuar dhe përgënjeshtuar të gjithë.

Allahu i Lartësuar thotë:

"Populli i Nuhut, i quante gënjeshtarë të dërguarit." (Esh-Shuara: 105)

E dyta: Besimi në ata që ua dimë emrat, si: në Muhamedin, Ibrahimin etj. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ne lidhëm besën me ty (o Muhamed) siç bëmë me profetët e tjerë: me Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, të birin e Merjemes. Ne lidhëm me ata një besë solemne.” (El Ahzab: 7)
Ndërkaq, sa u përket të dërguarve që nuk ua njohim emrat, i besojmë përgjithësisht. Allahu i Lartësuar thotë:

“Edhe para teje (o Muhamed) Ne kemi nisur të dërguar, për disa prej të cilëve të kemi treguar ty e për disa të tjerë nuk të kemi treguar.” (El Gafir: 78)

E treta: Besimi në lajmet autentike që kanë ardhur prej tyre.

E katërta: Zbatimi i sheriatit të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që është dërguar tek ne. Ai është Muhamedi, vula e profetëve, i Dërguari për mbarë njerëzimin.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (En-Nisa: 65)

Gjithashtu duhet të zbatojmë çfarë ka ardhur e saktë prej ligjeve të popujve të mëparshëm, të cilat nuk janë abroguar (shfuqizuar) nga sheriatu ynë.

Të gjithë profetët pajtohen në bazat e fesë, si p.sh.: në teuhidin, në profecinë, në ringjalljen dhe në të gjitha shtyllat e besimit, që janë: besimi në Allahun, në engjëjt, në librat, në të dërguarit e Tij, në Ditën e Gjykimit dhe në Kaderin e Tij.

Ndërsa legjislacionet e profetëve të mëparshëm kanë qenë të ndryshme: në formë, sasi, kohë dhe llojet e adhurimeve, por jo në përmbajtjen e tyre.

Shtylla e pestë: Besimi në Ditën e Fundit

Ajo është Dita e Kiametit (Dita e Gjykimit), në të cilën Allahu do t'i ringjallë njerëzit, do t'i marrë në llogari dhe do t'i shpërblejë ose ndëshkojë.

➤ **Besimi në ditën e Fundit përfshin tre çështje:**

E para: Besimi në Ringjalljen. Sigurisht që të gjithë të vdekurit do të ringjallen, kur t'i fryhet Surit për herë të dytë. Atëhere njerëzit do të dalin para Zotit të botëve. Ata do të jenë të zbatuar, të zhveshur dhe të pasyretuar. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtetë.”(El Enbija: 104)

Ringjallja është një e vërtetë, që e pohon Libri i Allahut, Suneti dhe konsensusi i dijetarëve. Allahu i Lartësuar thotë:

“Mandej, pas kësaj ju do të vdisni, pastaj, ju me siguri do të ringjallen në Ditën e Kiametit.”

(El Muminun: 15-16)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Në ditën e Kiametit njerëzit do të ringjallen të zbatuar, të zhveshur dhe të pasyretuar.** (Buhariu dhe Muslimi)

E dyta: Besimi në llogarinë dhe shpërblimin. Çdo njeri do të merret në llogari për veprat e tij, dhe do të shpërblehet për to. Këtë besim e argumentojnë Kurani, Suneti dhe konsensusi i muslimanëve. Allahu i Lartësuar thotë:

“Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne dhe patjetër do të japin llogari para Nesh!” (El Gashije: 25-26)

Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se i Dërguari

i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Allahu (në Ditën e Llogarisë) do ta afrojë një besimtar pranë Vetes, pastaj do ta mbulojë me Perden e Tij dhe do ta pyesë: ‘A di gjë për këtë dhe atë gjynah që e ke kryer?’ Ai do t’i thotë: ‘Po, o Zoti im’. Pasi pranon të gjitha gjynahet që ka bërë, mendon se çështja e tij ka marrë fund, është shkatërruar plotësisht. Mirëpo Allahu do t’i thotë: ‘Me të vërtetë, Unë t’i kam fshehur gjynahet në dynja, dhe sot do të t’i fal ato.’ Kështu që do t’i jepet libri i veprave të tij të mira. Sa i përket mohuesve dhe hipokritëve (veprat e liga të të cilëve do të shpallen hapur), dëshmitarët do të thonë: ‘Këta janë ata që kanë gënjer kundër Zotit të tyre. Me të vërtetë, mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët.”** (Buhariu dhe Muslimi)

E treta: Besimi në çdo gjë që ndodh pas vdekjes. Prej këtij besimi janë:

1- Sprovimi në varr

I vdekuri, pasi të varroset, do të pyetet: për Zotin, fenë dhe të Dërguarin e tij. Për këtë ka plot argumente të sakta nga Kurani dhe Suneti.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë botë dhe në botën tjetër.”** (Ibrahim: 27)

Po ashtu, transmetohet nga Ber’a bin Azib (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Kur të pyetet muslimani në varr, ai do të dëshmojë se nuk ka tjetër të adhuruar me meritë përveç Allahut, dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”** (Buhariu dhe Muslimi)

Për këtë Allahu i Lartësuar thotë:

“Allahu i forcon besimtarët me fjalë të qëndrueshme në këtë

botë dhe në botën tjetër.” (Ibrahim: 27)

Të gjithë do të pyeten: besimtarët dhe jo besimtarët, sepse të gjithë njerëzit janë përgjegjës për obligimet fetare, janë urdhëruar të zbatojnë shariatën e Allahut, kushdo qofshin ata: të këtij ymeti apo prej popujve të mëparshëm. Sa i përket atyre që nuk janë ngarkuar me përgjegjësi fetare²⁰, dijetarët ndajnë dy mendime të ndryshme. Shehidi²¹ nuk do të pyetet në varr. Edhe ai që vdes duke vigjëlur në rrugën e Allahut, gjithashtu nuk do të pyetet.

2- Dënimi dhe begatia në varr

Sa i përket dënimit në varr, atë do ta përjetojnë hipokritët dhe jobesimtarët keqbërës. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ah sikur t’i shihje keqbërësit gjatë agonisë së vdekjes, kur engjëjt zgjasin duart (duke thënë) “Dorëzoni shpirtat tuaj! Sot ju do të ndëshkoheni me dënim poshtërues për shkak të të pavërtetave që keni thënë për Allahun dhe që keni shpërfillur shpalljet e Tij.” (El Enam: 93)

Në Sahihun e Muslimit, përcillet nga Zejd bin Thabiti se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Sikur të mos druhesha se ju nuk do të varrosni njëri-tjetrin, do t’i lutesha Allahut që t’jua mundësonte t’i dëgjonit ndëshkimet në varr, që unë i dëgjoj.”** Më pas u kthye nga ne dhe tha: **“Kërkojini Allahut t’ju mbrojë prej dënimit të Zjarrit”** Ata thanë: **“I kërkojmë Allahut të na mbrojë prej dënimit të Zjarrit.”** Ai tha: **“Kërkojini Allahut t’ju mbrojë prej dënimit të varrit.”** Ata thanë: **“I kërkojmë Allahut të na mbrojë prej dënimit të varrit. Ai tha: “Kërkojini Allahut t’ju mbrojë prej sprovave të dukshme dhe të fshehta.”** Ata thanë: **“I kërkojmë**

²⁰ Si p.sh. njerëzit me të meta mendore.

²¹ Ai që është martirizuar në rrugën e Allahut.

Allahut të na mbrojë prej sprovave të dukshme dhe të fshehta.” Ai tha: **“Kërkojini Allahut t’ju mbrojë prej sprovës së Dexhalit.”** Ata thanë: “I kërkojmë Allahut të na mbrojë prej sprovës së Dexhalit.”(Muslimi)

Ndërkaq, në varr mund të ndëshkohen edhe gjynahçarët muslimanë. Gjithsesi, ndëshkimi i tyre nuk është i përhershëm.

Ndërsa begatitë në varr janë vetëm për besimtarët e sinqertë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: ‘Zoti ynë është Allahu’, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: ‘Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.’ (Fussilet: 30)

Pabesimtarët e mohojnë dënimin e varrit dhe begatitë e tij, duke pretenduar se kjo është e pamundur, sepse gjoja kundërshtoka realitetin. Ata thonë se po të zbulohet varri i të vdekurit, do të vërehet se ai nuk ka ndryshuar: as nuk është zgjeruar dhe as nuk është ngushtuar. Ky pretendim është i pasaktë. Këtë e hedhin poshtë argumentet fetare e logjike, si dhe argumentet e shqisave.

Sa i përket argumenteve fetare prej Kuranit, Sunetit dhe konsensusit të muslimanëve, ato janë mjaft të qarta. Tekstet e shariatit pohojnë bindshëm vërtetësinë e dënimit dhe begatimit në varr. Jeta e varrit i përket *gajbit*²², të cilën nuk mund ta perceptojnë shqisat. Dënimin, begatinë, gjerësinë dhe ngushtësinë e varrit e perceptojnë vetëm të vdekurit, dhe jo të tjerët. Kështu që nuk mund të bëhet analogji ndërmjet botës së dukshme dhe botës së fshehtë, pra jetës së varrit. Dënimet apo begatitë në varr i përjetojnë shpirti dhe trupi së bashku. Pas vdekjes, pasi shpirti ndahet nga trupi. Ai ose do të

²² Botës së fshehtë.

begatohet, ose do të dënohet. Ngadonjëherë shpirti lidhet me trupin dhe të dy së bashku ose dënohen, ose begatohen.

4- Fryrja në Sur

Engjëlli përgjegjës për fryrjen në Sur quhet Israfil. Israfil është ndër engjëjt e nderuar. Ai e ka kapur me dorë Surin qysh në kohën kur u dërgua Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Nga ajo kohë e deri tani është duke pritur urdhërin e Allahut të Lartësuar. Pasi t'i fryjë Surit për herë të parë, menjëherë do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej e në Tokë, përveç atyre që do Allahu. Pastaj do i fryjë Surit për herë të dytë. Atëhere, njerëzit do të çohen nga varret e tyre e do të ringjallen.

Fryrja në Sur është një e vërtetë që e konfirmojnë Libri i Allahut, Suneti dhe konsensusi i ymetit islam.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Kur do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.”(Ez-Zummer: 68)

Edhe i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na ka treguar në hadithe të sakta (autentike), se kur t'i fryhet Surit për herë të parë do të vdesin të gjitha krijesat njëra pas tjetrës. Çdo gjë në Tokë do të zhduket, e do të mbetet vetëm Allahu, Sunduesi i Gjithëfuqishëm, i Përhershmi, Ai që është Një dhe i Vetëm. Kur Allahu vendos t'i kthejë sërish krijesat në jetë, e urdhëron Israfilin t'i fryjë Surit për herë të dytë. Vërtet trupi i njeriut zhduket, por shpirti është i përvetshëm. Prej trupave tanë mbetet vetëm rruaza e fundit e kërbishtit, e cila nuk tretet. Në Ditën e Ringjalljes, kjo rruazë do të shërbejë si farë, prej së cilës do të zhvillohet e do të formohet sërish trupi ynë. Në atë Ditë, kur në tokë bie “shiu i jetës”, rruaza e fundit e kërbishtit mbin si bari. Pasi trupat të

jenë krijuar plotësisht, Allahu i jep urdhër Israfilut t'i fryje Surit për herë të dytë. Kur Israfil i fryn Surit për herë të dytë, çdo shpirt do të futet në trupin e vet. Kështu, ne do të ringjallemi.

5- Ringjallja dhe tubimi

Në Ditën e Kiametit të vdekurit do të ringjallen dhe do të tubohen para Allahut, për t'u marrë në llogari; secili do të marrë shpërblimin që i takon. Ringjallja dhe tubimi janë të vërteta që konfirmohen nga Libri i Allahut, Suneti dhe konsensusi i muslimanëve. Allahu i Lartësuar thotë:

“Thuaju :“Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni!”
(Et-Tegabun: 7)

Ndërsa i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), siç e përcjell Sehl bnu Sadi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: **“Në Ditën e Kiametit Allahu do t'i tubojë njerëzit në një tokë të bardhë si një bukë e gatuar me miell të pastër pa krunde, në të cilën nuk do të ketë asnjë shenjë për t'u orientuar.”** (Buhariu dhe Muslimi)

6- Shefaeti (ndërmjetësimi)

Ndërmjetësimi është ndërhyrja pranë dikujt për t'i bërë mirë një tjetri apo për të shmangur dëmin prej tij.

➤ **Ndërmjetësimi në Ditën e Kiametit është disa lloje:**

Lloji i parë: Ndërmjetësimi i madh

Është ndërmjetësim veçantë për Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në Ditën e Kiametit Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të ndërmjetësojë për gjithë njerëzimin; do t'i lutet Allahut të fillojë llogaria e njerëzve.

Lloji i dytë: Ndërmjetësimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për hapjen e dymëve të Xhenetit, që

banoret të hyjnë në të. Argument për këtë është hadithi i përcjellë nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Në këtë hadith Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Unë jam i pari prej njerëzve që ndërmjetësoj për hyrjen në Xhenet. Unë jam profeti me më shumë ndjekës.”** (Muslimi)

Lloji i tretë: Ndërmjetësimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për xhaxhain e tij Ebu Talibin, që t’i lehtësohet dënimi. Abas bin Abdulmutalibi na tregon se i tha Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): “O i Dërguari i Allahut, a do t’i bësh dobi me diçka Ebu Talibit? Sepse ai të ka mbrojtur e të ka ndihmuar.” Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha: **“Po. Ai do të jetë në shtresën periferike të Zjarrit. Sikur unë të mos ndërmjetësoja për të, ai do të ishte në shtresën e fundit të Zjarrit.”**(Buhariu dhe Muslimi)

Lloji i katërt: Ndërmjetësimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për besimtarët që do të hyjnë në Xhenet pa u gjykuar dhe pa u marrë në llogari. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) pohon se në Ditën e Gjykimit atij do t’i thuhet: **“O Muhamed, fut në Xhenet prej ymetit tënd gjithë ata të cilët nuk do të gjykohen e nuk do të merren në llogari. Futi nga dera e djathtë e Xhenetit, teksa në dyert e tjera, do të hyjnë bashkë me njerëzit e tjerë.”**

Lloji i pestë: Ndërmjetësimi për ata që meritojnë hyrjen në Zjarr, që të mos hyjnë në të. Edhe ky është ndërmjetësim i përgjithshëm (nuk është i veçantë për Profetin - Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Argument për këtë është fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e përcjellë nga Ebu Saïdi: **“Allahu i Lartësuar thotë: “Ndërmjetësuan engjëjt, profetët dhe besimtarët...”**

Lloji i gjashtë: Ndërmjetësimi për gjynahqarët që kanë

merituar Zjarrin, që të dalin prej tij. Ky është ndërmjetësim i përgjithshëm (jo vetëm për Profetin - Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!, por edhe për të tjerë). Përcillet nga Imran bin Husejni (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Me ndërmjetësinë e Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dalin nga Zjarri njerëz të cilët banorët e Xhenetit do t’i quajnë ‘xhehenemlinj’.”**

Dy llojet e fundit të ndërmjetësimit i mohojnë mutezilet dhe hauarixhët. Ata bazohen në besimin e tyre të gabuar sipas të cilit: personi i cili ndërron jetë duke bërë gjynahe të mëdha, do të banojë përjetësisht në Zjarr. Sipas tyre, këtij njeriu nuk i bën dobi ndërmjetësimi.

Këtyre grupeve të humbura iu përgjigjemi:

1- Kjo që thoni ju bie në kundërshtim me hadithet autentike që na kanë ardhur nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

2- Ky besim i gabuar bie ndesh me konsensusin e të parëve tanë të mirë.

➤ **Që ndërmjetësimi të pranohet te Allahu, duhet të plotësohen dy kushte:**

Kushti i parë: Duhet që Allahu t’i japë lejë ndërmjetësuesit. Allahu i Lartësuar thotë:

“Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij?”
(El Bekare: 255)

Kushti i dytë: Allahu duhet të jetë i kënaqur me ndërmjetësuesin dhe personin për të cilin ndërmjetësohet. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur.” (El Enbija: 28)

Kështu që për jobesimtarin nuk lejohet ndërmjetësimi. Allahu i Lartësuar thotë:

"Prandaj, kurrfarë ndërmjetësimi i cilitdo ndërmjetësuesi nuk do t'i ndihmojë ata. " (El Mudethir: 48)

Lloji i shtatë: Ndërmjetësimi për ngritjen në shkallët e larta të banorëve të Xhenetit. Gjithashtu, edhe ky ndërmjetësim është i përgjithshëm (për Profetin dhe të tjerë). Ibn Kajimi ka thënë se për këtë lloj ndërmjetësimi dijetarët kanë marrë si argument lutjen që Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka bërë për Ebu Selemen: **"O Zoti im, fale Ebu Selemen dhe lartësoje atë në shkallët e Xhenetit!"** (Muslimi)

7- Llogaridhënia

Allahu do t'ua tregojë robërve të Tij punët që kanë bërë dhe do t'i marrë në llogari. Llogaridhënia konfirmohet nga Libri i Allahut, Suneti dhe konsensusi i muslimanëve. Allahu i Lartësuar thotë:

"Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë tek Ne dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh!" (El Gashije 25-26)

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) lutej në namaz: **"O Zoti im, ma lehtëso llogarinë në Ditën e Kiametit!"** Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e pyeti: "O i Dërguari i Allahut, ç'është llogaria e lehtë?" Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) iu përgjigj: **"Kjo d.m.th. që Allahu do t'ia prezantojë punët robit të Tij dhe pastaj do t'ia falë gjynahet atij."** (Transmeton Ahmedi, Albani thotë se zinxhiri i transmetimit të hadithit është i mirë.)

➤ Si merret në llogari besimtari?

Në Ditën e Kiametit, kur besimtari të dalë para Allahut, Allahu e merr atë më vete; e veçon nga të tjerët; askush nuk e sheh përveç Tij. Allahu do t'i tregojë gjynahet që ka bërë dhe ai i

pranon të gjitha. Besimtari frikësohet shumë, saqë mendon se e pret shkatërrimi. Mirëpo Allahu i thotë atij: **“Unë t’i mbulova gjynahet në dynja, ndërsa sot po t’i fal ato.”** Pastaj i jepet libri i veprave të tij nga e djathta. Sa i përket jobesimtarëve dhe munafikëve, llogaridhënia e tyre do të jetë para gjithë krijesave. Një thirrës do të thërrasë: **“Këta janë ata që kanë gënjyer kundër Zotit të tyre. Mallkimi i Allahut qoftë mbi të padrejtët,”** (Hud: 18)

Të gjithë njerëzit do të merren në llogari, përveç atyre që ka veçuar Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilët janë 70 mijë veta nga ky ymet; prej tyre është dhe Ukasha bin Muhsin. Me secilin prej këtyre 70 000 vetave do të jenë dhe 70 000 të tjerë.

Ymeti i parë që do të merret në llogari në Ditën e Kiametit është ymeti ynë. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Ne jemi ymeti i fundit, por në Ditën e Kiametit do të jemi ymeti i parë me të cilin fillon llogariadhënia.”** (Buhariu dhe Muslimi)

Sa i përket të drejtave ndaj Allahut, së pari, njeriu do të merret në llogari për namazin. Ndërsa sa i përket raporteve me njerëzit, çështja e parë për të cilën do të gjykohet është vrasja (gjakderdhja).

8- Peshorja

Në Ditën e Gjykimit Allahu do t’i peshojë veprat e robërve të Tij. Për këtë dëshmon Libri i Allahut, Suneti dhe konsensusi i të parëve tanë të mirë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar.” (El A’raf: 8)

“Sa për ata që do të kenë peshore të lehta, mu ata do të jenë (njerëzit) që kanë humbur vetveten, duke qëndruar përherë në Xhehenem.” (El Muminun: 103)

Ndërsa Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë në hadithin që e përcjell Ebu Hurejra: **“Dy fjalë janë të dashura te Rahmani (i Gjithëmëshirshmi) ; janë të lehta për gjuhën, por të rënda në peshore. Këto dy fjalë janë: “Subhanallahi ue bihamdihi - O Allah, Ti je pa të meta, e lartësoj Lavdinë Tënde!” dhe “Subhanallahi el adhim - O Allah, Ti je pa të meta; i Lartësuar dhe i Madhëruar je, o Zoti im!”** (Buhariu dhe Muslimi)

Ajo është një peshore e vërtetë me dy pjata, siç përcillet nga Abdullah bin Amr bin el As (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) në hadithin ku Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) përmend njeriun e *Bitakës*²³. Në këtë hadith thuhet: **“Në njërën anë të peshores vendosen regjistrat e veprave të këqija, ndërsa në anën tjetër të saj vendoset Karta e Shehadetit.”** (Transmeton Termidhiu , Ibn Maxhe , Albani thotë se zinxhiri i transmetimit është i vërtetë.)

Thuhet se ka shumë peshore, në varësi të popujve, individëve apo veprave; sikurse thuhet se është një peshore e vetme. Të dyja këto medime janë të të mundshme (të pranueshme). Ajo që peshohet është vepra, e kjo duket qartë në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrrë sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.”** (ElEnbija: 47)

Është thënë se do të peshohen regjistrat e veprave, siç tregohet dhe në hadithin e *Bitakës* - Kartës së Shehadetit të lartpërmendur. Gjithashtu është thënë se do të peshohet vetë njeriu, pra ai që i ka kryer veprat. Si argument për këtë merret hadithi që e përcjell Ebu Hurejra, ku Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Në Ditën e Kiametit do të**

²³ Karta në të cilën është shkruar Shehadeti: “La ilahe il Allah”.

vijë një burrë trupmadh dhe i shëndoshë, i cili nuk do të peshojë tek Allahu as sa krahu i mushkonjës.” Pastaj tha: **“Lexoni fjalën e Allahut të Lartësuar: “Ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta (për veprat e tyre), në Ditën e Kiametit.”** (El Kehf: 105)

Gjithashtu është thënë se do të peshohen të gjitha: veprat, regjistrat e veprave dhe vetë njeriu.

9- Shpërndarja e librave të punëve

Secilit do t’i prezantohet libri i punëve të tij; do ta marrë dhe do ta lexojë vetë. Çdo gjë është e shkruajtur, e dokumentuar dhe e ruajtur mirë. Asgjë nuk humbet nga veprat e robërve, goftë e mirë apo e keqe. Engjëjt e Allahut kanë shkruar gjithçka. Allahu është i kënaqur me besimtarët, prandaj atyre do t’u jepet libri i veprave nga e djathta, ndërsa pabesimtarëve do t’u jepet libri nga e majta.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Ai, të cilit do t’i jepet libri në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë, dhe do të kthehet i gëzuar te të afërmit e tij. Kurse ai, të cilit do t’i jepet libri pas shpinës, do të lutet për të vdekur dhe në Zjarr do të digjet.” (El Inshikak: 7-12)

➤ **Mënyra e marrjes së librit**

Siç e thamë, besimtari e merr librin e tij me dorën e djathtë. Ai lumturohet dhe thotë i gëzuar:

“Ja, lexoni librin tim!”(El Haka: 19)

Ndërsa pabesimtari e merr librin e tij me dorën e majtë pas shpine, ngase dora e majtë i shtrëngohet pas shpine dhe aty i vendoset libri. Jobesimtari do të dëshpërohet dhe do të kërkojë vetëshkatërrim. Ai do të thotë i pikëlluar:

“Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im dhe të mos e kisha

ditur llogarinë time!” (El Haka: 25-26)

10- Haudi (Auzi-Burimi i madh në Mahsher)

Haudi është Kroi i madh në Mahsher, të cilin Allahu ia ka dhënë Profetit tonë, Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Prej këtij uji do të pijë ai vetë dhe ymeti i tij. Ky ujë vjen nga Xheneti, prej lumit Keuther. Ka shumë hadithe të sakta që e pohojnë një gjë të tillë. Ndjekësit e Traditës Profetike kanë rënë në konsensus për këtë. Në hadithin e përcjellë nga Ibn Mesudi, qëndron se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Unë do t’ju paraprij juve në Haud²⁴.”** (Buhariu dhe Muslimi)

Mutezilitë e përgënjeshtrojnë Haudin.

Atyre u përgjigjemi:

Së pari, ka shumë hadithe të sakta që kanë ardhur nga Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të cilat flasin për këtë çështje.

Së dyti, dijetarët e ymetit islam kanë rënë në konsensus për këtë gjë.

➤ Përshkrimi i Haudit

Haudi është shumë i gjërë, sa një muaj udhëtim; edhe gjatësia e tij është po kaq. Enët e tij janë si yjet në qiell. Uji i tij ka ngjyrë më të bardhë sesa qumështi; është më i ëmbël sesa mjalti dhe me aromë më të këndshme sesa misku. Ai vjen nga Xheneti nëpërmjet dy tubave: njëri prej të cilave është prej ari, ndërsa tjetri prej argjendi. Prej ujit të tij do të pijnë besimtarët e ymetit të Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Kushdo që do të pijë, qoftë edhe një herë të vetme nga ky ujë, nuk do të ketë më etje kurrë. Haudi ekziston tani.

²⁴ Do t’ju pres atje.

Këtë e dëshmon fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e përcjellë nga Ukbe bin Amir (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili rrëfen se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Për Zotin, me të vërtetë, unë e shoh Haudin tim tani, pikërisht në këtë moment.”** (Buhariu dhe Muslimi) Siç e theksuam më lart, uji i Haudit vjen nga Xheneti, prej lumit Keuther. Çdo Profet ka haudin e tij, mirëpo Haudi i Profetit tonë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është më madhështori dhe prej tij do të pijnë më shumë njerëz se nga çdo haud tjetër. Nga Haudi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) do të përzëhen njerëz, për të cilët është thënë se janë arabët e vrazhdë që hynë në Islam me hir a me pahir dhe pastaj e tradhëtuan atë. Gjithashtu është thënë se bëhet fjalë për ata që kanë shpikur në fenë e Allahut, pra janë bidatçinjtë.

11- Sirati

Sirati është Ura e vendosur mbi Xhehenem, në të cilën do të kalojnë njerëzit për të shkuar në Xhenet. Kjo pohohet në Librin e Allahut dhe në Sunetin e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ndjekësit e Traditës Profetike kanë rënë në konsensus për besimin e kalimit mbi urën e Siratit. Allahu i Lartësuar thotë:

“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (Xhehenemi).” (Merjem :71)

➤ Përshkrimi i Siratit

Ura e Siratit është e rrëshqitshme dhe e luhatshme; në të hidhen grremça dhe kanxha; ajo është e pajisur me gozha të shtrirë dhe gjemba të lakuar, si gjembat e Ukejfasë në Nexhd, që i quajnë Sadan. Madhësinë e kësaj Ure nuk e di askush përveç Allahut, por dihet se njerëzit, në varësi të punëve të liga që kanë kryer, do të shkasin dhe do të bien në zjarrin e Xhehenemit. Ndërkaq, mjetet shpuese: kanxhat dhe

mengenetët do t'i mbërthejnë mizorët djathtas e majtas. Ura e Siratit është më e hollë se fija e flokut dhe më e mprehtë se maja e shpatës.

➤ **Mënyra e kalimit mbi Sirat**

Njerëzit do të kalojnë mbi Sirat në varësi të veprave që kanë bërë. Në hadithin e përcjellë nga Ebu Saidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), transmetohet se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për besimtarët ka thënë: **“Besimtarët e kalojnë Siratin sa hapen dhe mbyllen sytë ose si vetëtima, ose si era e shpejtë, ose si zogjtë, ose si kuajt më të mirë, ose si kuajt e tjerë. Muslimani shpëton i tronditur dhe i trishtuar. I fundit kalon duke u zvarritur. I pari që e kalon Siratin prej profetëve është Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ndërsa prej popujve është ymeti i tij.”** (Buhariu dhe Muslimi)

12- Xheneti dhe Xhehenemi

Xheneti është vendbanimi përhershëm në botën e përtejme, të cilin Allahu i Lartësuar e ka përgatitur për të devotshmit. Ndërsa Xhehenemi është vendi i ndëshkimit të përhershëm, që Allahu i Lartësuar e ka përgatitur për jobesimtarët. Xheneti dhe Xhehenemi ekzistojnë tani. Ata të dy nuk zhduken kurrë. Allahu i Lartësuar thotë për Xhenetin:

“Është përgatitur për të devotshmit.” (Ali Imran: 133)

Ndërsa për Zjarrin thotë:

“Është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit.” (El Bekare: 24)

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), kur fali namazin e eklipsit të Diellit, tha: **“Unë e pashë Xhenetin dhe hëngra prej tij rrush. Sikur ta merrja atë (në dynja), do të**

hanit prej tij për sa kohë ekziston kjo botë. Gjithashtu pashë Zjarrin. Deri më sot nuk kam parë pamje më të llahtarshme se Zjarri.” (Buhariu dhe Muslimi)

Siç e theksuam, Xheneti dhe Xhehenemi nuk zhduken kurrë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë.” (El Bejine: 8)

Gjithashtu i Lartësuari thotë:

“Vërtetë, Allahu i ka mallkuar jobesimtarët dhe ka përgatitur për ata zjarr të flakëruar,” (El Ahzab: 64)

➤ **Banorët e Xhenetit dhe banorët e Xhehenemit**

Në Xhenet do të jetojnë përjetësisht të lumtur besimtarët e devotshëm. Allahu i Lartësuar për Xhenetin thotë: **“Është përgatitur për të devotshmit.”** (Al Imran: 133)

Ndërsa në Xhehenem do të vuajnë përjetësisht jobesimtarët. Allahu i Lartësuar për Zjarrin thotë: **“Është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit.”**(El Bekare: 24)

12- Therja e vdekjes

Në Ditën e Kiametit Allahu Fuqiptotë i jep vdekjes pamjen e një dashi të majmë dhe e ther atë ndëmjet Xhenetit dhe Xhehenemit. Ebu Said el Hudriu përcjell hadithin e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), në të cilin i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Vdekja sillet (në një vend ndërmjet Xhenetit dhe Xhehenemit) në pamjen e një dashi të majmë. Ndërkaq, një zë thërret: ‘O banorë të Xhenetit, a e njihni këtë?’** Ata thonë: ‘Po, e njohim. Kjo është vdekja.’ **Të gjithë ata e shohin**

vdekjen. Pastaj ky zë thërret: ‘O banorë të Zjarrit, a e njihni këtë?’ Ata thonë: ‘Po. Kjo është vdekja.’ Vdekjen e shohin të gjithë. Atëhere Allahu urdhëron të theret vdekja. Pastaj një zë thërret: ‘O banorë të Xhenetit, tashmë ka vetëm përjetësi; nuk ka më vdekje! O banorë të Zjarrit, tashmë ka vetëm përjetësi; nuk ka më vdekje!’ Pastaj lexoi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Paralajmëroji ata (o Muhamed) për Ditën e Pikëllimit, kur do të japin llogari, ndonëse tani ata janë të shkujdesur dhe nuk besojnë.” (Merjem :39)

12- Shikimi i Allahut të Lartësuar

Në Ditën e Kiametit besimtarët do ta shohin Zotin e Lartësuar me sytë e tyre, duke mos e përfshirë Atë. Besimtarët e shohin Allahun në dy vende.

Shylla e gjashtë: Besimi në Kaderin

Kaderi nënkupton paracaktimin e Allahut për të gjitha krijesat, në përputhje me dijen e Tij paraprake dhe me urtësinë e Tij të përkryer.

➤ **Besimi në Kaderin përfshin katër çështje:**

E para: Besimi se Allahu i Lartësuar di çdo gjë, përgjithësisht dhe imtësisht para se t'i krijojë ato. Kjo dije ndërlidhet me veprimet e Veta ose me veprimet e robërve të Tij.

E dyta: Besimi se Allahu e ka shkruar këtë (dituri) në Pllakën e Ruajtur mirë (*Leuhi Mahfudh*). Lidhur me këto dy çështje (dija dhe shkrimi), Allahu i Lartësuar thotë:

“A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë, që është në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër. Me të vërtetë, kjo është e lehtë për Allahun.” (El Haxh: 70)

Në Sahihun e Muslimit, përcillet se Abdullah bin Amr bin Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!) ka thënë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) duke thënë: **“Allahu e ka shënuar Kaderin e krijesave 50 000 vjet para se të krijonte qiejt dhe Tokën.”**

E treta: Besimi se të gjitha gjërat ndodhin vetëm me dëshirën e vullnetin e Allahut të Lartësuar, qoftë kjo e ndërlidhur me veprimet e Veta apo me veprimet e krijesave të Tij. Në lidhje me veprimet e Veta, Allahu i Lartësuar thotë:

“Zoti yt krijon ç’të dojë dhe zgjedh lirisht.” (El Kasas: 68)

Ndërkaq, lidhur me veprimet e krijesave të Tij, i Lartësuari thotë:

“Sikur të kishte dashur Allahu, do t’u kishte dhënë pushtet mbi ju dhe ata do të luftonin kundër jush.” (En-Nisa: 90)

E katërta: Besimi se të gjitha krijesat janë krijuar nga Allahu, duke përfshirë: qeniet, cilësitë dhe lëvizjet e tyre.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje.” (Ez-Zumer: 62)

Besimi në Kaderin, sipas asaj që përshkruam më sipër, nuk mohon faktin se njeriu nuk detyrohet në veprimet e tij dhe se ai vepron lirisht me dëshirën dhe vullnetin e tij. Gjithashtu kjo nuk i jep atij të drejtën t'i lërë detyrat dhe të bjerë në mëkate.

➤ **Nënçështje**

Vepra e robit është krijesë e Allahut dhe një kohësisht përpjekje e atij që e kryen.

Pajtimi ndërmjet këtyre dy gjërave realizohet në dy aspekte:

1- Veprimi i robit është prej cilësive të tij. Robi dhe cilësitë e tij, janë krijesa të Allahut të Lartësuar.

2- Robi e kryen veprën me vullnetin e zemrës dhe me fuqinë e trupit. Sikur të mos ishin këto të dyja, ai nuk do ta kryente veprën. Ai i Cili krijon vullnetin dhe fuqinë e robit është Allahu, Krijuesi i shkakut dhe shkaktarit.

➤ **Dy sekte kanë devijuar lidhur me Kaderin:**

1- Xhebritët - fatalistët, thonë se njeriu është i detyruar në kryerjen e veprimeve të tij dhe se ai nuk ka vullnet dhe mundësi për të kryer diçka.

2-Kaderitët - mohuesit e Kaderit, thonë se njeriu është i pavarur në veprimet e tij. Kështu pra, sipas tyre, vullneti dhe fuqia e robit janë ta pavaruara nga vullneti e fuqia e Allahut; këto të fundit nuk kanë ndikim në veprat që ai kryen.

KAPITULLI IV

MBËSHTETJA NË SHKAQET NË VIJA TË PËRGJITHSHME

- Mësimi i parë: Kategoritë e njerëzve në raport me shkaqet
- Mësimi i dytë: Llojet e shkaqeve dhe gjykimi për secilin lloj
- Mësimi i tretë: Mjekimi
- Mësimi i katërt: Rukja
- Mjekimi i pestë: Hajmalitë
- Mësimi i gjashtë: Dguret (e mbarësisë ose fatkeqësisë)
- Mësimi i shtatë: Kërkimi i shiut prej yjeve
- Mësimi i tetë: Kur mirësitë i atribuohen tjetërkujt veç Allahut të Lartësuar
- Mësimi i nëntë: Kërkimi i bereqetit
- Mësimi i dhjetë: Magjia

MËSIMI I PARË:

KATEGORITË E NJERËZVE NË RAPORT ME SHKAQET

Sa i përket pohimit të shkaqeve dhe ndikimit të tyre, njerëzit ndahen në tre kategori, nga të cilët: dy kategori janë ekstremë dhe i treti është mesatar, i drejtë. Ato janë:

Kategoria e parë: Në të bëjnë pjesë ata që pohojnë se shkaqet nuk janë diçka reale. Shkaqet i kryen vetëm Allahu, ndërsa njeriu nuk ka aspak dëshirë dhe vullnet. Kështu që, sipas tyre, vepra nuk mund t'i atribuohet njeriut.

Kategoria e dytë: Këta janë në kundërshtim të plotë me kategorinë e parë. Sa i përket shkaqeve, ata pozicionohen në ekstremin tjetër, duke e tepruar në to. **Ata i konsiderojnë shkaqet të pavarura nga Shkaktari i Vërtetë.** Sipas tyre, veprat ndodhin pa dëshirën dhe vullnetin e Allahut. Ata mbështeten vetëm të shkaqet, duke e injoruar Shaktarin e Vërtetë, pa lejën dhe vullnetin e të Cilit nuk mund të ndodhë asgjë.

Kategoria e tretë: Në të bëjnë pjesë njerëzit e drejtë, të cilët pohojnë vërtetësinë e shkaqeve; njëkohësisht, pohojnë se ato (shkaqet) nuk janë të pavaruara nga Shkaktari i Vërtetë, i Cili është Allahu i Lartësuar.

Bazuar në këtë besim, ata thonë se mbivlerësimi i shkaqeve e çon njeriun në shirk, duke e rrezikuar rëndë teuhidin (besimin e vërtetë). Nga ana tjetër, nënvlerësimi i shkaqeve është mendjelehtësi. Injorimi total i shkaqeve është keqinterpretim i teksteve të shariatit. Pohimi i shkaqeve, duke i trajtuar ato në përputhje me shariatin nuk bie ndesh me mbështetjen e sinqertë të Allahut i Lartësuar.

MËSIMI I DYTË

LLOJET E SHKAQEVË DHE GJYKIMI PËR SECILIN PREJ TYRE

Lloji i parë: Shkaqet e ligjëruara nga sheriat, qofshin ato të detyrueshme apo të pëlqyeshme. Tek këto bëjnë pjesë detyrat dhe gjërat e preferuara të shariatit.

Lloji i dytë: Shkaqet e lejuara. E lejuar është çdo gjë që njihet si shkak të cilin e aprovon sheriat; ose diçka tek e cila mishërohet lidhja logjike ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke qenë qartësisht e perceptueshme, por nuk është pjesë e llojeve të tjera të shkaqeve.

Lloji i tretë: Shkaqet e kritikuara. Në fakt, ato janë prej shkaqeve të lejuara, mirëpo kryerja e tyre është qortueshme, duke u bazuar në argumente të sakta të shariatit islam. Prej këtyre shkaqeve është kërkimi i rukjes²⁵ apo kurimi përmes djegies e damkosjes. Kryerja e këtyre shkaqeve tregon se mbështetja tek Allahu i Lartësuar nuk është e plotë.

Lloji i katërt: Shkaqet e ndaluara. Këto bëjnë pjesë në grupin e shkaqeve të mëparshme. Si shembull për këtë përmendim: ndëshkimin e të gjallëve përmes zjarrit, gjë të cilën sheriat e ka ndaluar. Po ashtu shkak i ndaluar është lypja në rastin kur njeriu nuk ka nevojë. Kjo e cënon mbështetjen tek Allahu i Lartësuar. Një pjesë e këtyre shkaqeve janë shirk; një pjesë tjetër nuk janë të tillë.

Lloji i pestë: Shkaqet iluzive (joreale). Këto ndahen në tre grupe:

1- Shirk i madh, sikurse është adhurimi i idhujve, duke i konsideruar ata shkak për t'u afruar tek Allahu. Po ashtu shirk është edhe rasti kur njeriu i lutet të vdekurve apo kërkon

²⁵ Pra kur njeriu kërkon nga të tjerët që t'i bëjnë rukje.

shpëtim prej tyre.

2- Shirk i vogël, gjë e cila pohohet qartë përmes tekstit të shariatit ose përmes analogjisë, siç janë: oguret (e mbarësisë ose fatkeqësisë), hedhja e fallit, besimi tek fallxhorët dhe ata që pretendojnë njohjen e të fshehtave, po ashtu edhe ajo pjesë e astrologjisë që është e ndaluar, si dhe gjithçka që lidhet me pretendimin e dijes së *gajbit* (të fshehtës) përmes këtyre shkaqeve të ndaluara. Gjithashtu në këtë grup bëjnë pjesë edhe nuskat dhe hajmalitë, e shumë të tjera, me kusht që ato të mos arrijnë cakun e shirkut të madh, siç do ta shpjegojmë në vijim. Kur diçka konsiderohet shkak dhe ajo nuk është e tillë: as sipas teksteve të shariatit dhe as nuk është provuar në jetën e përditshme, në këtë rast, kjo konsiderohet shirk. Ukbe bin Amir na përcjell hadithin në të cilin Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Ai që mban hajmali, ka bërë shirk.”**

3- Shkaqet e ndaluara, janë gjëra të ndaluara, mirëpo sheriati nuk i ka cilësuar ato idhujtari, siç është zotimi i ndaluar. Sigurisht që në këtë lloj duket qartë cënimi i parimit të mbështetjes tek Allahu i Lartësuar.

MËSIMI I TRETË

MJEKIMI

Dijetarët kanë rënë në konsensus se: mjekimi në përgjithësi është i lejuar. Ai nuk bie ndesh me mbështetjen tek Allahu i Lartësuar. Askush nuk thotë se mjekimi është i ndaluar. Gjithsesi, shumë prej të parëve tanë të mirë preferojnë durimin e sëmundjeve, duke u mbështetur tek Allahu i Lartësuar.

➤ Llojet e mjekimit

Lloji i parë: Kur dihet me siguri (apo me shumë mundësi) se një mjekim i caktuar është i dobishëm dhe se injorimi i tij shkakton vdekje. Në këtë rast, **ky lloj mjekimi është i domosdoshëm.**

Lloji i dytë: Kur dihet me siguri (apo ka shumë mundësi) që një mjekim i caktuar është i dobishëm dhe se braktisja e tij nuk çon drejt vdekjes. Në këtë rast, **ky mjekim është i preferueshëm.**

Lloji i tretë: Nëse janë njësoj të dyja mundësitë: mundësia e dobisë dhe e mungesës së saj. Në këtë rast, **është më mirë që të mos bëhet trajtimi mjekësor.**

MËSIMI I KATËRT

RUKJET

Rukjet janë leximi i ajeteve kuranore dhe lutjeve për të sëmurët, më qëllim shërimin e tyre ose parandalimin e sëmundjeve.

Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) pohon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka lejuar rukjen...(Muslimi)

Ekziston dakortësi për lejimin e rukjeve. Mendimi më i saktë është se rukja është e pëlqyer, për shkak se Xhibrili (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka bërë rukje, siç përcillet në hadithin e Aishes (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Po ashtu, edhe vetë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka bërë rukje, sikurse transmetohet nga Buhariu dhe Muslimi. Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) na tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur sëmurej i lexonte vetes ajete kuranore dhe lutje duke i fryrë trupit. Kur u përkeqësua dhe dhimbjet iu shtuan shumë, ajo i lexonte dhe e prekte me dorën e tij duke shpresuar në bekimin e saj.

➤ **Dijetarët (Allahu i mëshiroftë!) kanë përmendur disa kushte për lejimin e rukjeve:**

1- Të mos përmbajnë shirk.

2- Të besohet se ato nuk mund të ndikojnë vetvetiu, por vetëm se me caktimin e Allahut.

3- Duhet që rukja të jetë me fjalë të kuptueshme, sepse fjalët e pakuptueshme me shumë mundësi përmbajnë kufër dhe shirk.

4- Nuk lejohet të shkohet tek fallxhorët apo magjistarët për të bërë rukje.

5- Nuk lejohet që rukja të shfaqet në formë të ndaluar, si p.sh.: në rastin kur njeriu do të bëjë rukje në gjendje të papastër (kur është xhunub) ose në varreza, ose në banjë, ose kur është duke vrojtuar yjet etj.

6- Të besohet se rukja është thjesht një prej shkaqeve të lejuara.

➤ **Rukjet që përmbajnë shirk:**

Kur i sëmuri apo ai që kuron përmes rukjes mbështetet tek rukja: nëse mbështetet tek ajo, duke e konsideruar atë thjesht një shkak, që nuk është i pavarur në aspektin e ndikimit, në këtë rast, **është shirk i vogël.**

Ndërsa kur mbështetet plotësisht tek rukja, duke besuar se ajo sjell dobi vetvetiu pa lejën dhe vullnetin e Allahut të Lartësuar apo përmban ndonjë lloj adhurimi që nuk i kushtohet Allahut, siç është kërkimi i mbrojtjes prej krijesave, duke iu kërkuar diçka që nuk kanë mundësi ta bëjë askush përveç Allahut të Lartësuar, të tilla raste, konsiderohen **shirk i madh.**

Argument për ndalimin e të gjitha rukjeve që përmbajnë shirk është një hadith që transmeton imam Muslimi. Hadithin e përcjell Auf bin Malik el Eshxhau (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Ai ka thënë: “Ne bënim rukje në kohën e injorancës, andaj e pyetëm Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): ‘O i Dërguari i Allahut, çfarë mendon për këtë?’ Ai tha: **‘M’i tregoni rukjet tuaja. S’ka asgjë të keqe, nëse ato nuk përmbajnë shirk.’**”

Prej rukjeve të ndaluara janë edhe ato që përmbajnë hajmali apo fjalë të pakuptueshme. Përgjithësisht, këto janë rukje idhujtarie, dhe veçanërisht kur ato bëhen nga një person i cili nuk njihet si njeri i mirë dhe i përkushtuar në fenë e Allahut ose nga ndonjë jobesimtar, ithtar i Librit etj.

MËSIMI I PESTË

HAJMALITË

Hajmalitë janë çdo gjë që njeriu vendos në trupin e vet apo të dikujt tjetër, duke pasur si qëllim t'i bëjë dobi, t'i sjellë ndonjë gjë të mirë ose të pengojë a të largojë ndonjë dëm. Në mënyrë të veçantë, hajmalitë i përdorin kundra marrjes më sysh. Mund të bëhet me ndonjë pe ose byzylyk, ose diçka tjetër e ngjashme me to.

Arabët u vendosnin hajmali fëmijëve, duke u bazuar në besimin e tyre pagan se ato i mbronin nga syri i keq. Kur erdhi Islami, i ndaloi hajmalitë. Ka mjaft tekste të shenjta për ndalimin e hajmalive. I tillë është hadithi i transmetuar nga imam Ahmedi me zinxhir transmetimi të mirë, që e përcjell Ukbe bin Amir, i cili ka thënë se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka pohuar: **“Kush mban hajmali, ka rënë në shirk.”**

➤ **Gjykimi për hajmalitë që përmbajnë Kuran:**

Sa i përket hajmalive që përmbajnë Kuran ose lutje të lejuara, të cilat u vendosen të sëmurëve, dijetarët ndajnë mendime të ndryshme. Mendimi më i saktë është se ato lejohen, por me kusht që të vendosen pasi njeriu sëmuret apo në kohën kur ai ndien dhimbje.

➤ **Sa i përket mbajtjes në trup të penjve, byzylykëve e të tjera si këto, janë disa raste:**

1- Kur besohet se ato vetvetiu sjellin dobi apo pengojnë dhe e largojnë të keqen e dëmin dhe jo Allahu i Lartësuar, në këtë rast, **është shirk i madh**. Nëse beson që vetëm Allahu është Ai që sjell dobinë, porse këto i konsideron si shkak për t'u mbrojtur nga e keqja, në këtë rast, **kemi të bëjmë me shirk të vogël**.

2- Kur është provuar realisht dobia e tyre, njihen si shkaktarë që sjellin dobi dhe shërbejnë për të trajtuar dhimbje të ndryshme, pra janë prej shkaqeve të vërteta dobiprurëse, në këtë rast, **lejohet përdorimi i tyre.**

3- Kur nuk është provuar që ato janë të dobishme dhe nuk përdoren për të larguar dëmin apo për ta penguar atë, në këtë rast, **nuk lejonet përdorimi i tyre, madje janë shirk i vogël.** Argument për këtë është hadithi i përcjellë nga imam Ahmedi me zinxhir transmetimi të mirë, ku përmendet se Ukbe bin Amir ka thënë se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka pohuar: **“Kush mban hajmali, ka rënë në shirk.”**

4- Nëse e vendos perin, byzylykun apo diçka tjetër të kësaj natyre, thjesht për t’u zbukuruar, jo për të penguar dëmin dhe as për ta ndaluar atë, natyrisht që kjo **është prej gjërave të lejuara.** Të kësaj natyre janë stolitë me të cilat zbukurohen gratë, me kusht që të mos u përngjasohet atyre që i vendosin këto gjëra për t’u ruajtur nga syri i keq. **Në rastin e fundit nuk lejohet.**

MËSIMI I GJASHTË

OGURET (E MBARËSISË OSE FATKEQËSISË)

Oguret janë ato që kanë të bëjnë me pesimizmin ose optimizmin besëtytnor, duke parë, dëgjuar apo mësuar disa ngjarje e dukuri, që merren si shenja të fshehta, që parathënë të ardhmen ose që sjellin të mirën a të keqen. Për këtë arsye, oguret (e mbarësisë ose fatkeqësisë) i motivojnë paganët për vazhdimin ose jo të punës që duan të bëjnë. Në Sahihun e Buhariut është shënuar hadithi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), në të cilin ai thotë: **“Nuk ka infektim (sëmundje ngjitëse) dhe as pesimizëm. Mua më pëlqen optimizmi.”** I thanë: “Ç’është optimizmi?” Ai tha: **“Fjala e mirë.”**

➤ **Oguret ndahen në dy lloje:**

Lloji i parë: Nëse beson se ato bëjnë dobi apo sjellin dëm vetvetiu, pa lejën dhe vullnetin e Allahut të Lartësuar. **Ky është shirk i madh.**

Lloji i dytë: Nëse beson se ato janë shkak për të sjellë dobi apo për të larguar dëmin, porse është i bindur se këto ndodhin me caktimin e Allahut, pra nuk i merr si shkaqe të pavarura nga Shkaktari i Vërtetë (Allahu). **Ky është shirk i vogël.**

➤ **Kujdes!**

Në hadithe të ndryshme janë qortuar oguret (e mbarësisë ose fatkeqësisë) dhe është lavdëruar optimizmi. Dallimi ndërmjet këtyre të dyjave qëndron në dy aspekte:

1- Optimizmi është gjë e mirë, që e do shpirti; ai të mbush me gëzim dhe të motivon për punë të mira.

2- Optimizmi nuk merret si shkak për të vazhduar apo jo punën, por gjithsesi ai e motivon njeriun, e gjallëron dhe e forcon atë, ndryshe nga oguret (e mbarësisë ose fatkeqësisë). Këto të fundit janë prej shkaqeve të sajara që ndikojnë në vendimmarrjen e njeriut.

MËSIMI I SHTATË

KËRKIMI I SHIUT PREJ YJEVE²⁶

Kërkimi i shiut përmes yjeve ndahet në dy lloje:

Lloji i parë: Besimi që yjet ndikojnë vetvetiu për mirë ose për

²⁶ Buhariu në “*Sahih-un*” e tij thotë se Katade ka thënë: “*Allahu i ka krijuar yjet për tri qëllime: zbukurues të qiellit, gjuajtës për shejtanët dhe shenja orientuese. Kush u jep funksione të tjera, ka gabuar, e ka çuar jetën dëm duke u marrë me diçka të padobishme dhe e ka ngarkuar veten me diçka që nuk mund ta njohë*”.

Shkëputur nga libri “*Kitabu Teuhid*” i Muhamed bin Abduluehabit.

keq. **Ky është shirk i madh.**

Lloji i dytë: Besimi se yjet thjesht janë shkak për rënien e shiut, dhe se realisht është Allahu Ai që e zbret shiun. Në këtë rast, **konsiderohet shirk i vogël.**

MËSIMI I TETË:

KUR MIRËSITË I ATRIBUOHEN TJETËRKUJT VEÇ ALLAHUT TË LARTËSUAR

Në këtë kontekst është thënia e dikujt: *“Sikur të mos ishte filani, nuk do të kishte ndodhur kjo gjë.”*; apo: *“Këtë e kam arritur me djersën e ballit.”*

Allahu i Lartësuar është Bujari dhe Dhuruesi i Begatë. Të gjitha begatitë që gëzon njeriu janë vetëm prej mëshirës së Allahut; janë caktuar prej Tij dhe realizohen me mirësinë Tij. Allahu i Lartësuar thotë:

“Çdo mirësi që keni, është nga Allahu. E, nëse ju godet ndonjë fatkeqësi, prapë nuk keni kujt t’i kërkonit ndihmë përveç Tij.” (En-Nahl : 53)

➤ **Atribuimi i mirësive tjetërkujt veç Allahut të Lartësuar ndahet në disa lloje:**

Lloji i parë: Është shirk i madh, atëhere kur besohet se mirësitë nuk janë prej Allahut, por i atribuohen shkaqeve që kryhen apo dikujt a diçkaje që, në të vërtetë, nuk ka mundësi dhe nuk mund të quhet shkak, siç janë të vdekurit.

Lloji i dytë: Eshtë shirk i vogël, atëhere kur mirësitë i atribuohen një shkaku real, por harrohet Shkaktari i Vërtetë, që është Allahu i Lartësuar.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.” (El Bekare: 22)

Për domethënien e këtij ajeti kuranor, Ibn Abasi thotë: *“El-ëndad* është një lloj shirku, i cili është më i fshehtë se ecja e një milingone në një natë të errët në një gur të zi. Në këtë kontekst është dhe fjala e dikujt: ‘Beto hem për Allahun dhe për jetën tënde, o filan!’; ose: ‘Beto hem për jetën time!’; apo: ‘Po të mos ishte ky qen, do të na vidhnin hajdutët.’ (Ibn Ebi Hatim)

Lloji i tretë: Eshtë e lejuar, kur mirësitë ia atribuon një shkaku real, të vërtetë, duke qenë i qetë në zemër se Dhuruesi i Vërtetë është Allahu i Lartësuar, ndërsa ky shkak i drejtpërdrejtë është prej Allahut dhe vetëm prej Tij vjen begatia. Argument për këtë është hadithi që përcjell Abas bin Abdulmutalibi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) që tregon se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë për xhaxhain e tij Ebu Talibin: **“Po të mos lutesha unë, ai do të ishte në shtresën e fundit të Xhehenemit.”** (Buhariu dhe Muslimi)

MËSIMI I NËNTË:

KËRKIMI I BEREQETIT

Bereqeti është: fryt, dobi, vlerë dhe mirësi.

Kërkimi i bereqetit është disa lloje:

- **Lloji i parë: Kërkimi i bereqetit në mënyrë të ligjshme.**
Ky lloj ka dy nënndarje:

1- **Bereqeti i kësaj bote.** Që diçka të konsiderohet e bereqetshme, duhet patjetër të jetë provuar realisht se në të ka bereqet apo mirësi e begati të dukshme, siç është bereqeti nga trupi i bekuar i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ose bereqeti i ujit Zemzem.

2- Bereqeti i veprave të mira, që do të thotë se muslimani përmes adhurimeve kërkon shpërblimin e Allahut të Lartësuar.

➤ **Lloji i dytë: Bereqeti i ndaluar.**

Ky lloj ka disa nëndarje:

1- Shirk i madh: Është besimi se krijesa dhuron bereqet në mënyrë të vetvetishme, pa lejen dhe vullnetin e Allahut të Lartësuar. Ky është shirk i madh, sepse vetëm Allahu i Lartësuar është Ai që e ka krijuar bereqetin dhe e dhuron atë. Është transmetuar saktësisht se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Bereqeti është prej Allahut.”** (Buhariu)

2- Shirk i vogël: Është kërkimi i bereqetit në ato gjëra që nuk i ka lejuar sheriati islam.

3- Kërkimi i bereqetit përmes eulijave²⁷ dhe besimtarëve të devotshëm.

Ka shumë argumente që dëshmojnë lejueshmërinë e kërkimit të bereqetit përmes Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), sepse Allahu e bëri trupin e tij të bekuar. Kur ishte gjallë, lejohej kërkimi i bereqetit përmes prekjës së tij apo prej djersës, pështymës, flokëve dhe çfarë shkëputej prej trupit të tij të bekuar. Kjo është e veçantë vetëm për Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) gjatë jetës së tij. Ndërsa, pas vdekjes së tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), nuk lejohet që të kërkohet bereqet në varrin e tij.

Sa i përket eulijave, përveç Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), nuk ka ndonjë argument të saktë që e lejon kërkimin bereqetit prej trupave të tyre dhe as prej gjurmëve të tyre. Përkundrazi, veprimet e të parëve tanë të nderuar tregojnë për moslejimin e kësaj vepre. Kështu pra, nuk lejohet të kërkohet bereqeti përmes prekjës apo rrobave të

²⁷ Njerëzve të mirë.

tyre, apo pirjes pas tyre, apo puthjes dhe prekjes së varreve të tyre, apo marrjes së dheut nga këto varre për bereqet, apo adhurimit të Allahut në varret e tyre në kërkim të bereqetit, duke besuar se adhurimi në to është më i mirë se në vendet e tjera, dhe se kjo është shkak për pranimin e adhurimit dhe lutjeve. Të gjitha këto forma të kërkimit të bereqetit janë të ndaluara.

4- Kërkimi i bereqetit në kohë, në vende dhe në gjëra, për të cilat nuk ka argumente në shariat, që e lejojnë, si p.sh. kërkimi i bereqetit në malin Theur, në shpellën Hira dhe në malin e Arafatit. Muslimanit nuk i lejohet t'i vizitojë këto vende qëllimisht për ta adhuruar Allahun në to apo të prekë pjesë të ndryshme të tyre në kërkim të bereqetit. Dijetarët kanë rënë dakort unanimisht se të gjitha këto që u përmendën më sipër janë të ndaluara. Gjithashtu nuk lejohet kërkimi i bereqetit në disa kohë, siç janë netët apo ditët, për të cilat thuhet se kanë ndodhur ngjarje madhështore, siç është nata e Israsë dhe e Miraxhit, për të cilën thuhet se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është ngjitur në qiell, e të tjera si kjo.

5- Kërkimi i bereqetit në kohë, në vende dhe në gjëra, të cilat vërtet janë të vjera, por nuk ka argumente në shariat që lejojnë kërkimin e bereqetit në këto kohë, vende dhe objekte. Kështu pra, nuk lejohet që në këto vende të kryhen ibadete të caktuara apo të kërkohet bereqeti, sepse nuk kanë ardhur argumente në shariat, si p.sh. nuk lejohet që nata e 27-të e Ramazanit të veçohet me adhurime

të posaçme, siç është umreja (vizita e Qabes) etj. Nuk lejohet të kërkohet bereqet në muret e Qabes, duke i puthuar a fërkuar ato apo veprime të ngjashme me to.

MËSIMI I DHJETË

MAGJIA

➤ **Magjia është dy lloje:**

Lloji i parë: Talismanë, fryrje e lidhje nyjesh me natyrë politeiste, përmes të cilave magjistari afrohet tek shejtanët, për t'i përdorur ata në shërbim të vet, duke e dëmtuar njeriun që i bën magji.

Lloji i dytë: Ilaçe dhe barna që ndikojnë në trupin dhe në mendjen e atij që i bëhet magji. Po ashtu ato ndikojnë në dëshirat dhe vullnetin e tij. Për këtë arsye, ai urren dhe do përmes efektit të këtyre ilaçeve dhe barnave. Në këtë kontekst është edhe magjia, që bëhet për bashkimin dhe ndarjen e njerëzve. Në këtë lloj bën pjesë edhe ajo që quhet *tiuele*²⁸.

Ndjekësit e Traditës Profetike dhe Xhematit besojnë se magjia është e vërtetë dhe se ndikon në zemrën e në trupin e njeriut. Ajo mund të sëmurë e të vrasë. Një pjesë e saj është thjesht imagjinatë. Kështu p.sh. soditësit i duket sikur magjistari hyn në zjarr apo e godet veten me thikë etj. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Dhe njerëzit mësuani nga këta të dy se si t’i ndajnë bashkëshortët.”(El Bekare: 102)

Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) iu bë magji. Atij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i dukej sikur vepronte diçka, por në të vërtetë nuk kryente asgjë. Gjithsesi, magjistari nuk mund ta tjetërsojë objektin. Këtë nuk ka mundësi ta bëjë vetëm se Allahu i Lartësuar. Magjistari nuk mundet ta shndërrojë gurin në ar.

²⁸ Është magji për ta bërë gruan të dashur tek burri i saj dhe anasjelltas.

➤ **Çështje:**

Gjykimi për magjistarin

Për këtë çështje, dijetarët ndajnë dy mendime:

Mendimi i parë: Magjistari është jobesimtar.

Këtë mendim ka shumica e dijetarëve. Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar:

“E Sulejmani nuk ishte mohues, por djajtë ishin mohues. Ata u mësonin njerëzve magjinë.” (El Bekare: 102)

Mendimi i dytë: Ky është mendimi i imam Shafiut (Allahu e mëshiroftë!), i cili pohon se duhet pyetur magjistari. Atij i thuhet: **“Na e përshkruaj magjinë tënde.”** Nëse ai e përshkruan në atë mënyrë të atillë që duket qartë se është vepër kufri, në këtë rast, gjykohet se magjistari është jobesimtar. Përndryshe, nuk jepet ky gjykim.

Transmetohet se Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nuk e ka vrarë një shërbëtore, e cila i kishte bërë magji.

➤ **Bazuar në këtë arsyetim, gjykimi mbi magjinë ndahet në dy lloje:**

1- Një pjesë e magjisë është kufër – mohim; është ajo që realizohet përmes shejtanëve.

2- Një pjesë e magjisë është prej gjynaheve të mëdha; është ajo që realizohet përmjes ilaçeve, barnave dhe medikamenteve.

➤ **Çështje:**

Vrasja e magjistarit

E vërteta është se ai duhet të vritet. Këtë gjykim jep shkolla juridike e imam Malikut dhe imam Ahmedit. Transmetohet nga

Bexhale se ka thënë: “Një vit para se të ndërronte jetë Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), dërgoi një letër, në të cilën urdhëronte: ‘Vrisni çdo magjistar!’, dhe ne i vramë të gjithë magjistarët.” Këtë hadith e transmeton Buhariu. Mirëpo, shprehja “Vrisni çdo magjistar!” është në Musnedin e imam Ahmedit dhe nuk gjendet tek Buhariu.

Transmetohet se Hafsa (Allahu qoftë e kënaqur me të!) e ka vrarë një shërbëtore, e cila i kishte bërë magji.

➤ **Çështje: Prishja e magjisë**

Dijetarët përmendin dy mënyra për prishjen e magjisë:

Mënyra e parë: Prishja e magjisë me rukje: me leximin e Kuranit e lutjet profetike, si dhe me ilaçe të lejuara. Kjo mënyrë është e lejuar, madje e pëlqyer. Sepse, i Dërguari i Allahut, (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Nuk ka problem rukja, që nuk përmban shirk.”**

Mënyra e dytë: Prishja e magjisë me magji. Kjo vepër është shirk, nga hadithi që e përcjell Xhabiri, i cili na ka njoftuar se kur u pyet Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për *nushrën*²⁹, ai tha: **“Kjo është prej punëve të shejtanit.”** (Transmeton Ahmedi dhe të tjerë)

Dijetarët ndajnë mendime të ndryshme sa i përket kësaj fjale se: a është fjalë e Profetit apo e ndonjë sahabiu? Nga Ibn Mesudi është transmetuar diçka e ngjashme me këtë, si fjalë e një sahabiu.

➤ **Çështje: Pendimi i magjistarit**

A i pranohet pendimi magjistarit? Dijetarët kanë dy mendime për këtë:

Mendimi i parë: Nuk i pranohet pendimi magjistarit. Ky është

²⁹ Prishjen e magjisë me magji.

mendimi më i përhapur në shkollën juridike të imam Ahmedit, kështu që: ai vritet si tradhtar i fesë. Sa i përket faktit: a është penduar më gjithë zemër apo jo? Kjo është ndërmjet tij dhe Allahut.

Mendimi i dytë: Magjistarit i pranohet pendimi. Ky mendim bazohet në argumentet e përgjithshme, siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“Thuaj :‘O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.” (Ez-Zummer :53)

Në rastin kur thuhet se magjistarit i pranohet pendimi, duhet patjetër që pendimi të shoqërohet me disa gjëra të dukshme, të cilat tregojnë se është i sinqertë, është penduar me gjithë zemër.

➤ **Çështje: Ata që shkojnë tek magjistarët**

Ata që shkojnë tek magjistarët dhe fallxhorët ndahen në katër grupe:

Grupi i parë: Ata që shkojnë dhe u besojnë atyre në ndonjë çështje absolutisht të fshehtë ose në ndonjë çështje që është relativisht e fshehtë (jo absolute), si p.sh.: njohja e vendit ku është vendosur magjia apo njohja e vendit ku gjendet sendi i humbur etj. Mirëpo, këta nuk besojnë se magjistani apo fallxhori njoftohen prej shejtanëve. **Ky është kufër i madh,** sepse dija e të fshehtës është ekskluzivitet vetëm i Allahut të Lartësuar.

“Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato.” (El Enam: 59)

Grupi i dytë: Shkuarja tek magjistani apo fallxhori dhe besimi i fjalëve të tyre për ndonjë çështje relativisht të fshehtë, si p.sh.

njohja e vendit ku është fshehur magjia apo e vendit ku gjendet sendi i humbur, duke besuar se janë shejtanët ata që e njoftojnë për këtë. Për njeriun që kryen këtë veprim ka dy ndëshkime:

1- Nuk i pranohet namazi dyzet ditë.

2- Bie në kufër: mohon çfarë i është shpallur Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). **Ky është kufër i vogël.**

Grupi i tretë: Ata që shkojnë tek fallxhori apo magjistari thjesht për vizitë, pa u besuar atyre. Kjo nuk lejohet; **është haram.** Nuk lejohet të shkohet për vizitë te magjistari, në mënyrë që t'i pritët rruga së keqes. Argument për këtë është hadithi i transmetuar nga Muslimi, të cilin e përcjell Muaije bin Sulemi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), i cili ka thënë: “E pyeta Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): ‘O i Dërguari i Allahut! Ka prej nesh që shkojnë tek fallxhorët.’ Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: **“Mos shkoni tek ata.”**

Grupi i katërt: Ata që shkojnë tek magjistarët dhe fallxhorët, për t'i vënë në provë, që t'ua sqarojnë njerëzve realitetin e tyre, t'ua çjerrin maskën dhe të zbulojnë mashtrimin dhe kotësinë e tyre. Në këtë rast, vizita e tyre nuk ka problem. **Kjo është e lejuar.** Argument për këtë është veprimi i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili shkoi te Ibn Sajadi. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i fshehu atij diçka në vetvete, ndërsa ai nuk e gjeti. Më në fund, ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha: **“Nuk ke për ta kaluar cakun tënd si magjistar dhe fallxhor.”** (Buhariu)

KAPITULLI V

FJALË DHE SHPREHJE QË PËRMBAJNË SHIRK

- Mësimi i parë: Betimi për dikë tjetër përveç Allahut
- Mësimi i dytë: Si duhet të silllet njeriu me Allahun dhe krijesat e Tij, për gjërat që krijesa ka mundësi t'i bëjë?
- Mësimi i tretë: Emrat të cilat përmbajnë madhërim, nuk i takojnë vetëm se Allahut të Lartësuar
- Mësimi i katërt: Emrat me të cilat Allahu i Lartësuar ka emërtuar Vetën e Tij
- Mësimi i pestë: Emra nga të cilat nënkuptohet që përkushtimi me adhurim (të qenit rob adhurues) i drejtohet dikujt tjetër përveç Allahut
- Mësimi i gjashtë: Kërkimi i rreshjeve prej yjeve
- Mësimi i shtatë: Sharja e kohës
- Mësimi i tetë: Ankesa

MËSIMI I PARË

BETIMI PËR DIKË TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT

Betimi është premtim solemn duke përmendur emrin e Allahut ose ndonjë cilësi të Tij, për t'i qëndruar besnik dikujt apo diçkaje. Ai është adhurim, prandaj nuk lejohet betimi për dikë tjetër përveç Allahut. Në hadithin e përcjellë nga Ibn Umeri Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Sigurisht që Allahu jua ndalon të betoheni për baballarët tuaj. Kush do të betohet, le të betohet për Allahun e Lartësuar ose të heshtë.”** (Buhariu dhe Muslimi)

➤ **Betimi është dy lloje:**

Lloji i parë: Betimi për dikë tjetër përveç Allahut të Lartësuar, goftë ky profet apo njeri i mirë; po ashtu betimi për Qaben apo për diçka tjetër. Këto betime konsiderohen gjynah i madh, dhe nëpërmjet tyre njeriu **bie në shirk të vogël**.

Lloji i dytë: Kur ai që betohet ka për qëllim që përmes betimit të madhërojë krijesën, ashtu sikurse madhërohet Krijuesi (Allahu i Lartësuar). Në këtë rast, betimi është **shirk i madh**. Kësilloj betimi bëjnë shumë prej mistikëve.

MËSIMI I DYTË

SI DUHET TË SILLET NJERIU ME ALLAHUN DHE KRIJESAT E TIJ, PËR GJËRAT QË KRIJESA KA MUNDËSI T'I BËJË?

➤ **Kjo sjellje ka disa shfaqje:**

1- Të gjitha çështjet duhet t'i atribuohen vetëm Allahut të Lartësuar. Kjo tregon përsosmërinë e sinqeritetit të besimtarit, dhe e largon atë nga çdo formë e shirkut.

2- Përdorimi i ndajfoljes “pastaj”, si p.sh.: të thotë: *“Ndodhi ashtu siç dëshiroi Allahu, **pastaj** ashtu siç deshte filani.”* Kjo shprehje lejohet dhe është larg shirkut.³⁰

3- Përdorimi i lidhëzes “dhe”, siç është fjala: *“Ndodhi çfarë dëshiroi Allahu **dhe** çfarë dëshirove ti.”*; ose: *“Nuk kam askënd tjetër përveç Allahut **dhe** përveç teje!”* ose: *“Shpresoj tek Allahu **dhe** tek ti.”* Personi që thotë këto fjalë duke besuar se krijesa nuk ka dëshirë e vullnet të pavarur nga Allahu dhe se Krijuesi i Plotfuqishëm është Ai që ka në dorë gjithçka, **ky njeri bie në shirk të vogël**, sepse ai përdor lidhëzën “dhe”, pra, vë shenjën e barazimit ndërmjet dëshirës së Allahut dhe dëshirës së krijesave të Tij.

4- Është njësoj si rasti i tretë, mirëpo ky beson se krijesa ka

³⁰ Nga Kutejle përcillet se një hebre kishte shkuar te Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe i kishte thënë: “Ju bëni shirk, kur thoni: ‘Çfarë të dëshirojë Allahu dhe ti’ dhe kur betoheni: ‘Për Kaben!’” Atëherë Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) urdhëroi që kur të betoheshin, të thoshin: “Për Zotin e Qabes!” e gjithashtu të thoshin: “Çfarë të dëshirojë Allahu, pastaj ti”. (Ahmedi dhe En-Nesaiu, i cili edhe e ka saktësuar. Edhe sipas Albanit është i saktë.)

dëshirë dhe vullnet të pavarur nga Allahu i Lartësuar. **Ky njeri bie në shirk të madh.**

MËSIMI I TRETË

EMRAT TË CILAT PËRMBAJNË MADHËRIM,

NUK I TAKOJNË VETËM SE ALLAHUT TË LARTËSUAR

Emrat të cilat përmbajnë madhërim, nuk i takojnë vetëm se Allahut të Lartësuar, si p.sh.: *“Mbreti i mbretërve”, “Gjykatësi i gjykatësve”*³¹etj. Ky lloj emërtimi është haram³². Përcillet nga

³¹ Kjo temë lidhet me teuhidin, sepse kush vetëquhet me këtë emër, e ka konsideruar veten si të barabartë me Allahun në një titull që nuk e meriton askush përveç Tij. Përveç Allahut të Madhëruar, askush tjetër nuk e meriton të quhet *“Gjykatës i gjykatësve”, “Sundues i sunduesve”* apo *“Mbret i mbretërve”*. Allahu është Gjykatës mbi çdo gjykatës, në dorën e Tij është gjykimi dhe tek Ai kthehen të gjitha çështjet, siç thotë Ai vetë në Kuran.

(Shkëputur nga libri *“Komentar i librit të Teuhidit”* i shejh Ibn Uthejmin)

³² Shtrohet pyetja: A lejohet që këtë emërtim ta përcaktojmë dhe kufizojmë me një grup të caktuar, vend të caktuar ose kohë të caktuar, si për shembull të themi: gjykatës i gjykatësve në jurisprudencë, gjykatës i gjykatësve në Arabinë Saudite, ose gjykatës i gjykatësve në Egjipt, Jordani etj.?

Kufizimi me vend lejohet, sepse gjykimi i Allahut është i pakufizuar. Kështu që pohimi nuk vë shenjën e barazimit mes pushtetit të Allahut të Madhëruar dhe pushtetit të krijesave të Tij. Megjithatë, edhe pse lejohet, nuk është mirë që njeriu të përdorë të tilla emërtime, pasi është e vështirë ta kontrollojë veten, nëse i thonë *“gjykatësi i gjykatësve”* në një zonë të caktuar. Ndoshta atij mund t'i pëlqejë vetja ose të vetëmashtrohet, aq sa të mos e pranojë më të vërtetën, nëse bie ndesh me mendimin e tij. Është e rrezikshme kur njeriut i

Ebu Hurejre se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Emri më i përbuzur tek Allahu është dikush që cilësohet si ‘Mbreti i mbretërve.’”** (Buhariu dhe Muslimi)

MËSIMI I KATËRT:

EMRAT ME TË CILAT ALLAHU I LARTËSUAR KA EMËRTUAR VETEN E TIJ

Emrat e Allahut ndahen në dy kategori:

Kategoria e parë: Emra të veçantë për Allahun e Lartësuar, si: “Allah”, “Er-Rahman-i Gjithëmëshirshmi” “Rabul alemin - Zoti i botëve” e të tjera si këto. Përveç Allahut, nuk i lejohet askujt të emërtojë veten me të tillë emra. Madje, emërtimi me këta emra konsiderohet shirk.

Kategoria e dytë: Emra të cilat nuk janë të veçanta për Allahun e Lartësuar, si p.sh.: “Er-Rahim - Mëshirëploti” “El Hakem - Gjykuesi” e të tjera si këto. Lejohet që dikush tjetër përveç Allahut të emërtohet me këta emra, me kusht që thjesht të ketë për qëllim emërtimin, njohjen dhe të mos shfaqet kuptimi i këtij emri (atributi).

pëlqen mendimi i vet, deri atje sa t’ua imponojë atë edhe të tjerëve. (Shkëputur nga libri “Komentar i librit të Teuhidit” i shejh Ibn Uthejmin)

MËSIMI I PESTË:

EMRA NGA TË CILAT NËNKUPTOHET QË PËRKUSHTIMI ME ADHURIM (TË QENIT ROB ADHURUES) I DREJTOHET DIKUJT TJETËR PËRVEÇ ALLAHUT

E tillë është fjala e pronarit që i thotë robit të vet: “robi im”; ose i thotë robëreshës: “robëresha ime”; apo fjalë të tjera si këto, si p.sh.: “robi i filanit”; ose robi i thotë pronarit të vet: “zotëriu im”.

Të gjitha këto nuk lejohen. Në tekstet e shariatit ka ardhur ndalesë e qartë.³³

Ky konsiderohet shirk në emërtim. Për shembull, të tillë janë emrat: Abduamër (robi i Amrit), Abduatemim (robi i Temimit), Abdukabe (robi i Qabes), Abdulhusejn (robi i Hysenit) etj. Këto nuk lejohen, sepse njeriu është vetëm rob i Allahut dhe i askujt tjetër. Kështu që, kur dikush thotë për skllavin e vet: “Ky është robi im.”, apo për skllaven: “Kjo është robëresha ime.”, në fakt, ky është sikur po ia atribuon vetes zotërimin e këtyre krijesave. Sigurisht që vetëm Allahu është Zoti, Zotëruesi, Krijuesi i krijesave dhe Drejtuesi i çështjeve të tyre.

³³Sipas një hadithi të saktë, përcjellë nga Ebu Hurejre, Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Askush të mos thotë: ‘Çoji ushqim dhe jepi ujë për abdest zotërisë tënd!’ Përkundrazi, thoni: ‘i nderuari im’ ose ‘pronari im’. Askush të mos thotë: ‘robi im’ apo ‘robëresha ime’, por thoni: ‘djali im’, ‘vajza ime’, ‘shërbëtori im’.”** (Buhariu dhe Muslimi)

MËSIMI I GJASHTË:

KËRKIMI I RRESHJEVE PREJ YJEVE

Kërkimi i shiut prej yjeve behet duke ia atribuar atyre rënien e shiut. Arabët besonin se yjet janë shkak për rënien e shiut, pra i konsideronin ata shkaktarë. Një grup i vogël prej tyre besonin se vetë yjet sjellin shiun. Buhariu përcjell fjalën e Zejd bin Halidit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!), ku ndër të tjera thotë: “I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e fali namazin e sabahut në Hudejbije, pas një nate me shi. Pasi përfundoi namazin, u kthye nga njerëzit dhe tha: **‘A e dini çfarë tha Zoti juaj?’** Ata thanë: ‘Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë.’ Ai tha: **‘Disa nga robërit e Mi janë gdhirë besimtarë dhe disa të tjerë jobesimtarë. Ai që tha: ‘Shiu ra me mirësinë dhe mëshirën e Allahut,’ më beson Mua dhe nuk beson tek yjet (në ndikimin e tyre); ndërsa ai që tha: ‘Shiu ra për shkak të këtij apo atij ylli’, nuk beson në Mua dhe beson tek yjet.’**”

- Njerëzit që thonë “Shiu ra për shkak të këtij apo atij ylli”, ndahen në disa kategori:

Kategoria e parë: Besimi se shiun e zbresin vetë yjet dhe jo Allahu. Ky është besim pagan; është kufër dhe shirk i madh.

Kategoria e dytë: Besimi se ylli është shkak për rënien e shiut me caktimin e Allahut. Ky konsiderohet shirk i vogël.

Kategoria e tretë: Kur me shprehjen e mësipërme ka për qëllim të tregojë kohën, si p.sh. thotë: “Shiu ra në këtë apo atë kohë”. Kjo lejohet.

MËSIMI I SHSTATË:

SHARJA E KOHËS

Kemi për qëllim sharjen e kohës duke përdorur shprehje fyese, mallkime e të tjera, të cilat dalin nga gojët e të paditurve. Sa herë u ndodh diçka e padëshirueshme, ata shajnë e mallkojnë ditën, vitin, muajin etj.

Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), siç transmetohet tek Buhariu dhe Muslimi, në një hadith që e përcjell Ebu Hurejre (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: **“Allahu i Lartësuar thotë: ‘Më lëndon biri i Ademit, kur shan kohën. Sepse, Unë jam koha. Unë e ndërroj natën dhe ditën.’** Në një transmetim tjetër thuhet: **“Mos e shani kohën, sepse Allahu është koha.”**

➤ **Njerëzit që e shajnë kohën ndahen në tre kategori:**

Kategoria e parë: Ata që e shajnë kohën duke besuar se vepron ajo dhe jo Allahu.

Ky veprim është shirk i madh.

Kategoria e dytë: Ata që e shajnë kohën duke mos besuar në ndikimin dhe veprimin e saj; në këtë rast, **është haram.**

Kategoria e tretë: Ata që thjesht duan të njoftojnë për gjendjen e kohës si p.sh. ai që thotë: “Sot është një ditë e nxehtë.”; ose pohon: “Kaluam një ditë të vështirë.” Në këtë kontekst është edhe fjala e Allahut të Lartësuar, e përmendur prej Jusufit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): **“Pastaj do të vijnë shtatë vite të thata.”** (Jusuf: 48) Një rast si ky nuk konsiderohet sharje; këtë e përmendëm thjesht për të sqaruar kategorizimin e njerëzve në qëndrimin e tyre ndaj kohës.

MËSIMI I TETË

ANKESA

➤ **Ankesa ndahet në dy lloje:**

Lloji i parë: Ankesa tek Krijuesi. Kjo nuk bie ndesh me durimin. Në këtë kontekst është dhe fjala e Ejubit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

“(Kujtoje) Ejubin, kur iu lut Zotit të vet: ‘Mua më ka goditur fatkeqësia e Ti je më mëshiruesi i mëshiruesve!’ (El Enbija: 83)

Lloji i dytë: Ankesa tek njerëzit. Ky lloj ka dy nënndarje:

1- Ankesa e ndaluar, e cila shfaqet në formën e zemërimit ndaj caktimit të Allahut të Lartësuar.

2- Ankesa e lejuar, e cila është thjesht një formë njoftimi dhe nuk përmban në vetvete zemërim apo urrejtje ndaj caktimit të Allahut, siç është ankesa tek doktori për dhimbjet që ndjen ose kur ankohesh tek ndonjë person për ndonjë hall a problem, teksa ai ka mundësi ta zgjidhë.

➤ **Rënkimi është dy llojesh:**

Lloji i parë: Rënkimi në formë ankese; është e urryer.

Lloji i dytë: Rënkimi për t’u qetësuar dhe lehtësuar; nuk është e urryer.

KAPITULLI VI

EL UELAU UE EL BERRAU, BIDATI DHE TEKFI RI

- Mësimi i parë: El uelau ue el berau- miqësimi dhe armiqësimi
- Mësimi i dytë: Tekfiri
- Mësimi i tretë: Gjykimi jo sipas asaj që ka zbritur Allahu i Lartësuar
- Mësimi i katërt: Për bidatin

MËSIMI I PARË

EL UELAU UE EL BERAU- MIQËSIMI DHE ARMIQËSIMI

Miqësimi dhe armiqësimi janë prej bazave më madhështore të besimit.

➤ ***El Uelau – miqësimi e besnikëria:*** Është dashuria dhe ndihma për besimtarët, për shkak të besimit të tyre. Gjithashtu në këtë koncept mishërohet çdo gjë që ka lidhje me të drejtat e besimtarëve. Nëse njeriu këmbëngul në ndonjë gjynah të madh (ndërkaq bën edhe vepra të mira), ne e duam atë në varësi të bindjes që ai tregon ndaj Allahut të Lartësuar; si dhe e urrejmë në varësi të gjynaheve që bën ndaj Tij. Dashuria ndaj muslimanit gjynahqar, e kërkon që ta braktisë e t'i mbash mëri atij, nëse ky qëndrim e bën atë të heqë dorë nga mëkatet.

Gjithashtu ndër kërkesat kryesore të dashurisë ndaj muslimanit janë: këshilla, urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga të këqijat. Sikurse dashuria ndaj gjynahqarit e kërkon që atij t'i jepet masa ndëshkimore edukative, në mënyrë që të pendohet tek Allahu i Lartësuar.

Atij që ka shenja hipokrizie, ia shprehim dashurinë dhe e duam në varësi të mirësisë që shfaq; si dhe e urrejmë në varësi të ligësisë që ai nxjerr në shesh. Nëse *nifaku*³⁴ i tij është i madh, që e nxjerr nga Islami (besimi), gjykimi për të, në kapitullin "*El uelau ue el berau - miqësimi dhe armiqësimi*", është njësoj si për pabesimtarët e tjerë.

³⁴ Hipokrizia.

- **Sa i përket bidatçinjëve**, si: xhehmitë, kaderitë, rafidat, esharinjte, hauarixhët, shiat e sektit zejdi etj., këta ndahen në tre kategori:

Kategoria e parë: Kush thërret në bidat apo e shfaq atë, teksa kjo vepër nuk e nxjerr nga Islami, ai duhet të urrehet në varësi të bidati që kryen. Po ashtu ai duhet të braktiset e të kundërshtohet, përderisa në këto veprime nuk ka ndonjë dëm të madh. Për këtë kanë rënë dakort dijetarët. Nuk lejohet qëndrimi dhe biseda me të, nëse këto nuk janë të nevojshme, përveç rastit kur bidatçiu këshillohet.

Kategoria e dytë: Nëse bidati e nxjerr njeriun nga Islami, siç është rasti i mistikëve ekstremistë, të cilët u lutën të vdekurve dhe eulijave të tyre apo shijat e sektit imamij, të cilët pretendojnë se Kurani është tjetërsuar, sigurisht që, pasi atyre u janë sqaruar argumentet dhe nuk i pranojnë ato, gjykohet se kanë tradhtuar fenë. Për të tillë njerëz mbahet qëndrim njëjloj si për jobesimtarët e tjerë.

Kategoria e tretë: Ai që e fsheh bidatin dhe nuk fton në të, nuk e konsideron diçka të mirë dhe nuk i lavdëron bidatçinjtë, si dhe nuk përhap dilema dhe paqartësi. Një njeri i tillë, është si mëkatari që i fsheh mëkatet e tij. Me këtë njeri mund të qëndrosh dhe ta përshëndetësh me selam; nuk lejohet ta braktisësh. Ndërsa disa prej të parëve tanë të mirë i kanë braktisur këta gjynahqarë, pasi nuk e kanë pranuar këshillën.

- **El Berau - armiqësimi:** Është urrejtja ndaj armiqve të Allahut dhe armiqësimi me ta, largimi prej tyre dhe përpjekja për t'i luftuar ata, në varësi të mundësisë.

➤ **Jobesimtarët ndahen në disa kategori:**

Kategoria e parë: *El Muahidunë*: Janë ata të cilët jetojnë në vendet muslimane, teksa këto vende kanë nënshkruar me ta marrëveshje, siç janë në kohën tonë marrëveshjet që lidhen ndërmjet shteteve muslimaneve dhe jomuslimane përmes ambasadave apo institucioneve tjera, që kanë në fokusin e tyre lidhjet dypalëshe.

Kategoria e dytë: *Edh-Dhimijunë*: Janë jomuslimanët me të cilët muslimanët kanë bërë marrëveshje, nëpërmjet së cilës atyre u garantohen të drejtat publike dhe private, sikurse u garantohen edhe muslimanëve; ndërkaq ata u paguajnë muslimanëve xhizjen dhe kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e sheriatit islam për çështje që muslimanët besojnë në shenjtërinë e tyre.

Kategoria e tretë: *El Musteminunë*: Janë jomuslimanët që hyjnë në vendet islame me leje të udhëheqësit apo të ndonjërit prej muslimanëve. Pra, janë vizitorët e përkohshëm, ata që merren me tregti etj. Allahu i Lartësuar thotë:

“Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhamed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e Allahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë.” (Et-Teube: 6)

Nga gjithë kjo që u përmend, bën përjashtim Gadishulli Arabik. Në Gadishullin Arabik nuk lejohet të hyjnë jobesimtarët, përveçse në rastet kur është e nevojshme. Pra, atyre nuk u lejohet që të jenë rezidentë të përhershëm në këtë gadishull. Argument për këtë është fjala e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), e përcjellë nga Ibn Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!): **“Nxirrini idhujtarët nga Gadishulli Arabik.”**(Buhariu dhe Muslimi). Bazuar në këtë hadith,

theksojmë se nuk lejohet që jobesimtarët të pranohen në Gadishullin Arabik si punëtorë, ndërkohë që ka prej muslimanëve që mund t'i bëjnë ato punë.

Kategoria e katërt: *El Harbijunë*: Janë jomuslimanët e tjerë të vendeve pabesimtare, me të cilët shteti islam nuk ka marrëveshje paqeje e sigurie. Lejohet që muslimanët t'i luftojnë ata, në varësi të mundësive që kanë. Allahu i Lartësuar thotë:

“Nëse nuk shmangen prej jush, nëse nuk ju ofrojnë paqen dhe nëse nuk heqin dorë nga luftimi kundër jush, atëherë i kapni e i vrisni kudo që t'i gjeni! Kundër tyre ju kemi dhënë të drejtë të qartë.” (En-Nisa: 91)

➤ **Në marrëdhëniet me jobesimtarët që jetojnë në vendet islame, muslimanët duhet të kenë parasysh gjërat e mëposhtme:**

1- Nuk lejohet dashuria për jobesimtarët dhe miqësimi me ta. Allahu i Lartësuar thotë:

“Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahimimi dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet: ‘Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia e urrejtja midis nesh është e përhershme, derisa të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm’. Përrjashtim (nga ky shembull) bën fjala e Ibrahimimit për të atin: **‘Unë do të kërkoj falje për ty, por nuk kam kurrfarë mundësie për të të mbrojtur para Allahut. O Zoti ynë, tek Ti mbështetemi, Ty të drejtohemi dhe tek Ti do të kthehemi.’** (El Mumtehine: 4)

2- Nuk lejohet përngjasimi me jobesimtarët në gjëra që janë specifike për ta, me të cilat ata dallohen nga muslimanët. Allahu i Lartësuar thotë:

“E të mos bëhen si ata, që iu është dhënë Libri më parë?!” (El Hadid: 16)

3- Nuk lejohet që jomuslimanët të shfaqin lirshëm simbolet e fesë së tyre, si: adhurimet, festat dhe gjynahet.

4- Nuk lejohet të ndërtojnë kishat apo tempujt e tyre në vendet muslimane.

5- Nuk lejohet zgjedhja e tyre si miq dhe këshilltarë të afërt të muslimanëve. Allahu i Lartësuar thotë: “O besimtarë! Mos zgjidhni për miq dhe këshilltarë të afërt njerëz të tjerë jashtë gjirit tuaj; ata nuk ngurrojnë që t’ju bëjnë dëm. Ata dëshirojnë që të vuani. Urrejtja shfaqet në gjithçka që del prej gojës së tyre, kurse ajo që fshehin në zemrën e tyre, është edhe më e madhe. Ne jua kemi shpjeguar vargjet (e Kuranit), nëse jeni njerëz që kuptoni.” (Ali Imran: 118)

6. Nuk lejohet të jetohet me ta në të njëjtën banesë.

7- Nuk lejohet urimi për festat e tyre fetare, si p.sh.: urimi për Krishlindjet etj.

➤ **Të drejtat publike të jomuslimanëve në vendet islame:**

1- E drejta për t’i mbrojtur, përderisa jetojnë në vendet islame. Allahu i Lartësuar thotë:

“Nëse ndonjë nga idhujtarët kërkon mbrojtje nga ti (Muhamed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e Allahut,

e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë.” (Et-Teube: 6)

2- Gjykimi me drejtësi ndërmjet tyre dhe muslimanëve, si dhe midis tyre me njëri-tjetrin. Allahu i Lartësuar thotë: **“Le të mos ju nxisë urrejtja ndaj njerëzve për të bërë padrejtësi. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësojuni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.”** (El Maide: 8)

3- Thirrja e tyre në Islam. Muslimanët e kanë detyrë kolektive t’i thërrasin jobesimtarët në fenë e vërtetë.

4- E drejta e lirisë së besimit. Nuk lejohet që hebrenjtë, të krishterët etj. të detyrohen të ndryshojnë besimin e tyre. Allahu i Lartësuar thotë:

“S’ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!” (El Bekare: 256)

5- Muslimanëve nuk u lejohet t’i sulmojnë jobesimtarët. Përcillet nga Abdullah bin Amër (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Kush vret një jobesimtar *muahid*³⁵, nuk do ta ndjejë aromën e Xhenetit, ndonëse aroma e tij ndihet në një largësi prej 40 vitesh.”** (Buhariu)

6- Muslimanit nuk i lejohet të mashtrojë jobesimtarët.

³⁵ *El Muahidunë:* Janë ata të cilët jetojnë në vendet muslimane, teksa këto vende kanë nënshkruar me ta marrëveshje, siç janë në kohën tonë marrëveshjet që lidhen ndërmjet shteteve muslimaneve dhe jomuslimane përmes ambasadave apo institucioneve tjera, që kanë në fokusin e tyre lidhjet dypalëshe.

7- Muslimanit nuk i lejohet t'i bëjë keq ndonjërit prej pabesimtarëve.

8- Muslimanit i lejohet t'ia kthejë *selamin* jomuslimanit³⁶. Kur ky i fundit e përshëndet me fjalët: *“Es-selamu alejkum! - Paqja e Zotit qoftë mbi ju!”*, muslimani ia kthen: *“Ue alejkum - Dhe mbi ju!”*. Vetëm kaq i thotë, sepse Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), siç percillet nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: **“Kur ju përshëndesin me *selam* ithtarët e Librit, kthejauni atyre duke thënë: ‘Ue alejkum - Edhe mbi ju!’”** (Buhariu dhe Muslimi). Mirëpo, muslimanit nuk i lejohet që ai i pari ta përshëndesë me *selam* jobesimtarin. Muslimanit i lejohet të sillet butë me të, me qëllim t'ia bëjë atij të dashur Islamin, t'i thërrasë me emrat që atij i pëlqejnë, ta pyesë për shëndetin, familjen, ta përshëndesë i pari duke i thënë për shembull: *“Mirë se vjen!”* e kështu me radhë.

➤ **Cila është fusha e bashkëpunimit që muslimanit i lejohet të punojë bashkë me jobesimtarin?**

1- Muslimanit i lejohet të bashkëpunojë me jobesimtarin në ato punë në të cilat ky i fundit nuk e drejton muslimanin. Transmetohet se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur emigroi mori për udhërrëfyes (me pagesë) Abdullah bin Erikat. (Buhariu)

2- Është e pëlqyer që muslimani t'u bëjë mirë jomuslimanëve dhe t'i ndihmojë nevojtarët nga radhët e tyre, si p.sh. t'u japë lëmoshë të varfërve etj. Allahu i Lartësuar ka thënë:

³⁶ Jomusliman me të cilin shteti islam ka akt sigurie dhe paqe.

“Bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.” (El Bekare: 195)

3- Lejohet t’u japë dhurata atyre për t’i afruar në Islam, apo diçka të ngjashme me këtë; gjithçka që sheriatit islam e konsideron gjë të rëndësishme. Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.” (El Mumtehine: 8)

4- Kur jomuslimani shkon tek muslimani si mik, është e pëlqyer ta nderojë atë. Po ashtu muslimanit i lejohet ta vizitojë jomuslimanin.

5- Muslimanit i lejohet t’i përgjigjet ftesës së jomuslimanit, kur e kërkojnë interesat e sheriatit, sikurse Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i është përgjigjur ftesës së një çifuti. (Buhariu)

6- Muslimanit i lejohet të hajë ndonjëherë rastësisht me ta, por jo t’i bëjë ata miq apo të ulët dhe të ushqehet gjithmonë me ta.

7- I lejohet që të bashkëpunojë me ta për çështje të lejuara të kësaj jete. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bashkëpunoi me çifutët: u blinte dhe u shiste atyre mallra.

8- Muslimanit i lejohet të martohet me jobesimtare - ndjekëse (ithtare) të Librit, vetëm se ajo duhet të jetë e ndershme, pasi të sigurohet se kjo martesë nuk e dëmton atë vetë, as fenë dhe pasardhësit e tij. Allahu i Lartësuar thotë: “Sot ju janë lejuar gjërat e mira e të pastra. Ju janë lejuar edhe ushqimet e ithtarëve të Librit; po ashtu, edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ata. Të lejuara për ju janë femrat e

ndershme besimtare dhe femrat e ndershme të atyre që u është dhënë Libri para jush.” (El Maide: 5)

9- Muslimanëve u lejohet të kërkojnë ndihmën e jobesimtarëve për t’u mbrojtur nga sulmet e të tjerëve. Mirëpo, kjo mund të realizohet vetëm pasi të plotësohen dy kushte:

Kushti i parë: Kur e kanë të domosdoshme kërkimin e ndihmës prej tyre.

Kushti i dytë: Kur janë të sigurt nga kurthet e dredhitë e tyre, në mënyrë që të mos dëmtohen.

10- Muslimanit i lejohet të shkojë të vizitohet te një mjek jomusliman, nese ky i fundit është njeri i besueshëm.

11- Muslimanit i lejohet t’i japë zekatin e pasurisë jomuslimanëve, për t’i fituar zemrat. Allahu i Lartësuar thotë: “Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për ata që u duhen fituar zemrat.” (Et-Teube: 60)

12- Muslimanit i lejohet të bëhet ortak me jobesimtarin në tregti, me kusht që muslimani të mbikëqyrë e të drejtojë këtë punë.

13- Muslimanit i lejohet të pranojë dhurata nga jobesimtari, nëse nëpërmjet saj nuk poshtërohet dhe nuk i shkakton atij ndonjë lloj dashurie a miqësie për të. Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i pranonte dhuratat që i jepnin shumë prej idhujtarëve.

14- Muslimanit i lejohet të punojë tek jobesimtari, sikurse i lejohet të bëjë ndonjë punë që drejtohet nga jobesimtari,

mirëpo atij nuk i lejohet të jetë shërbëtor personal i jobesimtarit, si p.sh. të gatuajë për të apo t'ia lajë rrobat.

15- Lejohet t'i urojë jobesimtarët për gëzime për gjëra që kanë të bëjnë me çështjet e jetës së kësaj bote, si p.sh. për lindjen e një fëmije etj, nëse kjo shihet me interes në sheriatin islam.

➤ **Miqësia me jobesimtarët, e cila e çon muslimanin në kufër**

Dashuria ndaj jobesimtarëve për shkak të fesë së tyre, ndihma dhe përkrahja kur luftojnë kundra muslimanëve, mbështetja me pasuri, me armë apo vënia në shërbim të tyre: si spiun a agent i tyre kundra muslimanëve, të gjitha këto, si shprehje e besnikërisë dhe dashurisë për ta, sigurisht që këto janë shfaqje të miqësisë së ndaluar të muslimanit ndaj jomuslimanëve dhe çojnë në kufër, pra e nxjerrin nga Islami. Në lidhje me këtë çështje, shumë njerëz të dijes kanë përmendur dakortësinë e dijetarëve.

Nëse muslimani e bën këtë, për shkak të interesave personale apo nga frika, kjo konsiderohet gjynah i madh, por nuk bën pjesë në kufrin që e nxjerr njeriun nga Islami. Argument për këtë është hadithi i Ali bin Ebi Talibit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) që tregon për historinë e Hatib bin Ebi Beltës. Hatibi dërgoi një letër tek kurejshët, në të cilën i njoftonte për planet e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Ndërkaq, kur e mori vesh Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i tha atij: **“O Hatib! Ç’është kjo?”** Hatibi pohoi: “O i Dërguari i Allahut, mos merr vendime të nxituara kundra meje. Unë kam pasur lidhje me kurejshët, por nuk jam prej tyre. Muhaxhirët e tjerë, që janë pranë teje, kanë njerëz të afërm që ua mbrojnë familjet dhe pasurinë në Mekë.

Ndërsa unë nuk kam ndonjë prej njerëzve që t'i mbrojnë të afërmit e mi në Mekë. Prandaj, mendova t'u shkruaj kurejshëve këtë letër, për të mbrojtur familjarët e mi. Nuk e bëra këtë duke mohuar a tradhëtuar fenë time; dhe as ia kam hapur zemrën kufrit, sepse unë jam musliman." Atëhere Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: **"Ky është i sinqertë."**

➤ **Nënçështje:**

Të qenit i kënaqur me kufrin e jomuslimanëve apo moscilësimi i tyre si pabesimtarë, apo dyshimi në kufrin e tyre, apo besimi se ata janë në rrugën e drejtë, të gjitha këto, konsiderohen shfaqje kufri. Gjithashtu, edhe thirrja për afrimin dhe bashkimin e feve është kufër; ose ajo që në ditët e sotme quhet "Feja e Ibrahimit". Sigurisht që ai i cili beson se ndonjë fe tjetër veç Islamit është e vërtetë, konsiderohet jobesimtar. Allahu i Lartësuar thotë: **"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur."** (Ali Imran: 85)

➤ **Banimi i përhershëm në vendet jomuslimane**

Ka disa lloje:

Lloji i parë: Rasti kur personi banon në këto vende miqësohet dhe i përkrah pabesimtarët, si p.sh. u përngjason atyre në çështje që konsiderohen herezi - dalje nga feja islame; ose p.sh.: rasti kur vendos kryqin në shenjë adhurimi apo kryen rite adhurimi si ata, apo përvetëson një pjesë të besimit të tyre, të gjitha këto, janë tradhti ndaj fesë, janë kufër i madh që e nxjerrin njeriun nga Islami. Allahu i Lartësuar thotë: **"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur."** (Al Imran: 85) I tillë është edhe rasti kur viziton kishat duke besuar se vizita e

tyre është formë adhurimi dhe mënyrë për t'u afruar tek Allahu i Lartësuar.

Lloji i dytë: Nëse personi që banon në këto vende nuk e shfaq dot fenë dhe nuk shpërngulet prej tyre, ndonëse ka mundësi, kjo konsiderohet haram. Për këtë çështje Allahu i Lartësuar thotë:

“Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me faje, u thonë: ‘Ku ishit?’ Ata përgjigjen: ‘Ishim të pafuqishëm në Tokë’. (Engjëjt) do t’u thonë: ‘A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?’ Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenemi; eh, sa i keq është ai vendbanim!” (En-Nisa: 97)

Lloji i tretë: Në disa raste lejohet banimi në vende jomuslimane.

Kjo manifestohet në dy forma:

E para: Kur ka mundësi ta shfaqë fenë e tij dhe ta zbatojë atë.

E dyta: Kur nuk ka mundësi të shpërngulet nga vendi jomusliman, për shkak të ndonjë sëmundjeje apo kur është i detyruar të qëndrojë atje. Për këtë Allahu i Lartësuar thotë: “Me përjashtim të meshkujve të pafuqishëm, grave dhe fëmijëve, të cilët nuk kanë as fuqinë e as mundësinë të drejtohen në rrugë.” (En-Nisa: 98)

➤ **Çështje: Si realizohet manifestimi i besimit?**

Realizohet përmes shfaqjes së besimit në një Zot të Vetëm, faljes së namazit etj. Muslimani që e manifeston besimin nuk e ka për detyrë patjetër të shfaqë përbuzjen ndaj zotave të rremë të pabesimtarëve. Nga sa u tha më sipër, kuptohet se

udhëtimi në vendet pabesimtare për tregti, e të tjera punë si këto, është i lejuar, sepse nuk ka argument që e ndalon këtë gjë. Mirëpo, ka një kusht: duhet që muslimani ta shfaqë besimin e tij, përveç rastit kur ka frikë për veten se mund të shkelë kufijtë e Allahut, për shkak të tundimeve që vijnë nga epshet apo dilemat, në këtë rast, nuk lejohet të udhëtojë. Ky nuk është gjykim i veçantë vetëm për vendet jomuslimane. Madje, as në disa vende islame nuk lejohet udhëtimi, nëse muslimani ka frikë se mos tundohet në fenë dhe moralin e tij.

MËSIMI I DYTË

TEKFIRI³⁷

➤ **Rregulla të rëndësishme për njohjen e llojeve të kufrit:**

Rregulli i parë: Vetëm Allahu dhe i Dërguari i Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kanë të drejtën e tekfirit.

Pra, për të vërtetuar që fjala apo vepra është kufër, duhet t'u referohemi teksteve të shenjta (Kuranit dhe Sunnetit). Gjykimi nuk duhet të bazohet në tekat apo orekset e njerëzve, as në mendimet e këqija, as në hamendësitë apo keqkuptimet e tyre.

Rregulli i dytë: Kufri ka shumë degëzime, ashtu si dhe besimi. Transmetohet saktësisht tek Buhariu dhe Muslimi, në hadithin e përcjellë nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!), se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Besimi është 70 e ca degë. Shkalla më e lartë e besimit është fjala ‘La ilahe il Allah - Nuk ka tjetër të adhuruar me meritë përveç Allahut’. Shkalla më e ulët e tij është heqja e diçkaje të**

³⁷ Akuzimi i muslimanit për mosbesim dhe nxjerrja tij nga feja.

dëmshme nga rruga. Edhe turpi është prej degëve të besimit.”

Rregulli i tretë: Çdo shirk është kufër, por jo çdo kufër është shirk³⁸.

Rregulli i katërt: Fjala kufër ka ardhur në tekstet e shenjta të Kuranit dhe Sunetit në dy forma:

E para: Me parashtesën “elif” dhe “lam”; pra vjen në trajtën e shquar :“*el Kufru*”, që ka për qëllim kufirin e madh, i cili e nxjerr muslimanin nga feja.

E dyta: Vjen në trajtën e pashquar, pra pa parashtesën “elif” dhe “lam”. Ai nuk i atribuohet një personi konkret dhe përmes tij nuk specifikohet një njeri i caktuar. Përgjithësisht kjo formë e të shprehurit nuk konsiderohet kufër i madh. Përkundrazi, në thelb, ky është kufër i vogël, që nuk e nxjerr muslimanin nga Islami.

Rregulli i pestë: Ndjekësit e Traditës Profetike dhe Xhematit e konsiderojnë çështjen e tekfirit shumë të rrezikshme. Ata pohojnë se kjo çështje është e drejtë ekskluzive vetëm e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Në këtë kontekst, ata theksojnë se askujt nuk i lejohet të akuzojë muslimanin për mosbesim dhe ta nxjerrë atë nga feja. Kjo është e drejtë vetëm e Allahut dhe të Dërguarit të Tij, pra me argumente të qarta nga Kurani dhe Suneti i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

Rregulli i gjashtë: Ka ndryshime të dukshme ndërmjet tre fazave të kufirit, i cili e nxjerr njeriun nga Islami dhe e bën atë tradhëtar të fesë.

³⁸ Koncepti i kufirit është më i gjerë se ai i shirkut. Shirku është vetëm një pjesë e kufirit

Këto tre faza janë:

E para: Faza në të cilën gjynahu, përmes argumenteve të sheriatit, konsiderohet kufër i madh.

E dyta: Pastaj vjen faza e “*tekfirit el muajen*”³⁹. Ka dallim ndërmjet *tekfirit absolut* dhe *tekfirit el muajen*. Ky i fundit nuk mund të realizohet vetëm pasi të plotësohen kushtet dhe të largohen pengesat. Këtë gjë e sqarojnë njerëzit e dijes.

E treta: Pastaj vjen faza e tretë, në të cilën operohet në mënyrë të tillë: Nuk mund të thuhet me siguri për një gjynahqar të caktuar se ai pas vdekjes do të banojë përjetësisht në Zjarr, por pohohet se kjo është në dëshirën e Allahut: ose e fal me mëshirën e Tij, ose e ndëshkon me drejtësinë e Tij. Sigurisht që pasi gjykohet se një person i caktuar ka rënë në kufër, atëhere, në këtë botë, për të zbatohen dispozitat e kufrit.

Kështu pra, prej parimeve të ndjekësve të Traditës Profetike dhe Xhematit është se ata bëjnë dallim ndërmjet tekfirit absolut dhe tekfirit të përcaktuar. Tek ata nuk lejohet që një person i caktuar të quhet jobesimtar, edhe nëse ka bërë ndonjë vepër mosbesimi apo ka thënë ndonjë fjalë herezie, vetëm pasi ndaj tij të jenë ngritur argumentet dhe t’i jenë qartësuar, të plotësohen kushtet dhe të largohen pengesat e tekfirit. Bazuar në këtë, theksojmë se jo çdokush që bën një vepër kufri konsiderohet jobesimtar.

➤ **Pengesat e tekfirit:**

1- Injoranca - mosnjohja e gjykimit të sheriatit. Kush bie në ndonjë vepër kufri nga padija, duke mos qenë i shkujdesur në

³⁹ Akuzimi i muslimanit për mosbesim dhe nxjerrja e tij nga feja, për shkak të kryerjes së ndonjë gjynahu të madh.

kërkimin e së vërtetës, ky nuk quhet pabesimtar. I tillë është rasti i një muslimani i cili është i ri në fe, i cili nuk i kupton disa detaje të saj (të fesë), ose ai që rritet në ndonjë vend jomusliman apo jeton në ndonjë vend të largët jo pranë muslimanëve.

2- Gabimi - është veprimi i diçkaje në mënyrë të jo të saktë. Njeriu që bie në kufër për shkak të gabimit, nuk konsiderohet mohues - jobesimtar. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nuk është gjynah nëse gaboni, por është gjynah, kur zemrat tuaja bëjnë faj me qëllim. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (El Ahzab: 5)

3- Detyrimi - kur dikush shtrëngohet që të bëjë një punë a diçka tjetër pa dëshirën e pa vullnetin e vet. Kur njeriu detyrohet të bëjë ndonjë vepër kufri, teksa i rrezikohet jeta, duke mos qenë i aftë të mbrojë veten, në një rast të tillë, nuk quhet jobesimtar. Allahu i Lartësuar thotë:

“Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit, (do të dënohet ashpër), përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim. Ndërsa ata që ia hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh.”(En-Nahl: 106)

MËSIMI I TRETË

GJYKIMI JO SIPAS ASAJ QË KA ZBRITUR ALLAHU I LARTËSUAR

➤ **Gjykimi jo sipas asaj që ka zbritur Allahu i Lartësuar** ndahet në disa lloje:

Lloji i parë: Kur sundimtari mohon shpalljen e Allahut të Lartësuar apo e përgënjeshton atë, atëhere ky bie në kufër, sipas konsensusit të dijetarëve.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta.” (En-Neml: 14)

Lloji i dytë: Sundimtari ia lejon vetes të sundojë jo me ligjin e Allahut të Lartësuar. Duke qenë se lejon atë që Allahu e ka ndaluar, **ky bie në kufër.** Për këtë ka dakortësi mes dijetarëve. Prej argumenteve që dëshmojnë se lejimi i asaj që ka ndaluar Allahu është kufër, është fjala e Allahut të Lartësuar: **“Zhvendosja (e një muaji të ndaluar) është vetëm shtesë në mosbesim. Prandaj mohuesit humbin larg: një vit e quajnë të lejueshëm e vitin tjetër të ndaluar, për të plotësuar numrin e muajve që i ka ndaluar Allahu.”**(Et-Teube: 37)

Lloji i tretë: Kur sundimtari ve shenjën e barazimit mes ligjit të Allahut dhe ligjeve të krijesave, ky gjithashtu ka rënë në kufër të madh. Allahu i Lartësuar thotë:

“Andaj, mos krahasoni asnjë me Allahun!” (En-Nahl: 74)

Lloji i katërt: Kur sundimtari preferon ligjet e krijesave, i pëlqen ato më shumë se ligjet e Allahut, ky bie në kufër të madh. Allahu i Lartësuar thotë:

“A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislamik)?! E kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm?”(El Maide: 50)

Lloji i pestë: Kur sunduesi gjykon jo me ligjin e Allahut, për shkak të tekave dhe të pasioneve të tij. Nëse kjo ndodh në një numër të kufizuar çështjesh. **Kjo konsiderohet *fisk* - mosbindje ndaj Allahut.**

Në rastin **kur përgjithësisht ai ka vendosur ligjet e veta ose i përshtat në vendin e tij ligjet që zbatojnë vendet në të cilat nuk sundon sheriati islam**, në lidhje me këtë, dijetarët ndajnë mendime të ndryshme, sa i përket çështjes së tekfirit: shumica pohojnë se ka rënë në kufër, pjesa tjetër thonë se me këtë veprim nuk del prej Islamit.

Sa i përket rastit **kur sundimtari gjykon jo sipas asaj që ka zbritur Allahu i Lartësuar, për shkak të paditurisë, detyrimit apo keqinterpretimit**, të gjitha këto, janë prej pengesave që nuk e lejojnë tekfirin, sikurse e përmendëm më lart.

MËSIMI I KATËRT

PËR BIDATIN

➤ **Bidati është çdo besim, fjalë apo vepër përmes të cilave adhurohet Allahu i Lartësuar, duke mos pasur argument në sheriatin islam që dëshmojnë për ligjshmërinë e tyre.** Gjithashtu kur njeriu braktis diçka, duke e konsideruar një veprim të tillë adhurim ndaj Allahut, edhe ky rast konsiderohet bidat. Duke marrë në konsideratë çështjen me të cilën ka lidhje bidati, ai mund të ndahet në tre lloje:

Lloji i parë: Bidati në besim, siç është bidati i atyre që përngjasojnë Allahun me krijesat e Tij. Gjithashtu në këtë lloj bëjnë pjesë edhe bidatet e atyre që mohojnë Kaderin e Allahut të Lartësuar, emrat dhe cilësitë Tij.

Lloji i dytë: Bidati që ka lidhje me lënien e diçkaje duke e konsideruar atë formë adhurimi, siç veprojnë ata që nuk hanë asnjë produkt shtazor me pretendimin se kështu afrohen tek Allahu i Lartësuar; ose ata që e konsiderojnë beqarinë afrimetet tek Allahu i Lartësuar. Argument për këtë është fjala e Allahut të
Lartësuar:

“A kanë ata idhuj, të cilët u kanë caktuar një fe që nuk e ka lejuar Allahu?!” (Esh-Shura: 21)

Gjithashtu Xhabir bin Abdullah përcjell se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë në hutbe: **“Fjala më e mirë është fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit. Gjërat më të këqija janë shpikjet në fe dhe çdo risi në fe është humbje.”** (Muslimi)

➤ **Nënçështje: Festa**

Festë konsiderohen ceremonitë përkujtimore, që realizohen në kohë dhe në vende të caktuara.

Kriteri bazë që përcakton paligjshmërinë e një feste është: madhërimi i vetë kohës apo vendit, përmes tubimit apo organizimit të ceremonive përkujtimore e të tjera si këto, që përsëriten në mënyrë periodike. **Shembuj për festat e paligjshme:** festat e ditëlindjes, përkujtimi i martesës e të tjera si këto.

➤ **Festat që kremtojnë njerëzit ndahen në dy lloje:**

Lloji i parë: Festat i kremtojnë, duke mos pasur qëllim adhurimin e Allahut të Lartësuar, siç janë festat kombëtare. Nuk lejohet kremtimi i tyre.

Lloji i dytë: Festat që i kremtojnë, duke e konsideruar një veprim të tillë adhurim ndaj Allahut. Ky është mëkat më i rëndë se i pari. Të tilla janë p.sh.: java e xhamive, nata e Israsë dhe Miraxhit e të tjera bidate si këto.

KAPITULLI VII

UDHËHEQËSIA, XHEMATI, SAHABËT DHE EULIJATË

Mësimi i parë: Udhëheqësia dhe Xhemati

Mësimi i dytë: Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!)

Mësimi i tretë: Eulijatë

MËSIMI I PARË

UDHËHEQËSIA DHE XHEMATI

Çdo musliman e ka për detyrë t'i japë besën imamit (udhëheqësit). I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: **“Kush vdes pa i dhënë besën imamit, vdes si në kohën e injorancës⁴⁰.”** (Muslimi)

Muslimani duhet t'i bindet dhe ta respektojë udhëheqësin, përveç rastit kur ai e urdhëron të bëjë gjynahe. Udhëheqësi u prin njerëzve në haxh, në namazin e xhumasë dhe të bajrameve. Bindja ndaj udhëheqësit është detyrë, sidoqoftë ai: njeri i mirë apo i keq (gjynahqar). Nga ana tjetër, udhëheqësi duhet këshilluar. Në rast se muslimanët kanë mosmarrëveshje me udhëheqësin e tyre, ata të gjithë duhet t'i drejtohen Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Allahu i Lartësuar thotë: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.”** (En-Nisa: 59)

Nuk lejohet kryengritja dhe rebelimi ndaj udhëheqësve, edhe nëse ata bëjnë padrejtësi, derisa të shfaqin kufër të qartë, për të cilin kemi argument prej Allahut. Në rastin kur arrijnë këtë vijë të kuqe, largimi i tyre nga pushteti nuk duhet pasohet me një dëm më të madh sesa dëmi i qendrimit të tyre në të (pushtet). Në hadithin e transmetuar nga Ubade bin Samit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: **“Mos u rebeloni ndaj**

⁴⁰ Si xhahil - i paudhëzuar.

tyre e t'i rrëzoni nga pushteti, derisa ata të shfaqin kufër të qartë duke pasur argument nga Allahu i Lartësuar që e vërteton këtë (kufirin e tyre).” (Buhariu)

➤ **Xhemati dhe udhëheqësia**

- ✓ **Kur flasim për “Xhematin”, në këtë aspekt, kemi për qëllim shokët e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe gjithë ndjekësit e tij besnikë deri në Ditën e Gjykimit.** Këta janë grupi i shpëtuar dhe pala e ndihmuar. Të gjithë ata që i përmbahen rrugës së tyre quhen “Xhemat”. Sigurisht, përderisa ndjekin gjurmët e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ata janë duke ecur në rrugën e drejtë, edhe nëse gabojnë në disa çështje.
- ✓ **Nuk lejohet përçarja në fe dhe as përhapja e fitneve (trazirave) mes muslimanëve.** Për çdo gjë që muslimanët kanë mosmarrëveshje, i referohen Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), duke u përpjekur për t'i kuptuar këto dy burime të fesë ashtu si të parët tanë të mirë.
- ✓ **Kush del nga Xhemati, duhet të këshillohet e të debatohet me të në mënyrën më të mirë.** Atij duhet t'i ngrihen argumentet dhe t'i qartësohet e vërteta, derisa të pendohet; përndryshe, i jepet dënimi i merituar, duke u bazuar në ligjet e shariatit.
- ✓ **Muslimanët duhet të zbatojnë Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), sikurse duhet të respektojnë konsensusin e dijetarëve islamë.** Nuk lejohet që muslimanët të sprovohen me gjëra delikate dhe as me teza e ide që janë të vështira për t'u kuptuar.

- ✓ **Duhet të kemi mendim të mirë për gjithë muslimanët;** të besojmë se ata kanë qëllime të mira dhe besim të saktë, derisa të shfaqet e kundërta. Kjo mund të ndodhë për shembull: kur muslimanët jetojnë në një vend ku janë përhapur në masë besimet e gabuara. Fjalëve të muslimanëve duhet t'u japim gjithmonë kuptimin më të mirë. Sa për atë që e shfaq inatin apo qëllimin e keq, nuk lejohet të hyjmë thellë në interpretimin e fjalëve, sepse mund të gabojmë.
- ✓ **Sektet e *ehlu el Kiblet*⁴¹ janë në rrezik.** Ithtarët e tyre i pret dënimi në këtë botë dhe në botën tjetër, nëse nuk pendohen. Gjykimi për këta të devijuar është si për gjithë ata që janë paralajmëruar me ndëshkim, përveç atyre që shfaqin besimin dhe fshehin kufrin; këta të fundit do të jenë përherë në Zjarr. Edhe ata që kundërshtojnë parimet bazë të besimit, për të cilat kanë rënë në konsensus të parët tanë të mirë, konsiderohen të përjashtuar nga Islami, ashtu si pabesimtarët në përgjithësi. Për ta jepet i njëjti gjykim, si për tradhëtarët e fesë.
- ✓ **Falja e namazit të xhumasë dhe e pesë namazeve me xhemat janë prej simboleve të dukshme të Islamit.** Është i saktë namazi që falet pas një muslimani gjendja e të cilit nuk njihet mirë. Mosfalja e namazit pas tij, me pretendimin se nuk e njohim, është bidat.
- ✓ **Nuk lejohet të falet namazi pas një personi që e shfaq bidatin ose një njeriu të shturur prej muslimanëve, kur është mundësia të falemi pas një besimtari të devotshëm.** Por, edhe nëse ndodh që falemi pas njerëzve të këqij, namazi ynë është i saktë. Kush falet pas këtyre imamëve të

⁴¹ Muslimanët që kanë devijuar nga Suneti i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

këqij, është gjynahqar; bën përjashtim rasti kur ka për qëllim të parandalojë një të keqe të madhe. Nëse nuk ka imam tjetër veç tij ose është një më i keq se ai, në këto raste, lejohet të falesh pas tij, nuk lejohet të braktisësh xhematin.

- ✓ **Nëse ndodh që ndonjë imam e shfaq haptazi kufrin, atëhere nuk është i saktë namazi që falet pas tij.**
- ✓ **Udhëheqësi suprem duhet të ketë konsensusin e ymetit ose ai mund të caktohet në krye të shtetit përmes dakortësisë së të zgjedhurve të popullit.** Nëse ndodh që dikush e merr pushtetin forcërisht, bëhet sundimtar i vendit dhe vendos rendin, në këtë rast, muslimanët duhet ta respektojnë e t'i binden atij, përderisa ai nuk urdhëron për kryerjen e gjynaheve; sigurisht që ai duhet këshilluar. Nuk lejohet kryengritja e rebelimi ndaj tij, përveç rastit kur e shfaq haptas kufrin; për këtë duhet të kemi argument të qartë prej Allahut.
- ✓ **Namazi, haxhi dhe përpjekja në rrugën e Allahut janë detyra që duhen kryer me udhëheqësit muslimanë, edhe nëse ata bëjnë padrejtësi.**
- ✓ **Është rreptësisht e ndaluar lufta ndërmjet muslimanëve për çështje të kësaj bote apo për çfarëdo çështje që ka të bëjë me mbeturinat e kohës së injorancës. Madje, kjo (lufta) konsiderohet prej gjynaheve më të mëdha.** Lejohet të luftohen bidatçinjtë, rebelët e të tjerët të ngjashëm me ta, nëse nuk është mundësia të pengohen me mënyra të tjera. Madje, lufta mundet të bëhet e detyrueshme, në varësi të interesit dhe rrethanave.
- ✓ **Sahabët e nderuar ishin të gjithë njerëz të drejtë. Ata janë njerëzit më të mirë të këtij ymeti.** Vlerat dhe meritat e tyre janë absolutisht të padiskutueshme. Ata janë

besimtarët më të mirë të këtij ymeti pas Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Dashuria ndaj tyre është fe dhe besim; ndërsa urrejtja ndaj tyre është kufër dhe mosbesim. Ne kemi mendim të mirë për të gjithë sahabët dhe heshtim ndaj të metave të tyre. Gjithashtu, heshtim për grindjet që kanë ndodhur mes tyre dhe nuk thellohemi në to. Ajo që duhet të bëjmë është: të lutemi dhe t'i kërkojmë falje Allahut për ta. Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!

Më i miri prej sahabëve është Ebu Bekri, pastaj Umeri, pastaj Uthmani, pastaj Aliu. Këta janë katër udhëheqësit e drejtë të periudhës së lavdishme të Kalifatit të Drejtë.

- ✓ **Dashuria, nderimi, respekti për të afërmit e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe familjarët e tij janë prej fesë.** Në ngrejme lart vlerat dhe meritat e bashkëshorteve të të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!); ua njohim meritat nënave të besimtarëve. I duam të gjithë udhëheqësit e drejtë prej të parëve tanë të mirë, dijetarët e Sunetit dhe gjithë pasuesit e tyre besnikë. Ndërkaq, largohemi nga bidatçinjtë dhe ndjekësit e pasioneve të shfrenuara.
- ✓ **Përpjekja në rrugën e Allahut është pika kulmore e Islamit.** Ajo nuk mund të shfuqizohet. Përkundrazi, do të vazhdojë të ekzistojë deri në Ditën e Kiametit.
- ✓ **Promovimi i vlerave dhe parandalimi i ligësive janë simbole madhështore të Islamit; janë shkaqe të rëndësishme për ruajtjen e bashkësisë islame.** Këto janë dy detyra që mishërojnë bindje ndaj Allahut dhe përgjegjësinë e muslimanit karshi shoqërisë, për rregullimin dhe përmirësimin e saj.

MËSIMI I DYTË

SAHABËT (ALLAHU QOFTË I KËNAQUR ME TA!)

Sahabiu është ai që e takoi Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i besoi atij dhe ndërroi jetë si musliman. Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) janë njerëzit më të mirë pas profetëve. Të gjithë ata janë njerëz të drejtë. Allahu i Lartësuar ka thënë: “Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t’i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.” (El Fet’h: 29)

- Sahabët dallojnë ndërmjet tyre në aspektin e vlerave dhe meritave:

Muhaxhirët janë më të mirë se ensarët.

Ata që shpenzuan pasurinë e tyre dhe luftuan në rrugë të Allahut para marrëveshjes së Hudejbijes janë më të mirë, sesa ata që shpenzuan dhe luftuan pas kësaj marrëveshjeje.

Ata që morën pjesë në luftën e Bedrit janë më të mirë sesa të tjerët.

Ata që i dhanë besën Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Beslidhjen e Riduanit⁴² janë më të mirë sesa të tjerët.

Sa u përket dallimeve individuale, edhe në këtë aspekt, vlerat e meritat e tyre janë të ndryshme: Më të mirët e sahabëve janë prijësit e drejtë: Ebu Bekri, Umeri, Uthmani dhe Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me ta!).

Pastaj vijnë pjesa tjetër e sahabëve të përgëzuar me Xhenet: Abdurrahman bin Auf, Sad bin Ebi Uekas, Talha bin Ubejdullah, Ez-Zubejr bin el Auam, Ebu Ubejdetu Amir bin el Xherah dhe Seid bin Zejd (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!).

Ehlul bejti nebij - familja e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi ta!) janë: pasardhësit e Aliut, të Xhaferit, Abasit, Harithit dhe gratë e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Gratë më të mira të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) janë: Aishja dhe Hatixhja (Allahu qoftë i kënaqur me të dyja!).

➤ **Të drejtat e sahabëve dhe detyrimet ndaj tyre:**

1. Dashuria ndaj tyre, lutja dhe kërkimi i faljes për ta.

2. Të kemi mendim të mirë për ta, duke ua njohur vlerat dhe meritat.

3. Të heshtim ndaj të metave të tyre dhe ndaj asaj që ka ndodhur mes tyre.

⁴² Para marrëveshjes së Hudejbijes, muslimanët i dhanë besën Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), për të luftuar deri në vdekje. Allahu që i kënaqur me besimtarët, prandaj kjo besëlidhje mori emrin “Bejatu Riduan - Marrëveshja e Kënaqësisë”. (shën. përkth.)

➤ **Nënçështje:**

Sharja e sahabëve klasifikohet në disa kategori:

Kategoria e parë: Kush i shan ata të gjithë ose pjesën më të madhe të tyre, duke i sulmuar në fenë dhe drejtësinë e tyre, ka bërë kufër.

Kategoria e dytë: Kush i shan sahabët për vlerat e të cilëve kanë ardhur shumë tekste të shenjta, duke i sulmuar në fenë dhe drejtësinë e tyre, edhe ky, ka rënë në kufër.

Kategoria e tretë: Kush i sulmon sahabët në fenë dhe drejtësinë e tyre, qoftë edhe ata për të cilët nuk ka shumë tekste të shenjta që flasin për vlerat dhe meritat e tyre, edhe ky, ka bërë kufër.

Kategoria e katërt: Kush i shan gjithë sahabët apo pjesën më të madhe të tyre, në çështje që nuk çënojnë fenë e tyre, si p.sh.: i akuzon për koprraci, padituri apo mosnjohje të politikës e të tjera si këto, **ky ka rënë në *fisk* (poshtërsi) dhe hipokrizi.** Ndërkaq, ndaj atij që vepron kështu, duhet të ndërmerren masa ndëshkimore.

Kategoria e pestë: Kush e shan Aishen (Allahu qoftë i kënaqur me të!) në atë çështje që e ka shfajësuar Allahu, ky ka rënë në kufër, duke e përgënjeshtuar Kuranin.

Kategoria e gjashtë: Kush i shan pjesën tjetër të nënave të besimtarëve në gjëra që Allahu i ka shfajësuar, duke cënuar pastërtinë morale të tyre, edhe ky, ka rënë në kufër.

MËSIMI I TRETË

EULIJATË

➤ *Ueliju*⁴³ është çdo besimtar i devotshëm. Allahu i Lartësuar thotë:

“Pa dyshim, miqtë e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillë janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut).” (Junus: 62-63)

Shkalla e afrimitetit tek Allahut të Lartësuar nuk përcaktohet nga prejardhja, por nga besimi dhe devotshmëria.

Allahu i Lartësuar thotë:

“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.” (El Huxhurat: 13)

➤ *Kerameti*⁴⁴ është një ndodhi e pazakontë, realizimin e së cilës Allahu ia mundëson ndonjërit prej eulijave të Tij si nderim për të, si dhe për të vërtetuar se ai është ndjekës besnik i Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

⁴³ Miku i Allahut.

⁴⁴ Kerametet janë nderimet apo dhuntitë që Allahu u jep njerëzve të mirë.

KAPITULLI VIII

PËRMBLEDHJE E BINDJEVE TË RAFIDIVË DHE SUFIVË

Mësimi i parë: Përmbledhje e bindjeve të rafidive

Mësimi i dytë: Përmbledhje e bindjeve të sufijve

MËSIMI I PARË

PËRMBLEDHJE E BINDJEVE TË RAFIDIVE

➤ Ç'janë rafiditë?

Themeluesi i shiitëve është hebreu Abdullah bin Sebe'e. Ai jetoi në kohën e Ali bin Ebi Talib (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Pas tij, shiitët u ndanë në grupe të ndryshme. Më i njohuri dhe më i përhapuri deri në ditët tona është sekti shiit "*ithnëashari* - dymbëdhjetë imamët".

Rafiditë ithnëashari janë sekti shiit që në kohën tonë njihen me emërtime të ndryshme, prej të cilave: ithnëasheri, rafidi, shiit dhe imami. Ata kanë shumë bindje të gabuara, që bien ndesh me besimin e muslimanëve. Përmes këtyre bindjeve qartësohet realiteti i rafidive ithnëasheri.

➤ Bindjet e rafidave ithnëasheri:

1. Ata besojnë se Kurani është ndryshuar. Librat e tyre janë të tejmbushur me këtë besim të devijuar. Madje, kanë shkruar libra të veçantë për këtë çështje, sikurse është libri "*Faslu el hitab fi ithbati tahrifi kitabi rabi el erbab*", autor i të cilit është Husejn Et-Taberasi, i cili ka ndërruar jetë në vitin 1320 sipas kalendarit hënor.

2. Interpretimi ezoterik⁴⁵ i ajeteve të Kuranit të Madhëruar, me të cilin qeshin të mençurit.

3. Mohimi i Sunetit të Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), me përjashtim të dijes që marrin nga "të pagabueshmit", prej imamëve të tyre. Ata i fyejnë rëndë hadithologët e ymetit.

⁴⁵ Interpretim sekret dhe i fshehtë, që është i qartë vetëm për ata që e interpretojnë.

4. Sipas tyre, thëniet e imamëve të rafidave janë si thëniet e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

5. Sipas tyre, kundërshtimi i ndjekësve të Traditës Profetike është mençuri. Madje, prej bindjeve të tyre të papublikuara është edhe kjo: Veprat e mira të sunitëve u dhurohen shiitëve, ndërsa të këqijat e shiitëve u ngarkohen sunitëve.

6. Ndër shtyllat e fesë është “el Imametu”⁴⁶, madje e konsiderojnë shtylla e parë e saj (e fesë). Sipas tyre, kush e mohon këtë, konsiderohet jobesimtar. Numri i imamëve të tyre është dymbëdhjetë. I pari prej tyre është Ali bin Ebi Talib dhe i fundit është “Mehdiu i pritur”, i quajtur: Muhamed bin el Hasen el Askeri. Të gjithë imamët janë pasardhës të Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!), përveç imamit të fundit, i cili realisht nuk ekziston.

7. Sipas tyre, imami ka një pozitë shumë të lartë, të cilën nuk e arrin asnjë melek i afërt tek Zoti dhe asnjë profet, i Dërguar prej Allahut të Lartësuar. Ata kanë bindjen se imamët e zgjedhin vetë se kur do të vdesin dhe se ata e dijnë *gajbin* – të fshehtë. Sikurse besojnë se imamët e tyre janë më të ditur dhe më të mirë sesa profetët, dhe se ata kanë fuqi të ringjallin të vdekurit.

8. Ata besojnë se imamët janë të pagabueshëm; as nuk gabojnë dhe as nuk harrojnë.

9. Besojnë se sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) e kanë tradhëtuar fenë. I fyejnë dhe ofendojnë rëndë sahabët, përveç disave prej tyre, vetëm tre ose katër prej tyre: Selmanin, Mikdadin, Ebu Dherrin dhe Amarin; vetëm këta sahabë nuk i shajnë. Kur thonë: “Allahu qoftë i kënaqur me sahabët!”, kanë për qëllim pikërisht emrat e lartpërmendur.

⁴⁶ Udhëheqësia.

10. Thonë se “nuk ka besnikëri fetare pa distancim e armiqësi”. Me këtë shprehje kanë për qëllim distancimin dhe armiqësinë ndaj Ebu Bekër es-Sidikut dhe Umer el Farukut (Allahu qoftë i kënaqur me të dy!).

11. Vrasësit të Umer bin Hatabit, Ebu Lulu el Mexhusit i thërrasin “Porta e guximit fetar”. Ditën e vrasjes së Umerit e quajnë “ditë e festës së madhe” apo “ditë e bekuar”.

12. Teprimi në varret e imamëve dhe ndërrmarja e udhëtimeve të gjata për t’i vizituar ato. Ata besojnë se toka e Kerbelasë dhe faltoret e shenjta janë pjesët më të nderuara në Tokë. Tek ata është mjaft i përhapur besimi se haxhi në Kerbela është mijëra herë më i mirë sesa haxhi në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, në Qabe.

13. Besimi tek “Kthimi”

Ky besim është transmetuar në më shumë se 2000 hadithe të shpikura e të shpërndara në 50 libra. Sipas këtij besimi, kur të vijë koha e të dalë Mehdiu i tyre, Allahu do të kthejë në jetë shumë prej të vdekurve, ashtu siç kanë qenë në dynja. Atëhere Mehdiu i tyre do t’i vrasë armiqtë dhe shiitëve do t’ua kthejë të drejtat, të cilat ua kanë marrë me dhunë të tjerët përgjatë shekujve. Sipas tyre, në krye të armiqëve të cilët do të rikthehen në jetë janë: Ebu Bekri dhe Umeri, ndaj të cilëve do të hakmerren duke i kryqëzuar. **14. Besimi se imami i fundit i tyre Mehdiu është fshehur kur ishte 4 vjeç në bodrumin e Samurasë, që gjendet mes Bagdatit dhe Tikritit.** Atij i kanë vënë pseudonime të ndryshme si “Mehdiu el huxhe⁴⁷”. **15. Prej bindjeve të tyre është dhe “tukja⁴⁸”**. Kjo është prej bazave të doktrinës së tyre. Ata thonë se nuk adhurohet Allahu

⁴⁷ Mehdiu është prova, dëshmia, argumenti.

⁴⁸ Fshehja e së vërtetës para kundërshtarëve të tyre.

me diçka më të mirë, që Ai e do shumë, sesa fshehtësia, me të cilën nënkuptojnë *tukjen*. Madje, e konsiderojnë atë 9/10 e fesë. Gjithashtu thonë: “Nuk ka fe, ai që nuk ka *tukje*.”

16. Kontrata martesore e përkohshme kundrejt një pagese.

Këtë e konsiderojnë prej veprave më të mira, me të cilat njeriu afrohet tek Allahu i Lartësuar. Ata thonë se kjo lloj martese e përkohshme me një grua besimtare është si të vizitosh Qaben 70 herë. Fëmija i lindur nga kjo martese është më i mirë se fëmija i lindur nga martesa tradicionale, me gruan e përhershme. Kush e mohon martesën e përkohshme, konsiderohet jobesimtar - tradhtar i fesë. Për këtë lloj martese ata thonë se nuk ka kufij numerik, që do të thotë se: burri mund të martohet në këtë mënyrë edhe me 1000 gra.

17. Sipas tyre, muslimanët duhet të japin 1/5 e pasurisë që fitojnë, pas mbulimit të shpenzimeve vjetore, teksa gjysma e 1/5, në këtë kohë, shkon për imamin e fshehtë.

Ata besojnë se 1/5 e pasurisë duhet t'i dorëzohet prijësit fetar, që e quajnë *merxhiu*⁴⁹ apo *el fakihu*⁵⁰. Ai ka të drejtë ta shpenzojë këtë pasuri në ato drejtime të cilat ia mëson imami i fshehtë.

18. Besojnë se lejohet të bashkohet namazi i drekës me ikindinë dhe akshami me jacinë, kur njeriu është në vendbanimin e tij, pa ndonjë shkak apo arsye të fortë.

19. Shiat ithnëasheri kanë rënë në dakort se kur merret abdes, këmbëve u jepet *mes'h*⁵¹, në vend që të lahen.

Gjithashtu ata nuk e lejojnë dhënien e *mes'hit* mbi meste apo çorape.

⁴⁹ Referenca.

⁵⁰ Njeriu i ditur.

⁵¹ Pjesa e sipërme e këmbëve fshihet me dorë të lagur.

MËSIMI I DYTË

PËRMBLEDHJE E BINDJEVE TË SUFIJVE

➤ Njohja e sufizmit

Sufijtë janë sekt fetar që u përhap në botën islame në shekullin e tretë të hixhretit. Fillimisht sufizmi ka lindur në formën e tendencave individuale, që bënin thirrje për asketizëm dhe shtimin e intensitetit të adhurimit. Kjo erdhi si rezultat i reagimit të kundërt ndaj zhytjes në dynja dhe jetës luksoze. Më pas këto tendenca u zhvilluan, derisa u krijua një *tarikati* i njohur dhe i dallueshëm nga të tjerët, i quajtur *'tarikati sufij'*.

➤ Shtresat e sufijve:

Ne mund të njohim zhvillimin e sektit sufij gjatë historisë, përmes njohjes së shtresave të tij, të cilat janë:

Shtresa e parë: Kjo shtresë u bë e famshme për sinqeritetin në asketizëm deri në cakun e vesvesit dhe largimit nga kjo botë. Më vonë lindën devijime në sjellje dhe adhurime, të cilat binin në kundërshtim me Traditën e Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe të shokëve të tij fisnikë (Allahu qoftë i kënaqur me ta!). Gjithsesi, shtresa e asketëve i përket kohës së artë, sepse tek ajo dominonte besimi dhe përkushtimi ndaj adhurimit të Allahut. Kësaj shtrese i përkasin mjaft personalitete, si: Xhunejdi, Sulejman Ed-Darani, Maruf El Kerhi etj.

Shtresa e dytë: Kjo shtresë e përzieu asketizmin me fraza ezoterike të tilla si p.sh.: Uniteti i Qenies, panteizmi, *el fenau*⁵², *el keshfu*⁵³, *el ahualu* dhe *el mekamatu*⁵⁴ etj. Tek sufijtë është

⁵² Zhdukja dhe asgjesimi.

⁵³ Zbulimi.

fakt i njohur dallimi që ata bëjnë ndërmjet shariatit dhe së vërtetës. Ata i atriubojnë vetes njohjen e të vërtetave dhe e të fshehtave, ndërsa dijetarët e muslimanëve i konsiderojnë si njerëz sipërfaqësorë. Thonë se këta të fundit njohin vetëm anën sipërfaqësore të fesë. Në fakt, kjo shtresë përfaqëson fillimet e devijimit të sektit sufij, i cili tashmë, në ditët e sotme, ka rënë në shumë bidate dhe besëtytni. Përfaqësuesit më në zë të kësaj shtrese janë: Dhu-Nuni, Ebu Zejd el Bestami etj.

Shtresa e tretë: Kjo është shtresa që e përzieu sufizmin me filozofinë greke. Në kohën e përhapjes të kësaj shtrese u konsoliduan besimet e devijuara, si: Uniteti i Qenies dhe panteizmi. Ata besojnë se Krijuesi është bashkuar me krijesën, ndërsa natyrën e shohin si mishërim të Zotit. Më të famshmit e kësaj shtrese janë: Halaxhi, Ibn Arabiu, Ibn Faridi dhe Ibn Seb'ini.

➤ **Bindjet e sufistëve**

❖ **Besimi në Allahun e Lartësuar**

Sa i përket besimit në Allahun e Lartësuar, sufijtë kanë bindje të ndryshme, prej të cilave janë: Uniteti i Qenies dhe panteizmi. Sipas kësaj të fundit, Zoti është shkrirë në natyrë dhe nuk ka dallim ndërmjet Krijuesit dhe krijesës. Ky besim u përhap në shekullin e tretë dhe vazhdon deri në ditët e sotme. Këto ide të gabuara i bartin dhe i përhapin udhëheqësit e kësaj doktrine të devijuar.

❖ **Besimi në të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)**

Sufijtë kanë bindje të ndryshme për Profetin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Një pjesë e sufijve

⁵⁴ Gjendjet dhe pozitat.

pretendojnë se Profeti (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk ka arritur gradën e besimit të tyre, dhe se ai nuk di atë çfarë dinë klerikët misitkë. Ky është besimi i Ibn Arabiut dhe i të gjithë të tjerëve pas tij.

Një pjesë e tyre besojnë se i Dërguari i Allahut, Muhamedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është kupola e universit, se ai qëndron mbi Arshin e Allahut dhe se qiejt, Toka, Arshi dhe Kursija u krijuan nga drita e tij. Gjithashtu, kanë bindjen se ai është krijesa e parë e Zotit.

❖ **Besimi në eulijatë**

Edhe për eulijatë sufijtë kanë besime të ndryshme. Ata i japin përparësi uelijut ndaj Profetit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Pjesa më e madhe e tyre e konsideron uelijun të barabartë me Allahun në të gjitha cilësitë. Sipas tyre, ueliju krijon, dhuron, i sjell krijesat në jetë, ua merr shpirtin dhe rregullon çështjet e universit.

❖ **Varret dhe mauzoleumet⁵⁵**

Sufijtë mbajnë qëndrime ekstreme ndaj varreve të eulijave dhe njerëzve të mirë. Ata i madhërojnë varret në mënyrë të atillë që bie ndesh me fenë e Allahut. E kërkojnë bereqetin nga varret dhe mauzoleumet; kërkojnë shpëtim prej të vdekurve dhe ndërmjetësim prej tyre; zotimet, flijimet dhe sakrificat ua kushtojnë atyre, dhe të tjera bidate dhe manifestime të paganizmit si këto.

❖ **Xheneti dhe Zjarri**

⁵⁵ Ndërtesë që ngrihet si përmendore mbi varrin e një njeriu të shquar.

Të gjithë sufijtë besojnë se kërkimi i Xhenetit është mangësi e madhe. Sipas tyre, nuk lejohet që ueliju të punojë për të fituar Xhenetin dhe nuk duhet ta kërkojë atë; kush e kërkon atë, ka mangësi në besim. Kërkesa dhe synimi i besimtarit, sipas tyre, duhet të jetë *“el fenau”*.

Edhe për Zjarrin, sufijtë besojnë gjithashtu se nuk i takon një besimtari të mirë sufij që të kërkojë shpëtim prej Zjarrit. Nga ata që besojnë tek Uniteti i Qenies prej sufijve ka të tillë që pretendojnë se Zjarri, për ata që do të hyjnë në të, do të shndërrohet në mirësi e begati, të cilat janë jo më pak se mirësitë dhe begatitë e Xhenetit, madje edhe me shumë. Ky është besimi i Ibn Arabiut.

❖ **Adhurimet**

Sufijtë besojnë se namazi, agjërimi, haxhi, zekati etj. janë adhurime që i kryejnë njerëzit e thjeshtë, ndërsa ata e konsiderojnë veten *“elite”*, madje si *“ajka e elitës”*. Prandaj ata kryejnë adhurime të veçanta.

Adhurimet e veçanta: Secili grupacion prej tyre ka shpikur adhurime të veçanta, si p.sh. i përkushtohen një dhikri të veçantë që e kryejnë në një formë të caktuar. Të njëjtë gjë bëjnë edhe më adhurimet e tjera. Gjithashtu ata kanë ushqime, veshje dhe ceremoni të veçanta.

❖ **Hallalli dhe harami**

Ndjekësit e Unitetit të Qenies prej sufijve nuk kanë ndonjë gjë të ndaluar. Një pjesë e tyre beson se Allahu i ka liruar nga detyrat fetare dhe ua ka lejuar gjithçka që ua ka ndaluar të tjerëve.

❖ **Pushteti, qeverisja dhe politika**

Sufijtë ndjekin metodën e mospërballjes me të keqen dhe me pushtetarët e korruptuar, sepse, sipas tyre, Allahu zgjedh në krye të shtetit udhëheqësit që Ai dëshiron.

PËRMBAJTJA

▪ Hyrja	3
▪ Kapitulli I: Përkufizimi i akides, themeli i akides islame dhe burimet referenciale të saj	5
▪ Mësimi i parë: Përkufizimi i akides dhe teuhidit	6
▪ Mësimi i dytë: Themeli i akides islame dhe burimet referenciale të saj	7
▪ Mësimi i tretë: Shehadeti “La ilahe il Allah”	10
▪ Mësimi i katërt: Shirku i madh dhe shirku i vogël	11
▪ Mësimi i pestë: Kufri	15
	19
▪ Kapitulli II Ibadeti dhe format e shfaqjes së shirkut në të	
▪ Mësimi i parë: Përkufizimi i ibadetit	20
▪ Mësimi i dytë: Dy kushtet e ibadetit	21
▪ Mësimi i tretë: Llojet e ibadetit	22
▪ Mësimi i katërt: Shtirja	36
▪ Mësimi i pestë: Kur nëpërmjet veprave të mira njeriu synon të përfitojë nga kjo botë	39
▪ Kapitulli III: Besimi dhe shtyllat e tij	43
▪ Mësimi i parë: Përkufizimi i besimit	44
▪ Mësimi i dytë: Lidhja ndërmjet Islamit dhe Imanit	47
▪ Mësimi i tretë: Shtyllat e Imanit	48
▪ Shtylla e parë: Besimi tek Allahu	48
▪ Shtylla e dytë: Besimi në engjëjt	60
▪ Shtylla e tretë: Besimi në librat	61
▪ Shtylla e katërt: Besimi në të dërguarit e Allahut	63
▪ Shtylla e pestë: Besimi në Ditën e Fundit	66
▪ Shtylla e gjashtë: Besimi në Kaderin	83
▪ Kapitulli IV: Mbështetja në shkaqet në vija të përgjithshme	85
▪ Mësimi i parë: Kategoritë e njerëzve në raport me shkaqet	86
▪ Mësimi i dytë: Llojet e shkaqeve dhe gjykimi për secilin prej tyre .	87
▪ Mësimi i tretë: Mjekimi	89
▪ Mësimi i katërt: Rukjet	90
▪ Mësimi i pestë: Hajmalitë	92
▪ Mësimi i gjashtë: Oguret (e mbarësisë ose fatkeqësisë)	93

▪ Mësimi i shtatë: Kërkimi i shiut prej yjeve	94
▪ Mësimi i tetë: Kur mirësitë i atribuohen tjetërkujt veç Allahut të Lartësuar	95
▪ Mësimi i nëntë: Kërkimi i bereqetit	96
▪ Mësimi i dhjetë: Magjia	99
▪ Kapitulli V: Fjalë dhe shprehje që përmbajnë shirk	104
▪ Mësimi i parë: Betimi për dikë tjetër përveç Allahut	105
▪ Mësimi i dytë: Si duhet të sillet njeriu me Allahun dhe krijesat e Tij, për gjërat që krijesa ka mundësi t'i bëjë?	106
▪ Mësimi i tretë: Emrat të cilat përmbajnë madhërim, nuk i takojnë vetëm se Allahut të Lartësuar	107
▪ Mësimi i katërt: Emrat me të cilat Allahu i Lartësuar ka emërtuar Vetën e Tij	108
▪ Mësimi i pestë: Emra nga të cilat nënkuptohet që përkushtimi me adhurim i drejtohet dikujt tjetër përveç Allahut	109
▪ Mësimi i gjashtë: Kërkimi i rreshjeve prej yjeve	110
▪ Mësimi i shtatë: Sharja e kohës duke përdorur shprehje fyese, mallkime e të tjera që e bëjnë injorantët.	111
▪ Mësimi i tetë: Ankesa	112
▪ Kapitulli VI: El uelau ue el berau, tekfiri dhe bidati	113
▪ Mësimi i parë: El uelau ue el berau	114
▪ Mësimi i dytë: Tekfiri	126
▪ Mësimi i tretë: Gjykimi jo sipas asaj që ka zbritur Allahu i Lartësuar	129
▪ Mësimi i katërt: Për bidatin	131
▪ Kapitulli VII: Udhëheqësia, xhemati, sahabët dhe eulijatë	133
▪ Mësimi i parë: Udhëheqësia dhe Xhemati	134
▪ Mësimi i dytë: Sahabët (Allahu qoftë i kënaqur me ta!)	139
▪ Mësimi i tretë: Eulijatë	142
▪ Kapitulli VIII: Përmbledhje e bindjeve të rafidive dhe sufive	143
▪ Mësimi i parë: Përmbledhje e bindjeve të rafidive	144
▪ Mësimi i dytë: Përmbledhje e bindjeve të sufijve	148
▪ Përmbajtja	153

